



**AUTORITETI I  
KONKURRENCËS**

---

# RAPORTI VJETOR **2014**

DHE

# SYNIMET KRYESORE TË PUNËS PËR VITIN **2015**

**Autoriteti i Konkurrencës**

Adresa: Rr. Sami Frashëri, nr. 4,  
Kati IV, Tiranë

Tel: +355 4 2 234 504

Fax: +355 4 2 234 497

Faqe e internetit: [caa.gov.al](http://caa.gov.al)

Email: [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)

## TABELA PËRMBLEDHËSE

<b>FJALA PËRSHENDETËSE E KRYETARIT TË KOMISIONIT</b>	<b>4</b>
<b>I. ZHVILLIMET KRYESORE TË LIGJIT DHE POLITIKËS SË KONKURRENCËS</b>	<b>5</b>
<b>I.1 Misioni dhe objektivat e Autoritetit të Konkurrencës</b>	<b>5</b>
<b>I.2 Përmbledhje ekzekutive</b>	<b>6</b>
<b>II. ZBATIMI I LIGJIT TE KONKURRENCES</b>	<b>13</b>
<b>II.1. ADMINISTRIMI I ANKESAVE</b>	<b>13</b>
<b>II.2 MARRËVESHJET E NDALUARA</b>	<b>22</b>
II.2.1 Hetim në tregun e sigurimit të detyrueshëm	23
II.2.2 Hetimi paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve	25
II.2.3 Hetimi paraprak në tregun e prokurimit publik “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë.	26
II.2.4 Hetimi paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Dibrës.	27
<b>II.3 PËRJASHTIM NGA NDALIMI I MARRËVESHJEVE</b>	<b>28</b>
II.3.1 Përjashtim nga ndalimi i marrëveshjes “Digitalb - Operatore televiziv”	28
<b>II.4 ABUZIMI ME POZITËN DOMINUESE</b>	<b>30</b>
II.4.1 Hetimi i thelluar në tregun e telefonisë celulare me pakicë ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SH.A	30
II.4.2 Hetimi thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të karburanteve	32
<b>II.5. KONTROLI I PËRQËNDRIMEVE</b>	<b>35</b>
<b>II.6 RISHIKIMI I TE DREJTAVE EKSKLUZIVE</b>	<b>41</b>
<b>II.7 MONITORIMET E TREGUT</b>	<b>43</b>
II.7.1 Tregu i importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos	43
II.7.2 Tregu i duhanit dhe nënprodukteve të tij.	43
II.7.3 Tregu i importit dhe shitjes më shumicë gazit të lëngshëm	44
II.7.4 Tregu i importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit të lulediellit	45
II.7.5 Monitorimin i tregut të produkteve të akcizës	46
<b>II.8 RISHIKIMI GJYQËSOR I ÇËSHTJEVE TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS</b>	<b>48</b>
II.8.1 Analiza e rasteve të rishikimit gjyqësor	50
II.8.2 Ekzekutimi i vendimeve	56
<b>II.9 PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E KONKURRENCËS</b>	<b>57</b>
<b>III. ADVOKATIA DHE KULTURA E KONKURRENCËS</b>	<b>59</b>
<b>III.1. VLERËSIMI I AKTEVE</b>	<b>59</b>
<b>III.2. DHËNIA E REKOMANDIMEVE</b>	<b>61</b>
<b>III.3 TRANSPARENCA DHE RITJA KULTURES SE KONKURRENCES</b>	<b>62</b>
III.3.1 Konferenca ndërkombëtare	62

III.3.2. Tryeza të rrumbullakëta rajonale me komunitetin e biznesit dhe akademikët _____	63
<b>IV. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR _____</b>	<b>64</b>
IV.1 BASHKËPUNIMI ME KOMISIONIN EUROPIAN _____	64
IV.2 BASHKËPUNIMI ME RRJETIT NDËRKOMBËTAR TË KONKURRENCËS (ICN) DHE AUTORITET E RAJONIT _____	66
IV.3. BASHKËPUNIMI ME AGJENCINË E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR TREGTINË DHE ZHVILLIMIN – UNCTAD _____	67
IV.4 MEMORANDUMI ME AUTORITETIN AUSTRIAK TE KONKURRENCËS _____	68
<b>V. ADMINISTRIMI I BURIMEVE NJERËZORE _____</b>	<b>69</b>
V.1 STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE FUNKSIONET E AUTORITETIT TË KONKURRENCËS _____	69
V.2 RRRITJA E KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE _____	71
V.4 MANAXHIMI FINANCIAR _____	71
<b>VI. PRIORITETET PËR VITIN 2015 _____</b>	<b>72</b>
VI.1. FORCIMI I ZBATIMIT TË LIGJIT TË KONKURRENCËS _____	72
VI.2. PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT _____	72
VI.3. HARTIMI I DOKUMENTIT TË RI TË POLITIKËS SË KONKURRENCËS _____	73
VI.4 BASHKËPUNIMI ME GJYQËSORIN _____	73
VI.5 RRRITJA DHE FORCIMI I KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE _____	73
<b>SHTOJCA _____</b>	<b>75</b>
Shtojcë 1: Të dhëna statistikore mbi vendimet e Komisionit të Konkurrencës sipas viteve _____	76
Shtojca 2: Lista e vendimeve te komisionit te konkurrencës _____	77
Shtojca 3: Ekzekutimi i gjobave të vendosura nga Komisioni i Konkurrencës _____	80
Shtojca 4 Lista e vendimeve shoqëruar me urdhër ekzekutimi _____	81
Shtojca 5 Përqendrimet e njoftuara dhe të autorizuara _____	82
Shtojca 6 Rezoluta e kuvendit për veprimtarinë e autoritetit te konkurrencës _____	83
Shtojca 7 Kapitulli 8: Politika e konkurrencës, raporti i progresit, komisioni evropian _____	85
Shtojca 8: Matrica e rekomandimeve nga komisioni i konkurrencës për vitin 2014 _____	86
Shtojcë 9: Struktura e Autoritetit të Konkurrencës _____	97
Shtojca 10: Buxheti faktik i Autoritetit të Konkurrencës viti 2014 _____	98

## **FJALA PËRSHENDETËSE E KRYETARIT TË KOMISIONIT**

Konkurrenca është mënyra më e mirë për të nxitur rritjen ekonomike pasi vetëm në një mjedis konkurrues mund të kemi rritje të produktivitetit. Ky efekt pengohet nga shtrembërimet dhe inefiçencat, të cilat luftohen pikërisht nga zbatimi i ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Në këtë mënyrë, zbatimi i Politikës dhe Ligjit të Konkurrencës luan një rol kyç në çdo strategji për rritjen ekonomike.

Qëllimi kryesor i së drejtës së konkurrencës është shpërndarja efiçente e burimeve, mision i cili mundësohet plotësisht vetëm nga një bashkëpunim shumë i ngushtë midis gjithë rregullatorëve të tregjeve specifike dhe institucionit të konkurrencës. Një sfidë e vazhdueshme kjo, për të kapërcyer shqetësimet e momentit me të cilat ballafaqohen këto tregje, për të konverguar në instrumentat që duhet të garantojnë mirë funksionimin e qëndrueshëm të tyre. Prandaj puna në partnership me të gjitha institucionet dhe entet rregullatore ka qënë një nga karakteristikat e konsoliduara të institucionit shqiptar të konkurrencës.

Rregullat për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive kanë si qëllim kryesor korrigjimin e keqfunksionimit të ekonomisë së tregut, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm për të nxitur rritjen ekonomike. Kjo pasi konkurrenca promovon, rritjen ekonomike nëpërmjet uljes së barrierave në hyrje, rritjes së efiçencës, liberalizimit, luftës kundër marrëveshjeve të ndaluara, e abuzimit me pozitën dominuese.

Institucioni i konkurrencës, nuk mund të ndërtojë një partnership real me komunitetin e biznesit dhe të konsumatorit për të zbuluar praktikant antikonkurrese, pa zbatuar parimet bazë të etikës dhe të transparencës.

Viti 2014 shënoi 10 vjetorin e Autoritetit të Konkurrencës dhe ky përvjetor shërbeu për të analizuar praktikant më të mira dhe rrugën e përmirësimeve për një efektivitet në rritje të institucionit të konkurrencës. Gjithashtu, ky përvjetor konfirmoi reputacionin e një organi publik të pavarur në funksion të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, karakteristikat e të cilit janë marrë në trajtim në mënyrë të detajuar nga personaliteteve të fushës së antitrustit, në një program vlerësimi (Peer review) të Kombeve të Bashkuara të kërkuar nga vetë Autoriteti i Konkurrencës.

Konkurrenca është një vlerë e tregut dhe e shoqërisë në përgjithësi, prandaj nxitja dhe mbrojtja nga kufizimet e mundshme, është një sfidë e vazhdueshme e Autoritetit të Konkurrencës por jo vetëm. E drejta e konkurrencës është pjesë përbërëse e institucionit të së drejtës, marrja në konsideratë e së cilës përbën një nga instrumentat e luftës ndaj korrupsionit. Këto janë sfidat e vazhdueshme të Autoritetit të Konkurrencës.

# **I. ZHVILLIMET KRYESORE TË LIGJIT DHE POLITIKËS SË KONKURRENCËS**

Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" (i ndryshuar) dhe Politika Kombëtare e Konkurrencës, janë instrumentat bazë ligjorë që mundësojnë adresimin dhe zgjidhjen e kufizimeve, shtrembërimeve dhe pengimeve të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Por, në realizimin e aktivitetit të tij, Autoriteti i Konkurrencës bazohet në Kushtetutën e Shqipërisë, Kodin e Procedurave Administrative, gjithë legjislationin shqiptar rast pas rasti si dhe në praktikat më të mira të së drejtës së konkurrencës kryesisht të vendeve të Bashkimit Europian.

## ***1.1 Misioni dhe objektivat e Autoritetit të Konkurrencës***

Autoriteti i Konkurrencës vepron për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg në zbatim të Ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës" duke u mbështetur në katër shtyllat kryesore që garantojnë mbrojtjen dhe nxitjen e konkurrencës. Ligji "Për mbrojtjen e konkurrencës" në të gjitha aspektet e tij është i përafuar në një shkallë të gjerë me *acquis-communitaire*, jo vetëm në përmbajtje, por edhe në instrumentet e zbatimit të tij.

Për realizimin e misionit të përcaktuar në ligjin bazë të konkurrencës, ky institucion përdor instrumentet ligjorë dhe nënligjorë siç janë procedurat hetimore për të zbuluar praktikat anti-konkurrese. Këto praktika shfaqen në formën e: marrëveshjeve të ndaluara për fiksimin e çmimeve, ndarjen e tregjeve, kufizimin apo kontrollin e prodhimit; të abuzimit me pozitën dominuese në formën e vendosjes së çmimeve të padrejta, kufizimin e prodhimit apo të shërbimit, vendosjen në pozita jo të barabarta të klientëve, apo vendosja e kushteve dhe detyrimeve shtesë në kontratë me palët e treta etj.

Autoriteti i Konkurrencës mbikëqyr ndryshimin e strukturave të tregut nëpërmjet kontrollit të përqendrimeve të ndërmarrjeve, të cilat realizohen nëpërmjet transaksioneve të shit-blerjes së aksioneve midis tyre, për të mos lejuar krijimin ose forcimin e pozitës dominuese në tregjet përkatëse.

Nxitja e konkurrencës së lirë të ndërmarrjeve në treg, përbën një nga objektivat e Ligjit, i cili realizohet edhe nëpërmjet instrumentit të advokacisë dhe aktiviteteve për rritjen e kulturës së konkurrencës. Eksperienca 10 vjeçare e Autoritetit të Konkurrencës ka treguar se rritja e efekteve në treg të Autoritetit të Konkurrencës dhe zbatimi me

efiçiensë i Ligjit, kërkon vlerësimin e akteve ligjore dhe nënligjore që lidhin me kufizimet sasiore në treg, apo me dhënien e të drejtave ekskluzive apo të veçanta.

Mirëfunksionimi i tregjeve kërkon kujdesin si për mirëqenien e konsumatorëve, ashtu edhe për t'i bërë tregjet sa më konkurruese. Një nga karakteristikat e ligjit të konkurrencës dhe e aktivitetit të institucionit të konkurrencës është gjithëpërfshirja dhe bashkëpunimi i faktorëve dhe i aktorëve, që është realizuar nëpërmjet bashkëpunimit të vazhdueshëm me Parlamentin, institucionet qendrorë dhe vendore, entet rregullatorë, bizneset e organizatat e tyre, si dhe shoqatat e mbrojtjes së konsumatorëve.

## **1.2 Përmbledhje ekzekutive**

Aktiviteti i Autoritetit të Konkurrencës dhe vendimmarrja e Komisionit të Konkurrencës është mbështetur në objektivat kryesore të përcaktuara për vitin 2014, Rezolutës së Kuvendit “Për veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës”, Raportin e Progresit të Komisionit European, si dhe në përgjigje të të gjithë ankesave të adresuara tek institucioni i konkurrencës apo shqetësimeve të konsumatorit të bëra publike nga mediat.

Objektivi i punës së Autoriteti i Konkurrencës edhe për vitin 2014 ka qenë trajtimi me profesionalizëm dhe objektivitet i rasteve të shqyrtuara, të cilat kanë qenë kryesisht nga ankesat, rritja e efikasitetit nëpërmjet procedurave hetimore, konsolidimin e profilit si institucion i pavarur dhe profesional, rritja dhe forcimi i kapaciteteve administrative, përafrimi i kuadrit nënligjor si dhe fillimi i punës për hartimin e Politikës Kombëtare të Konkurrencës.

Veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës është fokusuar kryesisht në evidentimin dhe hetimin e praktikave antikonkurruese, kryesisht marrëveshjeve të ndaluara dhe abuzimin me pozitën dominuese, vlerësimin ex-post të të drejtave ekskluzive, si dhe vlerësimin e akteve ligjore dhe nënligjore që kanë impakt mbi konkurrencën në tregje. Kështu, gjatë vitit 2014, janë **marrë 42 vendime** nga të cilat 2 vendime me masa administrative (gjobë), 1 vendim me kushte dhe detyrime; në 3 raste është hetuar për abuzim me pozitën dominuese; janë shumëfishuar rastet e hetimit për marrëveshje të ndaluara në 7 raste; 8 vendime janë autorizim për përqendrim, një vendim për përjashtim të marrëveshje nga ndalimi; 4 vendime për rekomandime ndaj institucioneve publike për aktet ligjore, dhe vendimet e tjera kanë qenë të natyrës procedurale.

**Rritja me më shumë se 2 herë e ankesave** drejtuar Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit 2014 (33 në total) përbën një zhvillim të rëndësishëm në drejtim të rritjes së kulturës dhe avokatisë së konkurrencës, pasi praktikat e vendeve të zhvilluara dhe anëtare të

bashkimit European sugjerojnë se shumica e procedurave hetimore (mbi 90 %) fillojnë në bazë të ankesave dhe aplikimit për lehtësim nga gjobat nga ana e ndërmarrjeve.

Gjatë vitit 2014 janë kryer disa **procedura hetimore** në tregjet: e telefonisë celulare; sigurimeve motorike; prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të karburanteve; transportit detar të automjeteve dhe udhëtarëve; blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes; importin dhe tregtimin me shumicë të duhanit të pakeluar; prokurimit e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Dibrës; si dhe prokurimeve të ndërtimit të pjesës së jashtme të Unazës së Madhe të Tiranës, aksi Sauk-Bregu i Lumit. Në të gjitha këto raste, Sekretariati i Autoritetit ka kryer inspektime në formën e *dawn raids* në të njëjtën kohë në të gjitha ndërmarrjet si dhe ka realizuar investigimin e dokumenteve në forme elektronike, për të cilën janë trajnuar dy inspektore (forensics) duke përmirësuar cilësinë e evidencave të administruara.

Gjithashtu, objekt i punës për vitin 2014 kanë qenë tregjet konkrete të rekomanduara edhe nga rezoluta e Kuvendit për rregullimin. Kështu, në lidhje me **tregu e telefonisë celulare**, është rritur bashkëpunimi me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për të marrë në konsideratë rekomandimet e Komisionit të Konkurrencës për rregullimin e tregut të shumicës (uljen e tarifave të terminimit) si dhe të pakicës (barazimi i tarifave dhe minutave brenda me jashtë rrjetit), rekomandime të cilat janë marrë në konsideratë dhe janë shprehur në vendimin e AKEP-it për analizën e tregut të telefonisë celulare.

**Në tregun e sigurimeve** risia e vitit 2014 lidhet me marrjen e angazhimeve nga shoqëritë të cilat janë kthyer në masa rregulluese dhe detyruese nga Komisioni i Konkurrencës për të vendosur kushtet e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Këto masa kishin të bënin kryesisht me lidhjen e marrëveshjeve me më shumë se një broker, fillimin e funksionimit të sistemit Bonus-Malus (tarifa e sigurimit sipas riskut), sigurimin e drejtpërdrejtë (pagesa e dëmeve të shoqëria ku je siguruar) etj. Këto angazhime kanë qenë objekt i monitorimit të mëtejshëm nga inspektorët e konkurrencës, nga të cilat rezultoi se shoqëritë e sigurimit kishin zbatuar kushtet dhe detyrimet e vendosura nga Komisioni i Konkurrencës pjesërisht, plotësimi i të cilave kërkonte ndërhyrjen e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe marrjen në konsideratë të rekomandimeve të Komisionit të Konkurrencës për miratimin e akteve nënligjore.

Në tregun e **karburanteve** Autoriteti i Konkurrencës ka zhvilluar një proces të plotë dhe objektiv mbi mënyrën e funksionimit të këtij tregu, shkallën e përqendrimit dhe ndikimin

që kishte në nivelin e konkurrencës si sjellja e ndërmarrjeve në treg, ashtu dhe aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë funksionimin e këtij tregu.

Pas shqyrtimit të raportit të hetimit të thelluar dhe pretendimeve të palëve në seancat dëgjimore rezultoi se gjatë periudhës objekt hetimi nuk u gjetën evidenca të mjaftueshme që të provonin marrëveshje të ndaluara apo abuzimi me dominancën kolektive midis ndërmarrjeve objekt hetimi. Megjithatë, konkurrenca në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të karburanteve nuk është mjaftueshëm efektive për shkak të strukturave të tregut dhe rregullimit ligjor të këtij tregu.

Komisioni i Konkurrencës, vendosi t'i rekomandojë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes rishikimin e Ligjit nr. 8450, datë 24.02.19991 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", duke i krijuar mundësi ndërmarrjeve që operojnë në tregun e shitjes me shumicë të eurodieselit dhe benzinës: (a) të realizojnë edhe shitjen me pakicë, duke eliminuar në këtë mënyrë hallkat e tepërta në zinxhirin e tregtimit, për të mundësuar uljen e kostove të pajustificuara ekonomike në krahasim me vlerën e shtuar të produktit; si dhe (b) të ruajnë identitetin e produktit dhe të konkurrojnë nëpërmjet logos respektive tek shitësit me pakicë, për të mundësuar nxitjen e konkurrencës efektive në këtë treg.

Një rekomandim tjetër lidhej me krijimin e bazës ligjore dhe infrastrukturës administrative të nevojshme, për një njësi të transparencës së çmimit të hidrokarbureve, në të cilën ndërmarrjet që operojnë në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të karburanteve duhet të njoftojnë në kohë reale brenda 5-15 minuta këtë njësi dhe Autoritetin e Konkurrencës për çdo ndryshim të çmimit të shitjes me shumicë.

Nga Organi Shtetëror i Autorizuar është kërkuar vlerësimi i zbatimit të marrëveshjes konçesionare në portin "Vlora 1" për respektimin e detyrimit të mospërfshirjes së konçesionarit në tregtimin e karburantit si dhe transferimin e së drejtës ekskluzive në tregjet e lidhura.

Gjithashtu, Sekretariati do të vazhdojë monitorimin e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë dhe pakicë për të ndjekur sjelljen e firmave në treg.

**Prokurimet publike** kanë qenë sërish nën monitorimin dhe hetimin e Autoritetit të Konkurrencës. Ndryshimi për vitin 2014 lidhet me një bashkëpunim më të ngushtë me Kontrollin e Lartë të Shtetit, i cili pas auditimit të ushtruar në Autoritetin Rrugor Shqiptar, kishte konstatuar se në procedurat e prokurimit publik për vitin 2013 me objekt "Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut –



Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3, të njëjtët operatorë ekonomikë të cilët kanë konkurruar për lotin e 1 dhe që janë skualifikuar, rezultojnë të dalin fitues mbi bazë rotacioni në lotet 2 dhe 3, duke konkurruar për të njëjtat kritere të vendosura për secilin lot, ku dhe diferenca në vlerë nga oferta në oferte është e papërfillshme. Bazuar në evidencat e paraqitura nga hetimi paraprak për elementët e marrëveshjes në oferta si rotacioni dhe afërsia me fondin limit në 12 shkurt 2015 vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun përkatës ndaj 6 shoqërive dhe bashkimit të përkohshëm të tyre (një grup me dy shoqëri dhe një me tre) për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregun përkatës.

**Në sektorin e energjisë elektrike** është realizuar monitorimi i tregut kryesisht për segmentin e parregulluar të blerjes së energjisë nga Operatori i Shpërndarjes për mbulimin e humbjeve dhe janë zbatuar procedurat hetimore dhe vendimmarrëse në këtë sektor, ndërkohë dhe janë zhvilluar seancat dëgjimore me OSHEE si dhe ankimesin. Ky rast është në shqyrtim për të vlerësuar mundësinë e kufizimit të tregut si shkak/pasojë të marrëveshjeve të mundshme vertikale.

Rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës për **liberalizimin dhe nxitjen e konkurrencës në tregun e energjisë elektrike** janë që nga viti 2009 e në vijim, dhe sa i përket vitit 2014, Autoriteti është shprehur me rekomandime konkrete ndaj Entit Rregullator të Energjisë (ERE). Këto rekomandime konsistojnë në miratimin e rregullores së posaçme për blerjen e energjisë nga OSHEE, ndarjen e tregjeve të shumicës me pakicën në prodhim dhe shpërndarje si dhe gjatë procesit të miratimit të tarifave të reja të energjisë për vitin 2015. Rekomandimet e Autoritetit janë gjetur të përshtatshme dhe janë përshëndetur nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, si dhe janë diskutuar në tryeza të rrumbullakëta me ERE-n, por jo gjithmonë është ecur me të njëjtën dinamikë në marrjen parasysht të këtyre rekomandimeve. Gjithashtu, është bashkëpunuar edhe me Ministrinë e Energjetikës në fazat e para të hartimit të Projektligjit “Për energjinë elektrike”. Pavarësisht nga mospërfshirja në tryezat vijuese të diskutimit të Projektligjit, Autoriteti i Konkurrencës ka qenë proaktiv dhe me rekomandime konkrete në këtë sektor prodhues.

**Në sektorin e transportit** gjatë vitit të kaluar janë zhvilluar procedurat e hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve nga ku rezultoi se ndërmarrjet e licencuara kanë pozitë dominuese sipas tregjeve gjeografikë për të cilët janë licencuar. Në konkludim të hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës ka vendosur t’i kërkojë ndërmarrjeve aktive në këtë treg të mbajnë të dhëna ditore transparente lidhur me tarifat e zbatuara për çdo biletë të shitur, si dhe të ruajnë rekorde të shitjeve të biletave për një periudhë 3 (tre) vjeçare të cilat duhet të

jenë transparente në çdo kohë nga ana e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, Autoriteti i Konkurrencës.

Autoriteti, pas realizimit të tryezës së rumbullakët me përfaqësuesit e Ministrisë së Transporteve dhe dakortësisë së tyre, vendosi t'i rekomandojë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës (i) realizimin e një studimi mbi përcaktimin e nivelit të tarifave maksimale për shërbimin e transportit detar ndërkombëtar për udhëtarë dhe automjete; (ii) t'ju kërkojnë dhe t'u miratohen ndërmarrjeve, gjatë procesit të licencimit të tyre, nivelet e tarifës maksimale që do të zbatohen për çdo kategori udhëtimi sipas stinëve; (iii) të realizojë mbikëqyrjen e tarifave të zbatuara nga ndërmarrjet, krahasuar me tarifën maksimale të miratuara si dhe (iv) të monitorojë, mbi bazën e periudhshmërisë tremujore (stinore), ndërmarrjet e licencuara, lidhur me tarifën e zbatuara për çdo biletë të shitur, si dhe detyrimin e operatorëve të licencuar për ruajtjen e rekordeve mbi shitjet e biletave për një periudhë 3 (tre) vjeçare.

Parlamenti Shqiptar nëpërmjet Rezolutës së Kuvendit, për vlerësimin e aktivitetit të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2013, është shprehur për vlerësimin ligjor të kufizimeve të konkurrencës nga shërbimet konçesionare të dhëna kryesisht si të drejta ekskluzive ose të veçanta. Në këtë mënyrë një nga aspektet e veprimtarisë së institucionit të konkurrencës ka qenë vlerësimi i koncesioneve të dhëna, vlerësim i cili ishte ex-post dhe u fokusua në vlerësimin ex-ante që duhet të realizohej përpara se këto marrëveshje konçesionare të jepeshin. Në mënyrë të detajuar konstatimet dhe rekomandimet e bëra nga Komisioni i Konkurrencës për secilin koncesion janë dhënë në seksionin II.6.

Gjatë vitit 2014 janë autorizuar **8 praktika përqendrimesh** të cilat nuk krijojnë apo forcojnë pozitën dominuese. Është pezulluar një procedurë përqendrimi pasi kishte mungesë informacioni dhe 7 praktika të tjera nuk kanë qenë objekt autorizimi pasi nuk plotësojnë kriteret e nenit 10 dhe /ose 12 të Ligjit.

Gjatë 2014 janë kryer **monitorime** sipas ankesave dhe me nismën e Autoritetit kryesisht në tregun e çimentos, duhanit dhe nënprodukteve të tij, gazit të lëngshëm, vajit të lulediellit, si dhe është kryer një studim tregu për produktet e akcizës.

Gjatë vitit të kaluar nuk ka pasur **ndryshime në legjislacionin** parësor por në përputhje me Planin Kombëtar për Integrimin Europian janë miratuar 2 aktet e mëposhtme nënligjore: Rregullorja "Për kategoritë e marrëveshjeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e transportit detar të mallrave"; si dhe Udhëzimi "Për

zbatueshmërinë e nenit 8 dhe 9 të Ligjit për pozitën dominuese”, të cilat synojnë konsolidimin e praktikave zbatuese të ligjit të konkurrencës.

Procesi i **rishikimit gjyqësor** të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës ka kaluar në një stad të ri gjatë vitit 2014, pasi filloi funksionimi i Gjykatës Administrative dhe ankimimi i vendimeve të Komisionit është adresuar në këtë gjykatë. Procedurat e rishikimit gjyqësor janë përshpejtuar në gjykatën administrative ndërkohë që ka patur një periudhë tranzitore të kalimit të çështjeve nga gjykata civile drejt asaj administrative duke vazhduar procedura të zgjatura për rastet që janë për gjykim në Gjykatën e Lartë.

Për vitin 2014 në total Autoriteti i Konkurrencës ka pasur për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë 8 çështje, nga të cilat 5 janë shqyrtuar dhe mbeten 3 për t’u shqyrtuar në 2015. Në Gjykatën Administrative të Apelit kanë qenë për shqyrtim 8 çështje, nga të cilat 4 janë gjykuar dhe mbeten 4 për t’u shqyrtuar në 2015. Në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë gjatë 2014 kanë qenë 11 çështje për gjykim, nga të cilat vetëm 1 është vendosur mospranim i Rekursit të paraqitur nga ndërmarrja Vodafone Albania SH.A, duke konfirmuar përfundimisht vendimin e AK-së dhe 1 (një) çështje është shqyrtuar, pas Rekursit të Autoritetit të Konkurrencës (AMC SHA), për të cilën Gjykata e Lartë ka vendosur kthimin për rigjykim në Gjykatën e Apelit, kurse 9 çështje janë për shqyrtim për 2015.

Gjatë vitit 2014 Autoriteti i Konkurrencës i ka dhënë rëndësi të veçantë **avokatisë** së Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” pasi janë dhënë rekomandime për disa akte ligjore dhe nënligjore dhe kryesisht në fushën e telekomunikacioneve, sigurimeve, energjisë elektrike. Në të gjitha rastet e dhënies së rekomandimeve janë organizuar tryeza të rumbullakëta me entet rregullatore si dhe me përfaqësues të institucioneve qendrore.

Autoriteti i Konkurrencës ka ndërmarrë një sërë aktivitete për rritjen e **kulturës**, është organizuar konferenca shkencore ndërkombëtare me rastin e 10 vjetorit të krijimit të institucionit ku morën pjesë personalitete të fushës së konkurrencës nga SHBA, BE, vendet e rajonit etj. Gjithashtu janë organizuar workshopet nëpër rrethe (Gjirokastër, Korçë dhe Shkodër) me përfaqësues të pushtetit lokal dhe biznesit, si dhe janë kryer publikime të cilat janë bërë pjesë edhe e bibliotekave të universiteteve.

Viti 2014 ka qenë viti i realizimit të procesit të vlerësimit të përmbajtjes dhe zbatimit të politikës dhe të ligjit të konkurrencës nga ekspertët e konkurrencës së UNCTAD. Ky proces vlerësimi është kërkuar në mënyrë vullnetare nga Autoriteti i Konkurrencës, për të identifikuar standartin e zbatimit të ligjit bazë , cilësinë e legjislacionit sekondar, si dhe praktikën e ndjekura nga institucioni shqiptar i konkurrencës, duke i krahasuar këto me

praktikat më të mira dhe standardet europiane. Ky raport do të jetë objekt diskutimi analitik në Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin, në korrik 2015.

Sa i përket **rritjes dhe forcimit të kapaciteteve** është shtuar stafi i Autoritetit të Konkurrencës me një inspektor dhe konkretisht në Sektorin e Përqendrimeve në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Tregut, ndërkohë që për forcimin e kapaciteteve janë kryer një sërë trajnimesh. Stafi i Autoritetit është trajnuar nga ICN, OECD, autoritete homologe (italian dhe austriak), OECD-Budapest, UNCTAD, BE, OECD (Paris), SETTO, ICN, Autoriteti Austriak, Taiex (Tirane) si dhe janë zhvilluar trajnime të brendshme të stafit për analizat ekonometrike. Përmirësimi i vazhdueshme dhe konsolidimi i njohurive dhe ekspertizës nga ana e specialistëve të Autoritetit konsolidohet si një faktor kyç për pavarësinë reale të institucionit të konkurrencës.

## **II. ZBATIMI I LIGJIT TE KONKURRENCES**

Autoriteti i Konkurrencës edhe gjatë vitit 2014 ka vepruar në zbatim të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka përdorur të gjithë instrumentat për të zbuluar praktikant antikonkurrese të ndërmarrjeve, për të identifikuar faktorët që ndikojnë në mirëfunktionimin e tregjeve dhe rivendosur konkurrencën në treg.

Ky seksion paraqet në mënyrë të detajuar të gjithë procedurat e realizuara nga institucioni i konkurrencës në zbatim të Ligjit, të grupuara sipas shtyllave kryesore të tij. Karakteristika kryesore e së drejtës së konkurrencës është që hetimi i kushteve të konkurrencës bazohet në ankesat e operatorëve të tregut.

### **II.1. ADMINISTRIMI I ANKESAVE**

Rritja me më shumë se dy herë e numrit të ankesave që i janë adresuar Autoritetit të Konkurrencës vlerësohet si një zhvillim pozitiv drejt standarteve të një autoriteti evropian të konkurrencës. Deri vitet e fundit shumica e rasteve hetimore fillonte me nismën e vetë Autoritetit, ndërkohë që tashmë vihet re një ndërgjegjësim i biznesit për rolin dhe ndikimin e autoritetit për vendosjen e rregullave të sjelljes në treg.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit 2014 janë paraqitur 33 ankesa kundrejt 16 të depozituara gjatë vitit 2013. Vlerësimi ligjor dhe ndjekja e rasteve të paraqitura si ankesa deri në zgjidhjen përfundimtare të tyre, ose vënien në dijeni të institucioneve përkatëse, nëse ato nuk kanë qenë drejtpërsëdrejti objekt i ligjit të konkurrencës, ka qenë objektiv i realizuar i Autoritetit të Konkurrencës.

Ankesat kanë qenë kryesisht në tregje të rregulluara si energjia dhe komunikimet elektronike dhe për këtë arsye Autoriteti i Konkurrencës ka bashkëpunuar ngushtësisht me entet rregullatore sipas parashikimeve të ligjeve respektive.

#### *Në sektorin e komunikimeve elektronike*

**1. Ankesa e ndërmarrjes “Plus Communication” SHA kundër ndërmarrjes “Vodafone Albania” SHA.** Sipas ankimesit pretendohet se firma me pozitë dominuese në treg ka aplikuar sjellje përjashtuese agresive me objektiv të qartë eliminimit të operatorëve të vegjël nga tregu në periudhën 01.01.2013-31.12.2013, duke penguar në mënyrë indirekte e të pakthyeshme zhvillimin e konkurrencës në sektorin e telefonisë celulare dhe në veçanti, në tregun e pakicës. Si rrjedhim, duke cenuar konsumatorët shqiptarë në një perspektive afatgjatë. Pas vlerësimit të ankesës u vendos hapja e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare ndaj

shoqërisë Vodafone SH.A, për të vlerësuar nëse ka shenja të kufizimit të konkurrencës sipas parashikimeve të nenit 9 të ligjit Nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, e cila u miratua nga Komisioni i Konkurrencës me vendimin përkatës, duke vendosur si periudhë hetimore 1 Janar – 31 Dhjetor 2013. Procedura e hetimit paraprak parashikohet të përfundojë brenda datës 14 shkurt 2015.

**2. Ankesat e ndërmarrjes ‘Plus Communication’ SH.A** - Ndërmarrja “Plus Communication” SHA është ankuar pranë Autoritetit të Konkurrencës “Mbi procesin e dhënies së të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT) dhe të Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP nr.2426, datë 04.03.2014, “Për miratimin e dokumentit për këshillim publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT)”. Ankimuesi u shpreh lidhur me procedurën që po ndiqej për dhënien e të drejtës së përdorimit të burimeve të kufizuara dhe shteruese në një treg të rregulluar dhe pasojat e ndjekjes së kësaj procedure për “Plus”, për tregun e telekomunikacionit në Shqipëri dhe përfitimet e konsumatorit.

Pas vlerësimit të shkresave të ndërmarrjes PLUS, konstatohet se Autoriteti i Konkurrencës në lidhje me brezat e frekuencave është shprehur me Vendimin nr. 161 datë 02.12.2010 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në sektorin e komunikimeve elektronike në tregun e teknologjisë me bazë të gjerë ‘3G’. Si përfundim, u arrit në konkluzionin që t’i dërgohej Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike, si dhe AKEP, VKK nr. 161, datë 02.12. 2010 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në sektorin e komunikimeve elektronike në tregun e teknologjisë me bazë të gjerë ‘3G’ për ta patur në konsideratë gjatë procesit të konsultimit publik me palët e interesuara dhe zbatimit të procedurës për dhënien në përdorim të frekuencave në brezat 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT)” për ti vënë në kushte të barabarta teknike dhe konkurrencë të gjithë operatorët celularë.

**3. Ankesa e Plus Communication ndaj ndërmarrjeve Vodafone, AMC dhe Albtelekom, në tregun e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare** – Ankimuesi pretendonte se ndërmarrjet Vodafone, AMC dhe Albtelekom, për periudhën shkurt 2012-23 shtator 2013, (dhe madje duke rifilluar nga shkurti 2014 dhe vijim), kanë hyrë në një marrëveshje të ndaluar duke bashkërenduar praktikat përkatëse dhe duke përjashtuar tërësisht në mënyrë diskriminuese, ndërmarrjen Plus nga mundësia për të tranzituar thirrje hyrëse ndërkombëtare drejt secilit prej tyre, në kontrast të plotë me sjelljen përkatëse (Vodafone dhe AMC) kundrejt Albtelekom. Për sa më sipër u realizua një monitorim në tregun e tranzitimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare. Në përfundim të monitorimit u konkludua se në treg nuk vëreheshin sjellje antikorruese nga ana e ndërmarrjeve.

**4. Ankesat e ndërmarrjes “Plus Communication” SHA për ndërprerjen e menjëhershme të ofrimit të paketave tarifore nën kosto nga ndërmarrja “Albtelekom” SHA** – Sipas ankimesit ofrimi i tarifave nën kosto, është një praktikë e padrejtë antikonkurruese dhe diskriminuese për operatorët e tjerë në treg dhe për përdoruesit e tjerë fundorë, duke shkelur hapur legjislacionin në fuqi. Nga vlerësimi i ankesës rezultoi se ndërmarrja Albtelekom nuk zotëronte pozitë dominuese në tregun e shërbimeve të telefonisë celulare me pakicë, pasi pjesa e tregut në të gjithë treguesit për 6 mujorin e parë 2013 shkon deri në 10% pjesë tregu. Pra në kushtet e mungesës së pozitës dominuese, nuk plotësohen kushtet e shkeljes së mundshme të nenit 9 (abuzim me pozitën dominuese) të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

**5. Ankesa e Plus Communication” për analizën e AKEP** – sipas ankimesit masat e marra nga AKEP nëpërmjet Vendimeve nr. 2431-2435, datë 13.04.2014 në lidhje me reduktimin e tarifave të terminimit të operatorëve celularë, nuk kane reflektuar konkluzionin e Vendimit nr. 303 të Autoritetit të Konkurrencës, dhe kanë qenë jo efektive për rregullimin e konkurrencës në treg. Pas vlerësimit të kësaj ankese është konkluduar se çështjet e ngritura nga Plus i takojnë organit rregullator AKEP dhe Autoriteti i Konkurrencës është shprehur për analizën e AKEP brenda afatit të kërkuar.

**6. Ankesa e operatorëve alternativë ndaj Albtelekom SH.A** - Ndërmarrjet “Espace” Sh.p.k, “Enkelana – Communication” Sh.p.k, “Rutel” Sh.p.k dhe “Orikum Telekommunications” Sh.p.k janë ankuar se ndërmarrja “Albtelekom” SHA ju ka dërguar në mënyrë ultimative të gjithë operatorëve shkresa për të pranuar kërkesat e kësaj ndërmarrjeje, kur midis palëve më datë 23.09.2013 është nënshkruar Amendamenti nr. 4, në lidhje me tarifën e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare të tranzituara nga rrjeti Albtelekom në vlerën 7 lekë/minutë. Nga vlerësimi i ankesës, rezultoi se në bazë të nenit 50 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, nëse sipërmarrësit nuk arrijnë të lidhin marrëveshjet përkatëse brenda 45 ditëve, atëherë mund t’i drejtohen AKEP-it, i cili fillon procedimin sipas Kodit të Procedurave Administrative dhe parashikimeve të nenit 60 të Ligjit dhe në përfundim nxjerr urdhrin përkatës sipas parashikimeve përkatëse. Pra, u konkludua se çdo ndërmarrje që ushtron veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike dhe ka mosmarrëveshje me ndërmarrjet e tjera lidhur me marrëveshjet e interkonjeksionit apo tarifave, duhet t’i drejtohet AKEP-it, si organi përgjegjës i përcaktuar nga Ligji për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis operatorëve.

**7. Ankesa e ndërmarrjes “AMC” SHA ndaj Eagle Mobile SHA për “Ofertën e Shën Valentin”** – Ankimesi shprehet se ndërmarrja Eagle Mobile SHA kishte hedhur në treg ofertën e quajtur “Oferta Shën Valentin” me target abonentët me parapagesë, e cila është një praktikë antikonkurruese, pasi sjell si pasojë shtrembërimin dhe pengimin e konkurrencës në treg dhe që dëmton në mënyrë të drejtpërdrejtë operatorët e tjerë në

këtë treg specifik. Lidhur me këtë ankesë, nga analiza e pjesëve të tregut, si dhe duke mbajtur parasysh parashikimet e nenit 8 të Ligjit të konkurrencës, ndërmarrja “Eagle Mobile” nuk zotëron pozitë dominuese në tregun e shërbimeve të telefonisë celulare me pakicë, pasi pjesa e tregut në të gjithë treguesit për 6 mujorin e parë 2013 shkon deri në 10% pjesë tregu. Duke qenë se nuk zotëron pozitë dominuese në tregun përkatës, nuk ekziston mundësia e abuzimit me pozitën dominuese, pra nuk plotësohen kushtet e shkëljes së mundshme të nenit 9 (abuzim me pozitën dominuese) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

**8. Ankesa e ndërmarrjes Iliria Telecom A ndaj operatorëve** - Pranë Autoritetit të Konkurrencës ndërmarrja “ILIRIA TELECOM A” ka paraqitur katër shkresa me Nr. Prot 35,36,37,38, datë 30.01.2014, protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me Nr. 48 Prot., datë 31.01.2014 si ankesa drejtuar AKEP ndaj ndërmarrjeve Albanian Mobile Communication Sh.a (AMC), Plus Communication Sh.a (Plus), Vodafone Albania Sh.a, Altelekom Sh.a. si dhe për dijeni Autoritetit të Konkurrencës (AK).

Referuar shkresave të ankuesit, në përputhje me kërkesat e Rregullores së AKEP Nr. 19 datë 14.06.2010 “Për aksesin dhe interkonjeksionit”, Ligjin 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në RSH” i ndryshuar dhe RIO-n e AMC, Plus, Vodafone Albania, Altelekom, në fuqi të datës 14.12.2013, të miratuara nga AKEP, të publikuara në faqet e internetit të këtyre ndërmarrjeve, Iliria telecom kërkuar lidhjen e marrëveshjes së interkonjeksionit direkte me qëllim dërgimin dhe marrjen e thirrjeve telefonike mes sistemeve teknike të ankimuesit dhe këtyre ndërmarrjeve. Shërbimet e kërkuara të këta operatorë janë shërbimi i thirrjeve kombëtare dhe atyre ndërkombëtare.

Lidhur me interkonjeksionit dhe terminimin e thirrjeve kombëtare Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 548/1 Prot të datës 13.2.2015 i ka kërkuar AKEP të shprehet lidhur me ankimimin administrativ të shoqërisë Iliria dhe të njoftojë Autoritetin e Konkurrencës lidhur me vendimin

#### *Në tregun e prokurimeve publike*

**9. Ankesa për prokurimet publike të Autoriteti Rrugor Shqiptar në ndërtimin e infrastrukturës** - Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit informon se nga auditimi i ushtruar nga KLSH në Autoritetin Rrugor Shqiptar, është konstatuar se në procedurat e prokurimit publik për vitin 2013 me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3, është konstatuar se të njëjtët operatorë ekonomikë të cilët kanë konkurruar për lotin e 1 dhe që janë skualifikuar, rezultojnë të dalin fitues mbi bazë rotacioni në lotet 2 dhe 3, duke konkurruar për të njëjtat kritere të vendosura në dokumentet standard të tenderit për secilin lot, ku dhe diferenca në vlerë nga oferta



në ofertë është e papërfillshme. Pas vlerësimit të dokumentacionit të administruar, Komisioni i Konkurrencës, u shpreh me Vendimin nr.333, datë 21/10/2014 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3, për periudhën hetimore vitin 2013.

**10. Ankesa për prokurimin publik të Fondacioni Shqiptar i Zhvillimit - Kontrolli i Lartë i Shtetit,** në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit na bën me dije se nga auditimi i ushtruar nga KLSH në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, ishte konstatuar se në procedurat e prokurimit publik për vitin 2013 me objekt “Rikonstruksion i rrugës Mollas – Selitë – Frashër” dhe “Rikonstruksion i rrugës Kthesa e Patosit – Roskovec”, nga krahasimi i ofertave të paraqitura për fazën e parakualifikimit, megjithëse tenderimi bëhet në dy faza, në atë parakualifikuese dhe tender, ofertuesit konkurrues në këto procedura prokurimi, gjatë ofertimeve të njëpasnjëshme, ndjekin parimin e rotacionit në të qënurit fitues. Vlerësimi ligjor i rastit është bërë në bazë të nenit 4 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe udhëzuesit të OECD “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, dhe në përfundim të vlerësimit u konstatua se nuk rezultojnë shenja të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës në procedurat e prokurimit publik me objekt “Rikonstruksion i rrugës Mollas – Selitë – Frashër” dhe “Rikonstruksion i rrugës Kthesa e Patosit – Roskovec” e ndërmjet ndërmarrjeve, sjellje të cilat mund të bien në kundërshtim me nenin 4, pika 1, germa a) të Ligjit nr. 9121, dt. 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar.

**11. Ankesa në tregun e ndërtimit -Ndërmarrja “Apollon Qeramika” Sh.p.k – Ndërmarrja “Apollon Qeramika” Sh.p.k,** e cila ushtron aktivitetin e saj në fushën e prodhimit të qeramikës, bën me dije se administratorët e 7 fabrikave të prodhimit të tullave që funksionojnë në Shqipëri, kanë krijuar një Union të fabrikave të tullave dhe tjegullave të Shqipërisë (U.F.T.T.SH). Ankuesi ngre pretendimin se anëtarët e Unionit kanë krijuar një treg mbi bazën e marrëveshjeve të fshehta për të imponuar çmime të larta në treg për konsumatorin shqiptar. Nga vlerësimi i ankesës si dhe dokumentacionit të administruar u konkludua se nuk u gjetën shenja të kufizimit të konkurrencës në kuptim të nenit 4 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” e cila mund të sillte si pasojë një marrëveshje ndërmjet ndërmarrjeve në tregun e prodhimit të produkteve të qeramikës.

*Ankesa në tregun e lojërave të fatit*

**12. Ndërmarrja “Lotaria Kombëtare” ankohet për konkurrencë të pandershme** Sipas ankimesit shoqëria Nacional SHA, tregon bileta gërvishtëse nën logon e saj. Shoqëria Nacional është e licencuar për organizimin e lojës “Bingo” nga ana e Njësisë

së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit. Biletat gërvishtëse në bazë dhe në përputhje me nenin 26.2 ç (i) të Ligjit nr. . 10033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, janë pjesë e lojërave të lotarisë kombëtare dhe si të tilla mund të hidhen në treg vetëm nga i licencuari i lotarisë kombëtare, pra vetëm nga Lotaria Kombëtare, e cila operon në bazë të Marrëveshjes së Licencimit të Lotarisë Kombëtare. Në përfundim të vlerësimit të ankesës u konkludua se problematika e ngritur trajtohet nga Ministria e Financave si palë në Marrëveshjen e Licencës për Lotarinë Kombëtare, ratifikuar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë me Ligjin nr. 95/2013, datë 04.03.2013 dhe Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, e cila mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë e subjekteve, që organizojnë lojëra fati në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin për këtë veprimtari dhe aktet nënligjore në fuqi dhe u njoftua ankimuesi se kjo problematikë nuk hyn në objektin e veprimtarisë të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe nuk përbën objekt shqyrtimi nga Autoriteti i Konkurrencës.

**13. Ndërmarrja “Nacional Bingo” ndaj Lotarisë Kombëtare** – Ankimuesi pretendonte se dhënia e licencës për Lotarinë Kombëtare, kompanisë austriake “Austrian Lotteries”, krijon monopol në tregun shqiptar të lojërave të fatit. Lidhur me pozitën dominuese në tregun përkatës, Ligji nr.9121, në nenet 8-9 të tij, vlerëson dhe ndëshkon abuzimin me pozitën dominuese të një ndërmarrjeje, por jo ekzistencën e pozitës dominuese. Ligji ‘Për lojërat e fatit’ përcakton se “Autoriteti i parashikuar nga ligji ka të drejtë të japë licencën “Lotari kombëtare” për një periudhë 10-vjeçare. Licenca/kontrata bëhet efektive pas miratimit nga Kuvendi. Kjo licencë është një e vetme dhe i jepet aplikantit, i cili përzgjidhet i pari në procesin e konkurimit, të zhvilluar sipas procedurave të përcaktuara në ligj dhe në aktet nënligjore, dalë në zbatim të tij”. Në këtë ligj janë përcaktuar dhe kategoritë e lojërave të fatit që janë përfshirë në licencën e lotarisë kombëtare. Në përfundim u konkludua se kategoritë e lojërave të fatit që i janë dhënë mbajtësit të vetëm të licencës së lotarisë kombëtare janë përcaktuar me ligj.

#### *Në tregun e transportit*

**14. Ankesa e ndërmarrjes “Magic Travel”** - Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes ka përcjellë ankesën e shoqërisë së transportit të udhëtarëve Magic Globe – Travel Sh.p.k, ku kërkohet ndërhyrja e menjëhershme për ndërprerjen e përdorimit të paligjshëm të linjës së autobusit Babrru – Paskuqan – Tiranë, duke pretenduar për konkurrencë të pandershme nga ana e shoqërisë “Henri Trans” Sh.p.k, pasi ndërhyr në itinerarin e përcaktuar në licencë duke sjellë një anomali në aktivitetin e përditshëm të shoqërisë “Magic Globe – Travel” sh.p.k. Nga vlerësimi i kësaj ankese, referuar dhe deklarimeve të ankimuesit, u konstatua se kjo problematikë mbikëqyrej nga Komuna Paskuqan, e cila bën lëshimin dhe revokimin e licencës si dhe kontrollin e

ndjekjes së itinerareve sipas licencës. Në përfundim iu kthye përgjigje ankimesit që kjo ankesë nuk hyn në objektin veprimtarisë të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”,(i ndryshuar) dhe nuk përbën objekt shqyrtimi nga Autoriteti i Konkurrencës.

*Në tregun e ruajtjes dhe sigurisë fizike*

**15. Ankesa e ndërmarrjes “Pelikan Security”-** Ankimesi pretendon se operatorët Dea Security dhe Nazëri 2000 nuk kanë zbatuar Vendimin nr. 240, datë 26.07.2012, të Komisionit të Konkurrencës, por e kanë thelluar më shumë konkurrencën e pandershme, konkretisht pika II e Vendimit, duke shkelur nenin 4 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar dhe monitorimi i tregut sipas parashikimeve të nenit 28 të Ligjit nuk u gjetën shenja të kufizimit të konkurrencës në kuptim të një marrëveshje në oferta ndërmjet ndërmarrjeve “Nazëri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k.

**16. Ankesa e ndërmarrjes “Grand Security”** - Pranë Autoritetit të Konkurrencës u paraqitën disa shqetësime mbi kufizimin e mundshëm të konkurrencës në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Dibrës. Pas vlerësimit të ankesës, Komisioni i Konkurrencës, u shpreh me Vendimin 306, datë 19.02.2014 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Qarkun e Dibrës”, për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës, për periudhën e hetimit nga janari 2012 deri në janar 2014. Më shumë detaje për procesin paraqiten në vijim të këtij raporti (në pjesën II.2.4).

**17. Ankesa e personit fizik “Bilbil Hajdini” ndaj ndërmarrjes “Digitalb” SHA** - Personi fizik “Bilbil Hajdini” ka paraqitur ankesën e tij ndaj ndërmarrjes “Digitalb” SHA (DGA), e cila ushtron veprimtarinë si platformë digjitale tokësore dhe satelitore. Sipas ankuesit DGA ka abuzuar me pozitën dominuese, sipas Ligjit. Lidhur me këtë ankesë, nga Autoriteti i Konkurrencës, ju kërkua informacion ndërmarrjes “Digitalb” SHA. Referuar shkresës së Digitalb SH.A, kërkimi i të drejtës së ekskluzivitetit kryhet, pasi pjesa më e madhe e kanaleve që ofron platforma Digitalb janë në pronësi të tij dhe për këto kanale vetëm ai vlerëson mënyrën se si do të ofrohen për publikun. Gjithashtu, Digitalb SH.A. ka kryer edhe një vlerësim të marrëveshjes midis Digitalb SH.A. dhe televizioneve kabllore, duke renditur përfitimit nga marrëveshja për operatorin kabllor, konsumatorin final dhe kanalet televizive kombëtare, si dhe duke kufizuar shpërndarjen e piraterisë, sepse sipas Digitalb SH.A, 95% e tregut të platformave, që mbartin kanale, janë pirate. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se në kuptim të Ligjit nuk vërehen shenja të ndonjë kufizimi të mundshëm të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

**18. Ankesa e ndërmarrjes “Dinamo “për tregun e shitjes me shumicë -** Ndërmarrja “Dinamo” ankohet ndaj ndërmarrjes Ekma Albania sh.p.k, në lidhje me krijimin e një tregu ne autostradën Tiranë-Durrës. Lidhur me këtë ankesë u realizua një takim me përfaqësuesin e shoqërisë Ekma Albania sh.p.k, e cila ushtron aktivitetin e saj si subjekt që jep me qera ambiente në tregun agroushqimor me shumicë në autostradë. Sipas përfaqësuesit të kësaj shoqërie nuk aplikohen tarifa shtesë për marrjen e ambienteve me qera në këtë treg. Kjo shoqëri ka ndjekur të gjitha procedurat ligjore për marrjen e një sërë lejesh për ushtrimin e aktivitetit. Referuar ankesës rezultoi se aktiviteti i ndërmarrjes Dinamo është mbyllur nga institucionet publike për arsye të ndryshme dhe ligjërisht ndërmarrja Dinamo duhet të ankimonte në rruge administrative dhe/ose gjyqësore vendimet e këtyre institucioneve. Për sa më sipër ankesa e shoqërisë Dinamo nuk bie në fushën e veprimtarisë së Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” pasi tregjet e shitjes me pakicë janë të shumtë dhe ka mundësi të madhe zgjedhjeje.

**19. Ankesa e ndërmarrjes “EUROTEAM” sh.p.k –** Ankimuesi operon në tregun e shërbimit të mbledhjes dhe përpunimit të mbetjeve spitalore, ka paraqitur ankesën e tij duke pretenduar se inspektorët e agjencisë rajonale të mjedisit Tiranë, kanë vepruar ne shpërdorim të detyrës duke mundësuar krijimin e monopoleve dhe frenimin e konkurrencës së lire në këtë treg. Autoriteti i Konkurrencës hapi procedurën e monitorimit në tregun e shërbimit të mbledhjes dhe përpunimit të mbetjeve spitalore, duke siguruar informacion në lidhje me mbetjet spitalore të përpunuara (sasinë, çmimin dhe kompaninë kontraktuese për periudhën 2011-mars 2014) nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, kompania “Meditel” sh.p.k dhe kompania “Euroteam” sh.p.k. Për një vlerësim sa më të plotë të tregut të përpunimit të mbetjeve spitalore grupi i punës shkoi në teren për të parë në vend çfarë ndodh me përpunimin dhe problematikën e këtij tregu. Në fund të procesit të monitorimit rezultoi se në tregun e përpunimit të mbetjeve spitalore nuk jemi në kushtet e një operatori në treg pasi operojnë dy operatorë të licencuar, ndërkohe që është duke u futur në treg (duke u licencuar) një operator i tretë, si edhe janë të instaluar 6 autoklava në spitalet rajonale të cilat përpunojnë mbetje spitalore. Për këto arsye u konkludua me mbylljen e procedurave të monitorimit dhe i është kthyer përgjigje ankimuesit.

**20. Ankesa në tregun e grumbullimit të sherbelës në zonën e Malësisë së Madhe** Ankimuesi pretendonte se ndërmarrjet e grumbullimit të sherbelës kishin ulur çmimin e blerjes në mënyrë të konsiderueshme. Sekretariati i Autoritetit realizoi monitorimin e tregut, ku qëllimi ishte vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve të grumbullimit dhe efektet në tregun e kultivimit dhe tregun e integruar të eksportit për të parë nëse ka shenja të kufizimit të konkurrencës si pasojë e mundësisë së koordinimit të sjelljes dhe/ose abuzimit me pozitën dominuese të ndërmarrjeve aktive në tregjet përkatëse. Nga procedurat e vlerësimit të ankesës rezultoi se çmimet e grumbullimit dhe çmimet e

shitjes në tregun ndërkombëtar janë të ndryshme për ndërmarrjet dhe nuk rezultuan shenja të një ndarje të mundshme të tregut në kuptimin gjeografik, shenja të koordinimit të sjelljeve për të kufizuar ofertën apo për të ulur çmimin e grumbullimit. Si konkluzion, nga vlerësimi i rastit nuk rezultuan shenja të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës ndërmjet ndërmarrjeve grumbulluese dhe eksportuese, sjellje të cilat bien në kundërshtim me nenet 4 dhe 9 të Ligjit për të filluar procedurën e hetimit paraprak sipas përcaktimeve të nenit 42 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

**21. Ankesa e ndërmarrjes Agon Channel mbi zbatimin e Ligjit “Për TVSH” -** Shoqëria ka paraqitur një ankesë ku i drejtohet Autoritetit të Konkurrencës të ndërhyjë për vendosjen e kushteve të barabarta, pra jo diskriminuese, në ushtrimin e aktivitetit, sipas Ligjit nr.7928, datë 24.07.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar. Pas shqyrtimit të ankesës, Autoriteti i Konkurrencës informoi ankimuesin që problematika e ngritur trajtohet nga administrata doganore dhe nuk hyn në objektin e veprimtarisë të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

**22. Ankesa e ndërmarrjes “Huawei Technologies” për konkurrencë të pandershme –** Ankimuesi shprehu shqetësime në lidhje me konkurrencën në shitjen e produkteve të markës “HUAËEI” ku na bën me dije se duke filluar që prej vitit 2014, është bërë prezente në tregun shqiptar të tregtimit të produkteve Huawei (telefona celulare), nëpërmjet shitësve të autorizuar në këtë treg, partnerë të “Huawei Technologies Albania “ Sh.p.k, siç janë Albtelekom, Vodafone Albania dhe Neptun, subjekte të cilave u janë transferuar të drejtat e tregtimit, shpërndarjes, reklamimit dhe mirëmbajtjes së këtyre produkteve. Pas shqyrtimit të ankesës, Autoriteti i Konkurrencës informoi ankimuesin që problematika e ngritur nuk hyn në objektin veprimtarisë të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe nuk përbën objekt shqyrtimi nga Autoriteti i Konkurrencës.

**23. Ankesa e ndërmarrjes “Tring TV” për transmetimin ekskluziv –** ankimuesi u shpreh në lidhje me transmetimin e një ndeshje televizive. Sipas ankuesit, Radio Televizioni Shqiptar nuk ka filluar transmetimin e kësaj ndeshje, por ka transmetuar spote publicitare për transmetimin e saj, në një platformë private, dhe me tej ka filluar një transmetim nën logon e një prej kanaleve të kësaj platforme private, duke sjellë në këtë mënyrë nxitje dhe inductim të drejtpërdrejtë të publikut, për blerjen e këtij shërbimi nga publiku kundrejt një operatori të caktuar privat. Nga shqyrtimi i ankesës u konkludua se problematika që ngre ankimuesi trajtohet nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, në përputhje me Ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili rregullon dhe mbikëqyr veprimtarinë radiotelevizive në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjisllacionin për këtë veprimtari dhe aktet nënligjore në fuqi, të cilit i është drejtuar kjo ankesë, dhe ju kthye përgjigje ankimuesit

se kjo problematikë nuk hyn në objektin e veprimtarisë të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

**24. Ankesa e ndërmarrjes “Gaz Group Sh.p.k” për prokurimin e gazit** - Në ankesën e saj shoqëria “Gas Group Sh.p.k”, i referohet Ligjin 8450, datë 24/02/1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, si dhe Ligjit “Për prokurimin publik” duke sqaruar se “në procedurën e tenderimit të realizuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve “Negocim pa shpallje paraprake” për blerje gazi të lëngshëm me ndërmarrjen “A&V Gaz”, SH.A me nr. 18/04/, datë 26/02/2014 dhe me vlerë 4.097.198,424 lek me TVSH, janë shkelur procedurat në kriteret e përcaktuara në tenderë nga ana e autoritetit kontraktor. Nga vlerësimi ligjor i ankesës rezulton se problematika që ngre ankimesi lidhet me Autoritetin Kontraktor, Komisionin e Prokurimit Publik dhe problematikat që trajtohen në Ligjin “Për prokurimin publik” si dhe me diskutimin nëse shoqëritë SH.A të licencuara për tregtim me shumicë duhet të marrin pjesë ose jo në procedurat e prokurimit publik. Problematikat e ankimesit iu adresuan Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Hidrokarbureve) si organi i ngarkuar me ligj për dhënien e lejeve dhe autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre

**25. Ankesa në tregun farmaceutik: Shoqata e farmacistëve vs Berlin Chemie** Shoqëritë farmaceutike “Actavis”, “Bilim Ilac”, “Sandoz”, “Alkaloid”, “Nobel Ilac”, “Alvogen”, “Replek”, “Hemo Farma”, “Abdi Ibrahim” dhe “KRKA” pretendojnë se shoqëria “Berlin-Chemie Meranini” ka nisur një fushatë antireklamë në dëm të operatorëve të tjerë, si dhe kompanive që ato përfaqësojnë. Nga vlerësimi i ankesës u konstatua se pretendimi i ankimesve qëndron në kryerjen nga ana e “Berlin-Chemie Meranini” të praktikave të padrejta tregtare çorientuese (konkretisht publicitetet çorientuese), të cilat mund të bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9902, datë 17. 04. 2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” dhe kjo ankesë u adresua në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për tu shqyrtuar nga Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit si dhe u njoftua ankimesi.

## **II.2 MARRËVESHJET E NDALUARA**

Në kuptim të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” marrëveshjet e ndaluara konsiderohen marrëveshjet e çdo forme të lidhur midis ndërmarrjeve, vendimet ose rekomandimet e grupeve të ndërmarrjeve, si dhe praktikat e bashkërenduara midis tyre, të cilat veprojnë në të njëjtin nivel apo në nivele të ndryshme, apo konsensus ndërmjet palëve, të cilat kufizojnë apo shtrembërojnë konkurrencën.

## **II.2.1 Hetim në tregun e sigurimit të detyrueshëm**

Bazuar në disa sinjale të marra nga tregu i sigurimeve, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës me kërkesën e Komisionit të Konkurrencës në fund të vitit 2013 ka monitoruar tregtimin e policës së sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë nga palëve të treta. Nga ky monitorim rezultoi se nga data 1 Nëntor 2013 të gjithë agjentët e shitjes i tregtonin këto polica nëpërmjet një sistemi që quhej MSHM dhe menaxhohej nga një subjekt që është i licencuar nga AMF si shoqëri brokerimi. Ky sistem në momentin e nisjes së veprimit të shitjes tek agjentët nuk të ofronte të gjitha kompanitë e licencuara për tregtimin e produktit përkatës, por një numër më të kufizuar.

Komisioni i Konkurrencës, me anë të Vendimit nr. 297, datë 18.11.2013 u shpreh për hapjen e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta, për të identifikuar shenjat e kufizimit potencial të konkurrencës në tregun përkatës. Procedurat e hetimit paraprak në tregun e sigurimeve përfunduan më 17 Janar 2014. Duke marrë në konsideratë ndjeshmërinë e tregut dhe kërkesën e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), se do të ishte në interes të stabilitetit financiar të tregut të sigurimeve mbajtja parasysh e karakteristikave dhe brishtësisë të sistemit financiar të sigurimeve, veçanërisht sigurimeve të detyrueshme, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës propozoi mbajtjen nën monitorim të tregut të sigurimeve sipas parashikimeve të nenit 28 të Ligjit. Gjatë periudhës monitoruese, në median e shkruar të datës 12.02.2014, u shpreh shqetësimi publik për rritjen e tarifave të sigurimeve të makinave më datë 11 Shkurt 2014. Nga monitorimi i menjëhershëm i tregut rezultoi se primet e aplikuara ishin rritur ndjeshëm, në të njëjtën kohë nga të gjitha shoqëritë e sigurimit dhe në një masë të përafërt për kategoritë përkatëse. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 305, datë 14.02.2014, vendosi për zgjatjen e periudhës hetimore të hetimit paraprak për tregun e sigurimeve të detyrueshme për përgjegjësitë ndaj palëve të treta deri më datë 28.02.2014.

Bazuar në gjetjet e raportit të hetimit, ku rezultoi se sjellja e ndërmarrjeve mund të ketë patur si objekt ose pasojë kufizimin, kontrollimin e tregut, ndarjen e tregut, si dhe caktimin në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose të tërthortë të çmimeve (primeve) të shitjes të produktit të policës së sigurimit për mjetet motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 43 të Ligjit, me anë të Vendimit nr. 310, datë 31.03.2014 vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta” ndaj ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë në këtë treg.

Ndërmarrjet që operojnë në tregun përkatës gjatë procedurës së hapjes së hetimit të thelluar si dhe në përfundim të tij kanë shprehur pretendimet e këndvështrimet e tyre në

lidhje me gjetjet e raportit të hetimit, si dhe mbi faktorët dhe rolin e AMF-së në mirë funksionimin e këtij tregu.

Shoqëritë e sigurimit (me përjashtim të “SIGMA” SH.A.) kanë shprehur angazhimet e tyre për të zbatuar rregullimet e propozuara në raportin e hetimit të thelluar. Në mënyrë të përmbledhur këto angazhime konsistojnë në: Pagesa e dëmeve sipas shoqërive ku është siguruar mjete motorik, i cili parashikohet edhe në Ligjin 10076; Zbatimi konkret i sistemit Bonus-Malus për përcaktimin e primeve individuale të shitjes për produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik; Trajtimi i drejtpërdrejtë i dëmit nga shoqëria e sigurimit do ta zhvillonte konkurrencën mes shoqërive për produktet e tyre duke nxitur konkurrencën jo vetëm të tarifa e ofruar, por edhe mbi pagesën e dëmeve për produktin e siguruar që është dhe qëllimi kryesor i çdo blerje të riskut nga shoqëria e sigurimit të siguruari; Nga ana e të gjitha ndërmarrjeve është konfirmuar se ka filluar testimi i sistemit të individualizuar të sigurimit të detyrueshëm Bonus Malus dhe ky testim do të përfundojë në 22 gusht 2014 për tu bërë funksional për tregun.

Si konkluzion, në zbatim të qëllimit të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” për përcaktimin e sjelljes së ndërmarrjeve për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në treg, Komisioni i Konkurrencës ka gjykuar se sjellja e ndërmarrjeve në treg bie në kundërshtim me parimet e konkurrencës së lirë dhe efektive, duke rritur në masë të njëjtë dhe fiksuar për një periudhë tre ditore primet e shitjes së produktit MTPL, si dhe duke përdorur sistemin e shitjeve të përqendruara nëpërmjet Star Broker për të ruajtur pjesët e tregut. Për të patur një efekt real në ndërhyrjen në këtë treg, bazuar në nenin 45/2 të Ligjit, Komisioni i Konkurrencës shprehet me kushte dhe detyrime, për të gjitha ndërmarrjet objekt hetimi, si instrument për rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik.

Shoqëritë e sigurimit duhet të përmbushin brenda 90 ditëve nga marrja e këtij vendimi kushtet dhe detyrimet si: Vënie në funksionim të programit Bonus-Malus për sistemin e individualizuar të sigurimit të detyrueshëm bazuar në të dhënat e të siguruarit, mjetit, historikut të dëmeve të shkaktuara dhe vendndodhjes; Në sistemin e ofruar nga shoqëritë e brokerimit dhe agjentët e shoqërive të sigurimit duhet të shfaqen në kohë reale logot e të gjitha shoqërive të sigurimit me të cilat agjenti ose brokeri ka marrëveshje për tregtimin e policës së sigurimit të detyrueshëm motorik; Të zbatojnë parashikimin ligjor për pagesën e dëmit nga siguruari i drejtpërdrejtë; Të lidhin marrëveshje me më shumë se 1 shoqëri brokerimi sipas kriterëve të parashikuara nga AMF-ja lidhur me sistemin online të sigurimeve të detyrueshme dhe sistemit bankar për pagesat sipas legjislacionit në fuqi; Shtypja dhe tregtimi i policave të sigurimit me logon e secilës ndërmarrje. Mos përmbushja e këtyre kushteve dhe detyrimeve sipas nenit



45/2 të Ligjit do të sjellë si pasojë vendosjen e masës së gjobës për shkelje të rënda deri në 10 për qind të xhiros sipas nenit 74, pika 1, germa c e Ligjit.

Gjithashtu, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 325, datë 30/07/2014, i ka dhënë rekomandime rregullatorit, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për nxitjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës gjatë muajit nëntor 2014 ka monitoruar zbatimin e Vendimit nr. 324, datë 30.07.2014, të Komisionit të Konkurrencës mbi kushtet dhe detyrimet ndaj shoqërive të sigurimit për rivendosjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik. Nga monitorimi rezultoi se kushtet dhe detyrimet e vendosura nga Komisioni i Konkurrencës janë përmbushur nga ana e ndërmarrjeve, ndërsa për detyrimin për sistemin Bonus Malus dhe detyrimin e vendosur për pagesën e dëmit nga siguruesi i drejtpërdrejtë, nevojitet ndërhyrja e AMF dhe miratimi i akteve nënligjore nga ana e saj.

## **II.2.2 Hetimi paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve**

Në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit nr. 316, datë 23.05.2014, vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve”. Sekretariati realizoi inspektimet e nevojshme në treg si dhe kërkoi informacion nga ndërmarrjet.

Pas analizës së të dhënave dhe informacionit të disponuar rezultoi se: Ndërmarrja AFH SPA/Adria Ferries ka pozitë dominuese në nëntregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve dhe automjeteve nga Porti i Durrësit drejt Portit të Ankonës/Trieste, pasi është i vetmi operator që operon në këtë nëntreg, dhe referuar analizës së sjelljes së ndërmarrjes AFH Spa rezultoi se nuk kishte shenja të abuzimit me pozitën dominuese të saj, sipas nenit 9 të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Ndërmarrja NorthBay LDA/Gerverni Travel dhe NorthBay/Euroferries Sh.p.k ka pozitë dominuese në nëntregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve dhe automjeteve nga Porti i Durrësit/Vlorës drejt Portit të Brindisit pasi është i vetmi operator që operon në këtë nëntreg.

Komisioni i Konkurrencës ka vendosur t'i kërkojë ndërmarrjeve aktive në këtë treg të mbajnë të dhëna ditore transparente lidhur me tarifat e zbatuara për çdo biletë të shitur, si dhe të ruajnë rekorde të shitjeve të biletave për një periudhë 3 (tre) vjeçare të cilat duhet të jenë transparente në çdo kohë nga ana e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës si dhe Autoritetit të Konkurrencës.

Autoriteti vendosi t'i rekomandojë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës (i) realizimin e një studimi mbi përcaktimin e nivelit të tarifave maksimale për shërbimin e transportit detar ndërkombëtar për udhëtarë dhe automjete; (ii) t'ju kërkojnë dhe tu miratohen ndërmarrjeve, gjatë procesit të licencimit të tyre, nivelet e tarifës maksimale që do të zbatohen për çdo kategori udhëtimi sipas stinëve; (iii) të realizojë mbikëqyrjen e tarifave të zbatuara nga ndërmarrjet, krahasuar me tarifat maksimale të miratuara si dhe (iv) të monitorojë, mbi bazën e periudhshmërisë tremujore (stinore), ndërmarrjet e licencuara, lidhur me tarifat e zbatuara për çdo biletë të shitur, si dhe detyrimin e operatorëve të licencuar për ruajtjen e rekordeve mbi shitjet e biletave për një periudhë 3 (tre) vjeçare.

Aktualisht, të gjitha gjetjet dhe rekomandimet e Komisionit të Konkurrencës janë diskutuar me Ministrinë e Transporteve dhe janë pranuar prej tyre, duke cilësuar rëndësinë e vazhdimin të bashkëpunimit për të mundësuar zbatimin konkret të tyre.

### **II.2.3 Hetimi paraprak në tregun e prokurimit publik “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë.**

Shkak për nisjen e procedurave hetimore u bë shkresa e dërguar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, me nr. 341 Prot., datë 06.08.2014, i cili në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit na bën me dije se: Nga auditimi i ushtruar nga KLSH në Autoritetin Rrugor Shqiptar, është konstatuar se në procedurat e prokurimit publik për vitin 2013 me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3, është konstatuar se të njëjtët operatorë ekonomikë të cilët kanë konkurruar për lotin e 1 dhe që janë skualifikuar, rezultojnë të dalin fitues mbi bazë rotacioni në lotet 2 dhe 3, duke konkurruar për të njëjtat kritere të vendosura në DST për secilin lot, ku dhe diferenca në vlerë nga oferta në oferte është e papërfillshme.

Bazuar në vlerësimin e këtij informacioni nga Sekretariati, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 333, datë 21/10/2014 u shpreh “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti

3, për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës, për periudhën hetimore vitin 2013.

Sekretariati ka realizuar procedurat hetimore në përputhje me Ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës”, “Kodin e procedurave” dhe “Rregulloren e procedurave investigative” si dhe në Metodologjinë që aplikon OECD për luftën ndaj koordinimit të ofertave në prokurimet publike (OECD - Guidelines For Fighting Bid Rigging In Public Procurement).

Autoriteti i Konkurrencës pas zhvillimit të procedurave të hetimit paraprak në fund të vitit 2014 dhe shqyrtimit të elementëve të marrëveshjes në oferta si rotacioni dhe afërsia me fondin limit në 12 shkurt 2015 vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun përkatës ndaj 6 shoqërive dhe bashkimit të përkohshëm të tyre (një grup me dy shoqëri dhe një me tre) për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregun përkatës.

#### **II.2.4 Hetimi paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Dibrës.**

Duke marrë shkas nga disa shqetësime të paraqitura pranë Autoritetit të Konkurrencës mbi kufizimin e mundshëm të konkurrencës në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Dibrës, Komisioni i Konkurrencës, u shpreh me Vendimin nr.306, datë 19.02.2014 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Qarkun e Dibrës”, për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës, për periudhën e hetimit nga janari 2012 deri në janar 2014.

Për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjeve në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, u vlerësuan të dhënat e siguruara nga autoritetet kontraktore, pasi gjatë inspektimeve të befasishme të realizuara në ndërmarrjet e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Dibrës nuk u gjet asnjë evidencë që të vërtetonte bashkëpunimin në përgatitjen e ofertave në procedurat e prokurimit publik. Pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së hetimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të dërguar nga autoritetet kontraktore përkatëse, rezultoi se nuk u gjetën evidenca direkte dhe indirekte të bashkëpunimit midis ndërmarrjeve në përgatitjen e ofertave në procedurat e prokurimit publik në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Dibrës (për periudhën objekt hetimi), duke mos pasur në këtë mënyrë shenja të një kufizimi të mundshëm të nenit 4 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Si përfundim, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 317, datë 23.05.2014, vendosi mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Dibrës, pasi nuk kishte shenja të kufizimit të

konkurrencës në bazë të nenit 4 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

### **II.2.5 Hetimi paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve të duhanit**

Në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit nr. 302, datë 14.01.2014, vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve të duhanit”.

Grupi i Inspektimit gjatë periudhës së hetimit kreu inspektimet e nevojshme pranë ndërmarrjeve që operojnë në treg. Pas analizës së të dhënave dhe informacionit të disponuar rezultoi se në tregun e cigareve në Shqipëri ka 140 lloje të ndryshme paketash. Tregu i importit të duhanit ka strukturë oligopolistike duke qenë se në treg operojnë 5 firma të mëdha. Por bazuar në pjesët e tregut të ndërmarrjeve nën hetim, sjelljes së pavarur të ndërmarrjeve në treg, fuqisë kundërvepruese të blerësve, pengesave të hyrjes në tregun përkatëse, u konkludua se asnjë nga ndërmarrjet objekt hetimi që ushtrojnë veprimtari në tregun përkatës, nuk përmbushin kriteret e nenit 8 duke mos zotëruar pozitë dominuese në tregun përkatës dhe si pasojë nuk mund të ketë abuzuar me pozitën dominuese. Nga inspektimet e kryera nuk u gjet asnjë evidencë direkte lidhur me bashkëpunimin e mundshëm midis ndërmarrjeve. Kjo u vërtetua dhe nga analiza e bërë. Në përfundim të procedurës së hetimit paraprak u vendos mbyllja e hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit, shitjes me shumicë dhe pakicë të duhanit dhe mbajtjen në monitorim të tij për shkak të strukturës së tij oligopolistike.

## **II.3 PËRJASHTIM NGA NDALIMI I MARRËVESHJEVE**

Ligji “Për mbrojtjen e konkurrencës” ofron instrumentin që tu mundësojë ndërmarrjeve të bashkëpunojnë në favor të uljeve të kostove apo të ofrimit të një investimi, duke i përjashtuar nga ndalimi pas një procesi vlerësimi dhe autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### **II.3.1 Përjashtim nga ndalimi i marrëveshjes “Digitalb - Operatore televiziv”**

Autoriteti i Konkurrencës në përputhje me nenin 5 dhe 48 e në vijim të Ligjit, ka marrë njoftimin nga ndërmarrja Digitalb SH.A për kërkesën për përjashtim nga ndalimi të marrëveshjes “DIGITALB – OPERATOR TELEVIZIV” me objekt mbartja e kanaleve TV ne platformën numerike Digitalb. Qëllimi i marrëveshjes është përfshirja në platformën satelitore të kanaleve televizive të 14 operatorëve televizivë, i cili konsiston në ritransmetimin e sinjalit të kanalit në valë satelitore në kohë reale (live) dhe pa asnjë

ndërhyrje në kanal in origjinal. Me marrjen e informacionit të plotë është publikuar një njoftim paraprak për shtyp në faqen e internetit të Autoritetit të Konkurrencës për shprehjen e interesit nga palët e treta. Gjatë periudhës 30 ditore të publikimit nuk ka patur asnjë reagim nga palë të treta në adresat e publikuara të Autoritetit të Konkurrencës.

Nga vlerësimi i marrëveshjes së paraqitur për përjashtim, pas një analize të hollësishme të përfitimeve dhe kufizimeve të marrëveshjes, konkludohet se marrëveshja ka si objekt dhe pasojë disa kufizime të konkurrencës, por nga krahasimi i përfitimeve me kufizimet e marrëveshjes, arrihet në konkluzionin se sipas parashikimeve të nenit 5 të Ligjit dhe udhëzimit për vlerësimin e marrëveshjeve vertikale, marrëveshja plotëson kushtet për përjashtim nga ndalimi pasi: akses i abonentëve të kanalet kombëtare dhe lokale është i mundshëm, pavarësisht transmetimeve të Digitalb, dhe kjo e fundit ka rritur mbulimin gjeografik nëpërmjet ritransmetimit për kanalet kombëtare dhe lokale; marrëveshja vertikale kontribuon për përmirësimin e shpërndarjes, duke qenë se i ofron publikut një mundësi shtesë (edhe në zonat e pambuluara me sinjal analog të televizioneve të licencuara); marrëveshja vertikale i lejon konsumatorit të ketë një pjesëmarrje të drejtë në këto përfitime; marrëveshja vertikale nuk i vendos ndërmarrjeve nënshkruese kufizime vertikale, të cilat nuk janë të nevojshme për arritjen e këtyre përfitimeve; nuk kufizon në mënyrë të ndjeshme konkurrencën në lidhje me produktet/shërbimet objekt i marrëveshjes; kohëzgjatja e marrëveshjes do të jetë për një periudhë të kufizuar, deri në fund të vitit 2015, që përkon me fundin dhe vetshfuqizimin e kontratave mes palëve lidhur mbi bazën e marrëveshjes së përjashtuar.

Lidhur me kriterin e ekskluzivitetit, për të cilin disa nga palët sollën përgjigje se është kryer mbi bazën e përfitimeve të dyanshme dhe me vullnet të plotë dhe se ka argumente (si p.sh. mbrojtja e të drejtës së autorit dhe rritja e cilësisë së transmetimit) për kufizimin e vendosur për ekskluzivitetin është i nevojshëm për arritjen e marrëveshjes dhe nuk ekzistojnë më pak kufizime për të arritur përfitime të ngjashme.

Komisioni i Konkurrencës u shpreh me Vendimin nr. 338, datë 11.11.2014 “Mbi përjashtimin individual nga ndalimi të marrëveshjes-tip mes shoqërisë “Digitalb” SH.A dhe operatorëve televizivë”, pasi bazuar edhe në nenin 5 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), Komisioni i Konkurrencës çmon se marrëveshja-tip ndërmjet “Digitalb dhe Operatorëve televizivë” duhet të përjashtohet nga ndalimi, pasi kontribuon në përmirësimin e shpërndarjes, nxitjen e progresit teknologjik, si dhe se një pjesë e mjaftueshme e këtyre përfitimeve shkon në përkrahje të interesave të klientëve dhe konsumatorëve. Kjo marrëveshje u dha me kushte që: afati i vlefshmërisë së kësaj marrëveshjeje është për një vit dhe çdo ndryshim ose amendim i kësaj marrëveshjeje nga palët, por edhe rilidhje e saj pas afatit të saj të

shfuqizimit më 31.12.2015, do duhet t'i rinjoftohet për përjashtim Autoritetit të Konkurrencës.

## **II.4 ABUZIMI ME POZITËN DOMINUESE**

Ligji "Për mbrojtjen e konkurrencës", (neni 8) sqaron se pozitë dominuese është ajo që zotërohet nga një ose më shumë ndërmarrje, dhe që i lejon ato të veprojnë në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg përsa i përket ofertës apo kërkesës. Por shkelje e ligjit është abuzimi me këtë fuqi tregu dhe jo zotërimi i pozitës dominuese. Abuzimi me pozitën dominuese individuale apo kolektive mund të jetë në formën e çmimeve të larta dhe të padrejta, çmimeve apo kushteve diskriminuese, refuzimin e ofrimit të shërbimit , etj.

### **II.4.1 Hetimi i thelluar në tregun e telefonisë celulare me pakicë ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SH.A**

Sikurse është raportuar vitin e kaluar, Autoritetit i Konkurrencës përfundoi procedurat e hetimit të thelluar në tregun e telefonisë celulare me pakicë, ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SH.A. Bazuar në shqetësimet mbi nivelin e konkurrencës në tregun e telefonisë celulare të rezultuara gjatë procedurave hetimore, Komisioni i Konkurrencës, u shpreh me anë të Vendimit nr. 303, datë 16.01.2014 "Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e telefonisë celulare me pakicë ndaj ndërmarrjes "Vodafone Albania" SH.A dhe rekomandime për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare".

Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjes objekt hetimi rezultoi se strategjia e ndjekur nga ky operator shkakton shqetësime për konkurrencën në tregun përkatës si dhe efekte negative për konkurrencën në periudha afatgjata ndaj konkurrentëve më të vegjël, nëpërmjet aplikimit të diferencimit të çmimit të thirrjeve brenda me jashtë rrjetit (on-net vs off-net). Analiza e rasteve të ngjashme tregon se diferencimi i çmimeve brenda me jashtë rrjetit mund të përdoret si një mekanizëm i mbylljes së tregut nga operatorët e mëdhenj për operatorët e vegjël të cilët mund të rrezikojnë daljen nga tregu përkatës, dhe ky fakt përbën një shqetësim për mirë funksionimin e tregut në një periudhë afatgjatë.

Ndërmarrja Vodafone është angazhuar publikisht që të barazojë tarifat brenda Vodafone Club dhe jashtë rrjetit të Vodafone (drejt nr. fiks, AMC, Eagle dhe Plus) për të ulur drejt eliminimit diferencimin e tarifave të thirrjeve brenda me jashtë rrjetit. Me Vendimin nr. 303, datë 16.01.2014, Komisioni i Konkurrencës konkludoi se kjo sjellje e Vodafone Albania nuk përbën abuzim me pozitën dominuese gjatë periudhës nën

hetim, por strategjia e ndjekur nga ndërmarrja sjell shqetësim për konkurrencën në periudhën afatgjatë, prandaj i adresoi disa rekomandime rregullatorit të tregut(AKEP).

Komisioni i Konkurrencës vendosi t'i rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare të marrë masat e ndërmjetme dhe të menjëhershme, përpara përfundimit të analizës së tregut të pakicës së telefonisë celulare, për të bërë të zbatueshme zgjidhjet e rregullimit të tregut për të parandaluar daljet nga tregu që do kishin pasoja afatgjatë mbi konkurrencën, dhe në veçanti: të modifikojë modelin BULRAIC duke ulur ndjeshëm koston e terminimit për operatorët e vegjël ndaj operatorëve të mëdhenj në këtë treg, me qëllim nxitjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në tregun përkatës; të detyrojë zvogëlimin real të diferencës së tarifave off net/on-net brenda dhe jashtë paketave dhe planeve tarifore specifike për operatorët që kanë pozitë dominuese.

Gjithashtu, Komisioni i Konkurrencës i rekomandoi AKEP të realizojë analizën e tregut të pakicës në telefoninë celulare për të adresuar zgjidhjet për shqetësimet e konkurrencës në tregun e telefonisë celulare me pakicë, duke ndërmarrë masa konkrete rregullatore për reduktimin e diferencimit të theksuar të tarifave për thirrjet brenda rrjetit me tarifat jashtë rrjetit të operatorit Vodafone. Gjithashtu të monitorojë zbatimin e angazhimit publik të Vodafone Albania për barazimin e tarifave brenda Vodafone Club dhe jashtë rrjetit të Vodafone (drejt fiks, AMC, Eagle dhe Plus) dhe në veçanti, reflektimin e zvogëlimin real të kësaj difference jo vetëm në tarifat nominale (off-net, on-net), por edhe në njësitë e përfshira në paketat opsionale të komunikimit kombëtar (ofertat dhe paketat javore, mujore e vjetore).

Autoriteti i Konkurrencës në zbatim të vendimit të Komisionit të Konkurrencës dhe Rezolutës së Kuvendit "Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2013" ka bashkëpunuar me AKEP, i cili ka marrë në konsideratë rekomandimet e dhëna nga Komisioni i Konkurrencës. AKEP, në vijim të rekomandimeve të Komisionit të Konkurrencës, ka përfshirë në dokumentin "Analizë e tregut të telefonisë së lëvizshme", një analizë më të detajuar të tregut celular me pakicë, për një rregullim sa më efektiv të këtij tregu, duke përdorur të gjitha instrumentat ligjorë të Ligjit 9918 dhe legjislacionit shqiptar në tërësi, sidomos të ligjit të konkurrencës, kryesisht lidhur me: reduktimin e tarifave të terminimit për thirrjet jashtë rrjetit; reduktimin e diferencave mes tarifave brenda dhe jashtë rrjetit jo vetëm për tarifat normale, por edhe për paketat opsionale; rishikimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare për orientimin në kosto LRIC(Long Run Incremential Cost) të pastër.

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës, ka monitoruar tregun për barazimin e tarifave brenda Vodafone Club dhe

jashtë rjetit të Vodafone, reflektimin e zvogëlimit real të kësaj difference jo vetëm në tarifat nominale (off-net/on-net), por edhe në njësitë e përfshira në paketat opsionale të komunikimit kombëtar. Nga vlerësimet e të dhënave vihet re se ndërmarrja Vodafone ka aplikuar reduktime e tarifat e terminimit në rjetet e tjera, si dhe në ofertën Vodafone Card mujore ka rritur numrin e minutave kombëtare (off-net) të përfshira në pagesë fikse.

#### **II.4.2 Hetimi thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të karburanteve**

Gjatë vitit 2014 në zbatim të Vendimit nr. 315, datë 13.05.2014, janë ndjekur procedurat e hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve ndaj ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në këtë treg dhe konkretisht: Kastrati SH.A, Kastpetrol SH.A, Europetrol Durrës Albania SH.A, Portoromano Oil SH.A, Bolv Oil SH.A, Genklaudis SH.A, Everest Oil SH.A, Taci Oil SH.A dhe Armo SH.A për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregun përkatës sipas parashikimeve të nenit 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” për periudhën kohore 1 Janar 2010- 30 Prill 2014.

Gjatë procedurave hetimore u kryen inspektime në të njëjtën ditë dhe orë në ndërmarrjet objekt hetimi për gjetjen e evidencave direkte dhe indirekte të një bashkëpunimi të mundshëm midis konkurrentëve, por gjatë këtyre inspektimeve nuk u gjet asnjë provë apo evidencë direkte. Duke qenë se gjatë inspektimeve nuk u gjetën evidenca direkte të komunikimit mes konkurrentëve, bazuar në metodologjinë e OECD<sup>1</sup>-së, janë kryer analiza ekonomike me qëllim evidentimin e sjelljes së mundshme të bashkërenduar mes konkurrentëve, parashikuar sipas nenit 3, pika 4 e Ligjit, e cila mund të shfaqet në formën e dominancës kolektive të ndërmarrjeve objekt hetimi me efekt kufizimin e mundshëm të konkurrencës.

Grupi i Punës në raportin hetimor konkludoj se në rastin e ndërmarrjeve “Kastrati” SH.A, “Kaspetro” SH.A, “Europetro” Durrës SH.A, “Bolv Oil” SH.A, “Porto Romano Oil” SH.A, “Genklaudis” SH.A, që operojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të karburanteve, struktura e tregut është oligopolistike me integrim horizontal dhe vertikal të ndërmarrjeve në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë. Evidencat më kryesoret të cilat janë përdorur për të vlerësuar pozitën dominuese kolektive janë: barrierat ligjore, barrierat ekonomike, konkurrenca potenciale, fuqia kundërvepruese e blerësve, rrjeti i ndërmarrjeve, qëndrueshmëria e kërkesës, homogjeniteti i produktit, transparenca e tregut, transaksionet midis ndërmarrjeve, blerjet e përbashkëta si edhe pjesët e larta të tregut në të gjitha nivelet e tregtimit. Në konkluzion grupi i punës konkludoj se struktura e tregut oligopolistike përbën një dominancë të përbashkët dhe se ndërmarrjet kanë abuzuar me pozitën dominuese në vendosjen e çmimeve të

<sup>1</sup> [www.oecd.org/competition/CompetitionInRoadFuel.pdf](http://www.oecd.org/competition/CompetitionInRoadFuel.pdf)



padrejta sipas parashikimeve të nenit 9, pika 2, germa a, të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të raportit të hetimit të thelluar, dosjes hetimore, pretendimeve të palëve të paraqitura në seancat dëgjimore argumenton se:

Për të provuar dominancën kolektive, e drejta europiane ka gjykuar rast pas rasti dhe në të gjitha rastet e shqyrtuara theksohet se për vërtetimin i pozitës dominante kolektive duhet të plotësohen 3 kushte të nevojshme: (i) pjesë tregu të krahasueshme midis ndërmarrjeve të tregut përkatës gjatë gjithë periudhës objekt hetimi; (ii) qëndrueshmëria në pjesët e tregut respektive dhe pengesat për hyrjen e ndërmarrjeve të reja në treg dhe; (iii) transparenca e tregut dhe ekzistenca e mekanizimit të “hakmarrjes” mes konkurrenteve.

Referuar të dhënave mbi pjesët e tregut të pasqyruara në raportin e hetimit të thelluar, dhe të përshkruara në paragrafët 29,36 dhe 37, gjatë periudhës hetimore ndërmarrjet objekt hetimi paraqesin pjesë tregu jo të krahasueshme me njëra-tjetrën për të dy nëntregjet: import dhe tregtimi me shumicë për të dy produktet.

Referuar të dhënave të disponuara nga hetimi i thelluar vihet re se ndërmarrjet paraqesin një tablo dinamike të ndryshme të pjesëve të tregut respektive në periudhën objekt hetimi, si dhe në nëntregjet janë identifikuar hyrje dhe dalje nga tregu përkatës.

Referuar të dhënave në lidhje me çmimet e tregtimit me shumicë, përkatësisht produktin euro diesel dhe produktin benzinë, vihen re lëvizje paralele të çmimit të ofruar nga ndërmarrjet objekt hetimi. Gjatë periudhës objekt hetimi, në vitin 2013, është provuar se në këtë treg ekzistojnë struktura oligopol (me disa shitës me shumicë) dhe analiza e sjelljes është kryer sipas teorive të sjelljes së firmës në këtë lloj strukture.

Për shkak të shkallës së lartë të transparencës së tregut, ndërmarrjet objekt hetimi kanë patur mundësi të ndjekin tendencat e lëvizjeve të çmimeve të njëri – tjetrit, duke mos patur nevojë që të përdorin mekanizmin e ndëshkimit për ndërmarrjen që devijojnë nga anëtarët e oligopolit.

Nga krahasimi i çmimeve mujore të blerjes CIF të karburantit pa taksa me çmimin e shitjes pa taksa të pakicës së ndërmarrjeve objekt hetimi për vitin 2013, si dhe të marzheve bruto respektive për të dy produktet, evidentohen ndryshime të vogla në çmimet e aplikuara në nivelin e pakicës, sikurse ndryshime të vogla edhe në nivelin i çmimit CIF të karburantit të blerë duke rezultuar në këtë mënyrë në vlera jo të njëjta përsa i përket marzheve bruto të këtyre ndërmarrjeve. Gjithashtu vihet re një elasticitet mesatar i ulët i çmimit të shitjes me pakicë ndaj ndryshimeve të çmimit të blerjes CIF në doganë, kryesisht kur ky i fundit ka pësuar ulje.

Gjatë periudhës objekt hetimi është evidentuar një ngurtësim i tregut të shitjes me pakicë. Ky është një kufizim vertikal i konkurrencës që është rrjedhojë e Udhëzimit nr.

17/2008, i cili përcaktonte se shitësi me shumicë (kryesori) i cakton çmimet shitësit me pakicë (agjenti). Për këtë arsye nuk ka qenë e mundur matja e efekteve të çdo segmenti, përkatësisht importi, shitja me shumicë dhe shitja me pakicë në çmimin final të produkteve eurodiesel dhe benzinë që i ofrohen konsumatorit fundor.

Pra, diferenat e mëdha mes pjesëve të tregut dhe strukturat e tregut jo të krahasueshme midis ndërmarrjeve, hyrjet dhe daljet nga tregu gjatë periudhës objekt-hetimi janar 2010 - prill 2014, si dhe ekzistenca e dy modeleve të tregut të importit, në të cilat operojnë ndërmarrje të ndryshme konkurrenca me njëra-tjetrën, nuk përbëjnë evidenca të mjaftueshme për të argumentuar dominancën e përbashkët të disa ndërmarrjeve që operojnë në tregun përkatës gjatë periudhës së hetimit.

Megjithatë, konkurrenca në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të karburanteve, nuk është mjaftueshëm efektive për shkak të strukturave të tregut dhe rregullimit ligjor (Ligji "Për hidrokarburet") dhe atij nënligjor (Udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe asaj të Energjetikës). Hetimi i realizuar nga Autoriteti i Konkurrencës në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të karburanteve, evidentoi faktin se ekzistojnë hallka të tepërta në strukturat e tregut që nuk justifikojnë vlerën e shtuar që nga importi, zonat e lira doganore, shitjet me shumicë, shitjet me pakicë, deri tek konsumatori fundor, duke shkaktuar rritjen artificiale të kostove dhe një elasticitet të çmimit mesatarisht të ulët.

Shkalla e lartë e përqendrimit të tregut dhe tendencat për rritjen e këtij përqendrimi kryesisht në tregun e importit, kërkon përmirësime strukturore të tregut dhe ndërthurjen e instrumentave përtej atyre të Autoritetit të Konkurrencës, për të ndihmuar në kontrollin e abuzimit dhe ndalimin e ndërmarrjeve që kanë fuqi tregu të aplikojnë praktika abuzive duke dëmtuar konsumatorin fundor.

Për një treg konkurrues, si dhe për të mundësuar vlerësimin e efekteve reale të sjelljes së ndërmarrjeve në treg, Komisioni i Konkurrencës në Vendimin nr.345, datë 12.02.2015 u shpreh me disa rekomandime për ministrinë e Energjetikës dhe të Ekonomisë:

Të rishikojnë Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", duke i krijuar mundësi ndërmarrjeve që operojnë në tregun e shitjes me shumicë të eurodieselit dhe benzinës: të realizojnë edhe shitjen me pakicë, duke eliminuar në këtë mënyrë hallkat e tepërta në zinxhirin e tregtimit, për të mundësuar uljen e kostove të pajustificuara ekonomike në krahasim me vlerën e shtuar të produktit; të ruajnë identitetin e produktit dhe të konkurrojnë nëpërmjet logos respektive tek shitësit me pakicë, për të mundësuar nxitjen e konkurrencës efektive në këtë treg.

Të krijojnë bazën ligjore dhe infrastrukturën administrative të nevojshme, për një njësi të transparencës së çmimit të hidrokarbureve<sup>2</sup>, në të cilën ndërmarrjet që operojnë në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të karburanteve duhet të njoftojnë në kohë reale brenda 5-15 minuta këtë njësi dhe Autoritetin e Konkurrencës për çdo ndryshim të çmimit të shitjes me shumicë; Vlerësimin e zbatimit të marrëveshjes konçesionare në portin “Vlora 1” për respektimin e detyrimit të mospërfshirjes së konçesionarit në tregtimin e karburantit si dhe transferimin e së drejtës ekskluzive në tregjet e lidhura; Ndërtimin e instrumentave për të kontrolluar hyrjet dhe daljet e shpeshta brenda vitit financiar të ndërmarrjeve që operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të karburanteve, të cilët gjenerojnë konkurrencë të pandershme.

Gjithashtu, ndërmarrjet që operojnë në tregun e hidrokarbureve të paraqesin pranë Autoritetit të Konkurrencës për vlerësim, marrëveshjet që ato lidhin për realizimin e importeve të përbashkëta apo përdorimin e logjistikës, për të përfituar përjashtimin individual të tyre në bazë të nenit 5 të Ligjit. Autoriteti i Konkurrencës do të vazhdojë monitorimin e këtij tregu.

## **II.5. KONTROLLI I PËRQËNDRIMEVE**

Gjatë vitit 2014, është vënë re rritja e numrit të rasteve të shqyrtuara (16 raste) si përqendrim pranë Autoritetit të Konkurrencës. Ky ndryshim vjen si pasojë e uljes së pragut të xhiros së ndërmarrjeve objekt përqendrimi që kanë detyrimin ligjor për marrjen e autorizimit të Komisionit të Konkurrencës si dhe nga bashkëpunimi me Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) e cila ka kontribuar për t'i bërë me dije palëve kur duhet të njoftojnë një përqendrim. Ndërkohë në kuadër të mbikëqyrjes së tregut, Autoriteti i Konkurrencës pasi ka administruar të gjithë databazën nga QKR-ja, ka filluar me nismën e tij procedurat për njoftimin e të gjitha rasteve që përmbushin kriteret ligjore për t'u autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës, por që nuk janë njoftuar nga palët.

Gjatë vitit 2014, janë shqyrtuar dhe autorizuar 8 praktika përqendrimesh lidhur me përfundimin e kontrollit, bashkimin e ndërmarrjeve apo krijimin e një ndërmarrje të re. Përqendrimet e ndodhura janë shqyrtuar si për efektet pozitive të sjella në treg, porë kjo nga pikëpamja e konsumatorit dhe rritjes së efikasitetit në treg, ashtu edhe nga premiset e mundshme për të krijuar apo forcuar pozitën dominuese të ndërmarrjes së përqendruar.

---

<sup>2</sup> Ky rekomandim bazohet në praktikatat më të mira në tregun e karburanteve, rasti i rekomandimeve të rregullimit të tregut në Gjermani (2013).

i. Bashkim i dy ose më shumë ndërmarrjeve ose pjesë ndërmarrjesh të pavarura nga njëra tjetra, neni 10, pika 1) shkronja a) e Ligjit nr.9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” - Nga përqendrimet e autorizuara nga Komisioni i Konkurrencës u konkludua se asnjë rast nuk ka rezultuar të jetë bashkim apo shkrirje i/e dy ndërmarrjeve.

ii. Përfitim kontrolli (i drejtpërdrejtë ose i tërthortë) i një ose më shumë ndërmarrjeve ose të një pjese të kësaj të fundit, neni 10, pika 1) shkronja b) e Ligjit nr.9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

**Në tregun minerar** Autoriteti i Konkurrencës ka pasur një përqendrim përkatësisht në sektorin e metalit të bakrit dhe Vendimin nr. 309, datë 06.03.2014 vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të përbashkët në mënyrë të tërthortë në shoqërinë Beralb SH.A., nëpërmjet transferimit të 50% të aksioneve të shoqërisë Nesko Metal Sanayi Ve Ticaret AS, nga shoqëria Ekin Maden Ticaret Ve Sanayi AS tek shoqëritë Jiangxi Copper Company Limited, Beijing Metal Challenge Global Trading Co. Ltd dhe CRM International (Beijing) Co. Ltd. Ky transaksion nuk shfaqte shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Përsa i përket transaksioneve ndërkombëtare të cilat kanë një ndikim në tregun ë brendshëm, Komisioni i Konkurrencës i merr në shqyrtim atëherë kur plotësojnë kushtin e xhiros së brendshme sipas nenit 12 të Ligjit nr.9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar (“Ligji”). Në këtë kuadër Komisioni i Konkurrencës ka autorizuar 4 përqendrime.

Me Vendimin nr.313, datë 30.04.2014 Komisioni i Konkurrencës vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të biznesit të markës ACE nga shoqëria Fater S.p.A me anë të blerjes së asetëve nga shoqëria “The Procter & Gamble”. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr.328, datë 11.09.2014, ka autorizuar përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit nga Alpha Bank S.A, të asetëve të zotëruara nga CitiBank International PLC që i përkasin aktivitetit të shërbimeve bankare për individë në Greqi dhe të ndërmarrjes Diners Club of Greece Finance Company S.A. Ky transaksion nuk ka shfaqur shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominues.

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin e tij Nr.330, date 03.10.2014 vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të plotë nga shoqëria

Ferrero International S.A, të shoqërive të Oltan Group. Ky transaksion nuk ka shfaqur shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Gjithashtu, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin e tij nr.335, date 31.10.2014 vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të plotë nga shoqëria Trans Atlantic Petroleum Ltd, të shoqërisë Stream Oil & Gas Ltd. Ky transaksion, nuk ka shfaqur shenja të kufizimit të konkurrencës në treg, ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Marrëveshja për zgjidhjen me mirëkuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë CEZ A.S, datë 31 Korrik 2014, është miratuar nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin nr.114/2014, datë 31.07.2014 në fuqi. Transaksioni i transferimit të 76% të aksioneve të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SH.A (“OSHEE”) nga aksioneri Cez A.S tek aksioneri shtet është pjesë e Marrëveshjes së Zgjidhjes me Mirëkuptim përkatësisht në aneksin 6 të saj. Për efekt të legjislacionit të kontrollit të transaksioneve (përqendrimeve) të cilat shkaktojnë një ndryshim të qëndrueshëm kontrolli duke pasur një impakt në treg, subjekt i autorizimit nga Autoriteti i Konkurrencës ka qenë “Marrëveshja e Blerjes së Aksioneve” e nënshkruar ndërmjet palëve MZHETS dhe CEZ A.S. Për këtë qëllim Komisioni i Konkurrencës është shprehur me Vendimin nr.331, datë 07.10.2014 me anë të së cilit ka autorizuar përqendrimin e realizuar nëpërmjet transferimit të 76% të aksioneve të shoqërisë CEZ SH.A. nga shoqëria CEZ A.S. tek Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS). Ky transaksion nuk ka shfaqur shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Në periudhën e fundit vitit është vënë re një lëvizje që ndodh brenda tregut bankar në segmentin e lisingut financiar (qirasë financiare). Në këtë treg Komisioni i Konkurrencës ka autorizuar me Vendimin e tij nr.343, datë 04.12.2014 përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfundimit të 100% të kapitalit aksionar të Landeslease SH.A. nga Union Bank SH.A. Ky transaksion, nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

- iii. Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët, që kryen të gjitha funksionet e një njësie ekonomike të pavarur – (Joint Venture) neni 10, pika 1) shkronja c) e Ligjit nr.9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

Nga përqendrimet e autorizuara nga Komisioni i Konkurrencës, gjatë vitit 2014, ka rezultuar një rast i cili shfaqte një ndryshim të qëndrueshëm kontrolli që vinte si pasojë e

krijimit të një ndërmarrjeje të përbashkët (*joint venture*), e cila kryen të gjitha funksionet e një njësie ekonomike të pavarur.

Ky përqendrim Joint Venture është autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr.340, datë 27.11.2014, përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrjeje të pavarur CMA CGM Albania sh.p.k., nga ndërmarrjet CMA CGM Agencies Worldwide dhe Pelikan sh.p.k. Ky transaksion, nuk ka shfaqur shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe për këtë arsye është autorizuar.

**iv. Raste të shqyrtuara që nuk janë konsideruar objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës**

Në kuadër të nenit 6 të “Rregullores për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, gjatë vitit 2014, pranë Autoritetit të Konkurrencës janë paraqitur 5 raste transaksioni të cilët nuk janë konsideruar objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës si pasojë e mospërbushjes së kriterit të ndryshimit të kontrollit të ndërmarrjeve objekt përqendrimi apo të mospërbushjes së kushtit të xhiros minimale të parashikuara në ligj.

*Në tregun e telekomunikacioneve*

Transaksioni i njoftuar ka pasur si objekt realizimin e përfundimit të kontrollit të shoqërisë Global Telecommunications Services (GTS) (shoqëria target) nga shoqëria gjermane Deutsche Telekom AG. Palët për këtë qëllim kanë nënshkruar marrëveshjen për shitblerjen e aksioneve lidhur me shitjen dhe blerjen e të gjitha titujve të Consortium 1 S.a.r.l, ndërmjet aksionerëve të maxhorancës (si shitës) dhe Deutsche Telekom AG (si blerës), më datë 8 nëntor 2013. Pas realizimit të këtij transaksioni, shoqëria (mëma e GTS-së) Consortium 1 S.a.r.l do të kontrollohej tërësisht nga shoqëria Deutsche Telekom, nëpërmjet blerjes së të gjitha aksioneve të zakonshme, të gjitha çertifikatave preferenciale të kapitalit dhe 63 102 820 çertifikata preferenciale dhe të konvertueshme të kapitalit të emetuara nga Consortium 1 S.a.r.l. Transaksioni i propozuar ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve kombëtare të telekomunikacionit (NACE code j.61), si dhe aktivitete të lidhura të shërbimeve të informacionit (NACE code J.63). Transaksioni i përfundimit të kontrollit të shoqërisë GTS (Europa Lindore) nga shoqëria Deutsche Telekom (Gjermani) përbënte një përqendrim, i cili ka ndodhur jashtë tregut të Republikës së Shqipërisë. Ky përqendrim nuk ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, në tregun e brendshëm dhe për pasojë, në bazë të nenit 2/b të Ligjit nr. 9121, nuk është bërë objekt për dhënien e autorizimit nga Komisioni Konkurrencës.

*Në tregun e energjisë elektrike*

Si pasojë e bashkëpunimit me QKR-në , kjo e fundit ka orientuar përfaqësuesit e shoqërisë Energia Pulita Sh.p.k të njoftojnë një transaksion pranë Autoritetit të Konkurrencës. Transaksioni i njoftuar, i cili ka si objekt transferimin e pjesës prej 51% të kuotave të shoqërisë Energia Pulita Sh.p.k tek shoqëria NCI Sh.p.k me ortak të vetëm z. Ergys Halili. Ky transaksion është realizuar me anë të Kontratës së Dhurimit, datë 9 maj 2014. Me përfundimin e kësaj kontrate shoqëria NCI Sh.p.k, me ortak të vetëm z. Ergys Halili, njihet si pronar dhe ortak në shoqërinë Energia Pulita Sh.p.k në masën 51% të kuotave. Në bazë të nenit 10 , pika1) shkronja b) e Ligjit, ky transaksion ka përbërë një përqendrim në formën e përfutimit të kontrollit. Nga bilancet e palëve pjesëmarrëse të cilat janë depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës ka rezultuar se shoqëria Energia Pulita ka realizuar një xhiro 0 Lek për vitin ushtrimor 2013, ndërsa shoqëria NCI Sh.p.k është themeluar më 8 maj 2014 dhe për pasojë nuk ka xhiro. Pra shoqëritë pjesëmarrëse nuk plotësojnë kushtin e xhiros së parashikuar në nenin 12, pika 1),shkronja b) të Ligjit dhe për pasojë nuk ka qenë objekt për autorizimin nga Komisioni i Konkurrencës.

#### *Në tregun e shitjes së produkteve ushqimore me pakicë (supermarketeve)*

Në bazë të nenit 53 “Detyrimi për njoftim” të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar, shoqëria Delhaize Albania Sh.p.k (Euromax) dhe CMB Albania Sh.p.k kanë depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës “Kërkesë për opinion nga Autoriteti i Konkurrencës, në lidhje me procesin e ristrukturimit të brendshëm brenda të njëjtit grup të kompanive”. Transaksioni është realizuar me anë të marrëveshjes për transferimin e veprimtarisë ekonomike të datës 1 prill 2014 të nënshkruar nga CMB Albania Sh.p.k dhe Euromax Sh.p.k. Objekt i këtij transaksioni ka qenë transferimi i aseteve, kontratave, stoqet dhe punonjësve nga shitësi (Euromax Sh.p.k) tek Blerësi (CMB Albania Sh.p.k). Operacioni i transferimit të veprimtarisë ekonomike me anë të transferimit të aseteve dhe kontratave nga Euromax tek CMB Albania i cili ka ndodhur ndërmjet dy ndërmarrjeve Euromax dhe CMB Albania (që kontrollohen nga i njëjti aksioner CMB Balkans) nuk ka shkaktuar ndryshim cilësor të kontrollit në ndërmarrjen target (Euromax) dhe për pasojë nuk është klasifikuar si përqendrim në bazë të nenit 10), pika 1) , shkronja b) e Ligjit. Ky transaksion nuk ka qenë objekt shqyrtimi nga Komisioni i Konkurrencës.

#### *Në tregun e shitjes së produkteve elektrike*

Edhe njoftimi paraprak i shoqërive Faie Sh.p.k dhe Siame Sh.p.k ka ardhur si pasojë e bashkëpunimit me QKR-në. Transaksioni i njoftuar kishte të bënte me operacionin e bashkimit të plotë të dy ndërmarrjeve të pavarura (Siame Sh.p.k dhe Faie Sh.p.k) në një ndërmarrje të përbashkët që do të kryente të gjitha funksionet e një njësie ekonomike të pavarur. Për këtë qëllim ndërmarrjet pjesëmarrëse kanë nënshkruar

“Projektarrëveshjen për bashkimin me përthithje të shoqërive tregtare Siame Sh.p.k dhe Faie Sh.p.k”, më datë 3 qershor 2014. Shoqëritë pjesëmarrëse operojnë në të njëjtin treg të brendshëm dhe të jashtëm si Kosove dhe Maqedoni. Po ashtu, ato kanë të njëjtët furnitorë të huaj dhe tregtojnë të njëjtat materiale elektrike si priza, çelësa, automate etj. Shoqëritë pjesëmarrëse tregtojnë mallrat dhe kanë ekskluzivitetin e markës Gewis. Transaksioni i bashkimit me përthithje ndërmjet ndërmarrjeve Siame Sh.p.k dhe Faie Sh.p.k ka përbërë një përqendrim në formën e bashkimit të dy ndërmarrjeve të pavarura nga njëra tjetra në bazë të nenit 10.1.a) të Ligjit. Por ky përqendrim nuk plotësonte kushtin e xhiros në bazë të nenit 12.1.a) të Ligjit dhe për pasojë, nuk ka qenë objekt për dhënien e autorizimit nga Komisioni Konkurrencës.

### Në tregun e sigurimeve

Në bazë të nenit 53 “Detyrimi për njoftim” të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar përfaqësuesi ligjor i Vienna Insurance Group në Shqipëri ka depozituar një kërkesë për interpretim në lidhje me transaksionin e bashkimit të dy shoqërive shqiptare të Grupit VIG, shoqërive Interlbanian SH.A dhe Sigma SH.A.

Me qëllim zvogëlimin e kostove operacionale dhe përmirësimin e shërbimeve të ofruara konsumatorëve shqiptarë, VIG dhe aksionerët e tjerë të shoqërive Interlbanian SH.A dhe Sigma SH.A (Palët) po shqyrtonin mundësinë e bashkimit të këtyre dy shoqërive në një shoqëri të vetme siguri. Me shumë mundësi, si pasojë e bashkimit të parashikuar, Interlbanian SH.A do të përthithej nga Sigma SH.A. në vijim të këtij bashkimi VIG do të vazhdonte të ishte aksionari kontrollues i Sigma SH.A duke zotëruar minimalisht pjesën prej 85% të kapitalit të kësaj të fundit. Për këtë qëllim palët kanë nënshkruar një Projektarrëveshje (pa datë) bashkimi midis Sigma Vienna Insurance Group SH.A dhe Interlbanian Vienna Insurance Group SH.A. Sipas Projektarrëveshjes, (pika 1.3) shoqëria Interlbanian do të bashkohej dhe do të përthithej nga Sigma, dhe më pas Interlbanian do të pushonte së qeni një entitet juridik i veçantë. Aksionerët e Interlbanian do të konsideroheshin aksionarë të Sigma dhe do të ushtronin të drejtat e tyre si të tillë, duke përfshirë të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimeve, nga data e hyrjes në fuqi të bashkimit. Nga pikëpamja ligjore operacioni i bashkimit me përthithje të shoqërisë Interlbanian SH.A nga shoqëria Sigma SH.A, i cili ka ndodhur ndërmjet dy ndërmarrjeve që bëjnë pjesë në të njëjtin grup (VIG) nuk ka shkaktuar ndryshim cilësor të kontrollit në ndërmarrjen përfundimtare të operacionit,(Sigma Interlbanian Vienna Insurance Group SH.A) pasi kjo e fundit ka vazhduar të kontrollohet nga VIG dhe për pasojë nuk ka qenë objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.



## **II.6 RISHIKIMI I TE DREJTAVE EKSKLUZIVE**

Përgjatë vitit 2014, në fokus të veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës kanë qenë një sërë të drejtash ekskluzive dhe të veçanta të dhëna në Shqipëri. Vlerësimi i këtyre marrëveshjeve konçesionare mbështetet në Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” ( i ndryshuar) , ku në nenin 2 të tij është përcaktuar se ky ligj zbatohet edhe për ndërmarrjet publike dhe private, të cilave iu janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive ose të drejta të veçanta. Gjithashtu, ky vlerësim u krye edhe në zbatim të Rezolutës së Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2013” ku ishin përcaktuar disa marrëveshje konçesionare në qendër të vëmendjes së Autoritetit për vitin 2014.

Autoriteti i Konkurrencës kreu vlerësimin ex-post të këtyre drejtave të veçanta dhe ekskluzive të dhëna nga institucione të ndryshme në Shqipëri, duke pasur parasysh mbrojtjen dhe ruajtjen e parimeve të konkurrencës së lirë dhe efektive. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i të gjitha kontratave konçesionare, ka rezultuar se gjatë procedurës për dhënien e koncesioneve nuk është respektuar detyrimi i nenit 2/1c dhe 69/1/b të Ligjit nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” pasi institucionet përgjegjëse në çdo rast nuk kanë zbatuar detyrimin për të marrë vlerësimin e Autoritetit gjatë procedurës së dhënies së të drejtave ekskluzive

### ***Shërbimi i kontrollit teknik të automjeteve***

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr.312, datë 18.04.2014 “Për disa rekomandime në lidhje me funksionimin e tregut të shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve”, i ka rekomanduar Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës që në periudhë afatshkurtër të kërkojë nga konçesionari SOCIETE GENERALE DE SURVEILLANCE S.A të krijojë më shumë se një mundësi për zgjedhjen e konsumatorit për kryerjen e kontrollit të detyrueshëm teknik vjetor të automjeteve në qytetin e Tiranës; në periudha afatgjatë të shikohet mundësia e ofrimit të kontrollit teknik të automjeteve nga disa operatorë. Në rastet e të drejtave ekskluzive të kërkohet mendimi i Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të nenit 69-70 të Ligjit. Gjithashtu është vënë në vëmendje të institucioneve publike direktiva e re e BE-së lidhur me rregullat e reja për koncesionet duke zbatuar parimin e transparencës dhe e kriterit të “tenderit me avantazhin më të mirë ekonomik”.

### ***Terminali Lindor i Portit të Durrësit***

Autoriteti i Konkurrencës ka kryer vlerësimin e kontratës konçesionare për menaxhimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Terminalit Lindor të Portit të Durrësit, duke kërkuar edhe mendime dhe sugjerime lidhur me këtë vlerësim nga organet publike që monitorojnë zbatimin e kësaj marrëveshjeje konçesionare. Si konkluzion, Autoriteti i Konkurrencës ka vendosur në vëmendje të konçesionarit që për mallrat rifuxho shoqëria EMS është

ofruesi i vetëm i shërbimit për një periudhë relativisht të gjatë kohore 35 vjeçare dhe për këtë arsye i rekomandojmë Ministrisë së Transportit që nëse do të rishikojë marrëveshjen konçesionare të përcaktojë që Kalata Lindore të jetë për mallrat rifuxho. Autoriteti ka rekomanduar se për mallrat e përgjithshme, në mënyrën e aplikimit të tarifave edhe për Autoritetin Portual, të shikohet mundësia e ndryshimit mes marzheve për të përshtatur tarifat e ofruara sipas tregut për të konkurruar në mënyrë efektive me konçesionarin.

### ***Shërbimi i skanimit të automjeteve***

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr.319, datë 13.06.2014 “Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”, i ka rekomanduar Ministrisë së Financave dhe Këshillit të Ministrave, rishikimin e kontratës konçesionare për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”. Një pikë tjetër e vendimit është detyrimi i institucioneve publike për të respektuar parashikimet e Ligjit nr.9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) për të kërkuar paraprakisht vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës në dhënien e miratimit e akteve që kanë si objekt ose pasojë dhënien e të drejtave ekskluzive ose kufizime sasiore në tregje ose sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

### ***Pullat fiskale***

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 337, datë 11.11.2014 “Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për projektimin, financimin dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave” i ka rekomanduar Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të kryejnë vlerësimin ekonomik dhe teknik mbi zbatueshmërinë e kushteve të kontratës konçesionare dhe analizën e justifikimit ekonomik të koncesionit, i cili është pasuar me rritjen e kostos së biznesit për pullat fiskale, duke identifikuar përmbushjen e qëllimit për të cilin është dhënë koncesioni, si rritjen e të ardhurave fiskale dhe luftën ndaj evazionit dhe kontrabandës së produkteve të akcizës. Komisioni i Konkurrencës ka rekomanduar rishikimin e kontratës konçesionare, për pjesën e pullave fiskale për barnat, pasi konstatohet se nuk ka filluar prodhimi i këtyre pullave duke qenë se kjo sjell kosto të lartë për produktet farmaceutike të cilat kanë një ndjeshmëri shumë të lartë.

## ***Lotaria kombëtare***

Autoriteti i Konkurrencës ka vlerësuar marrëveshjen e licencës për Lotarinë Kombëtare ndërmjet Ministrisë së Financave si Autoriteti i Autorizuar dhe shoqërisë Oesterreichische Lotterien GmbH nëpërmjet OLG Project sh.p.k. Në përfundim të këtij vlerësimi i është dërguar një shkresë Ministrisë së Financave ku i bëhet me dije se nuk janë respektuar parimet e ligjit të konkurrencës gjatë procedurës së dhënies së kësaj të drejte, por duke evidentuar faktin se kjo procedurë është zbatuar duke ndjekur parimet dhe eksperiencën e pothuajse të gjitha vendeve duke pasur vetëm një licencë të vetme për lojërat për të cilat edhe Lotaria ka ekskluzivitetin. Sidoqoftë, duke qenë një situatë e pozitës dominuese, Autoriteti do të monitorojë sjelljen e ndërmarrjes në treg në respektim të ligjit organik.

## **II.7 MONITORIMET E TREGUT**

### **II.7.1 Tregu i importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos**

Në përfundim të hetimit të thelluar në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të çimentos, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ka realizuar në vijimësi monitorimin e tregut të importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos. Qëllimi i monitorimit ishte vlerësimi i strukturave të tregjeve përkatëse të prodhimit, importit dhe shitjes me shumicë të çimentos si dhe analiza e çmimeve të ndërmarrjeve që operojnë në tregjet përkatëse me qëllim vlerësimin e nivelit të konkurrencës.

Metodologjia e përdorur gjatë monitorimit u bazuar kryesisht në analizën e konkurrencës së realizuar gjatë procedurave hetimore nëpërmjet treguesve të strukturës së tregjeve, dinamikës së çmimeve të shitjes me shumicë, vlerësimin e ofertës në treg si dhe politikat tregtare të ndërmarrjeve mbi volumet e eksporteve dhe shitjet brenda vendit.

Në përfundim të këtij monitorimi u vu re se tregu i importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos edhe pse ka karakteristikat e një tregu oligopolistike, paraqet dinamika të zhvillimit të tij si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë rajonal. Ndërmarrjet ofrojnë çmime të ndryshme për klientë të ndryshëm duke treguar për fuqinë kundërvepruese të blerësve. Gjatë monitorimit nuk u gjetën evidenca për ndonjë sjellje antikonkurrese në lidhje me çmimin.

### **II.7.2 Tregu i duhanit dhe nënprodukteve të tij.**

Në zbatim të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr.314, datë 08.05.2014 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit, shitjes me shumicë dhe pakicë të duhanit” Sekretariati ka patur në monitorim tregun e duhanit.

Gjatë kësaj procedure, Sekretariati kishte administruar informacion mbi volumet dhe çmimet e shitjes së cigareve nga importuesit më të mëdhenj në vend si dhe dinamikat e çmimeve të aplikuara nga importuesit.

Në mesin e muajit tetor 2014 në media u ngrit shqetësimi i konsumatorëve për rritjen e çmimit të cigareve të fabrikuara, arsye kjo që kërkoi një vlerësim të menjëhershëm të tregut të cigareve. Pas analizës së të dhënave, monitorimit në terren si dhe kontakteve me tregtarët, rezultoi se tregu i importit të cigareve të fabrikuara kishte karakteristikat e një tregu me përqendrim të lartë, ku dy ndërmarrjet kryesore zotëronin rreth 80% të tregut.

Gjatë fundit të muajit tetor konstatohet që dy ndërmarrje importuese kane rritur çmimin në periudha të përafërta kohe dhe në marzhe të njëjta rritjeje pavarësisht se ligji për akcizat nuk kishte hyrë ende në fuqi. Këto evidenca paraqisnin shenja që mes dy ndërmarrjeve të importit të cigareve mund të kishte koordinim të sjelljes, kjo në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit nr.9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Për gjithë sa u evidentua gjatë monitorimit, me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm, Komisioni i Konkurrencës nëpërmjet Vendimit nr.342 datë 27.11.2014 vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e cigareve të fabrikuara.

### **II.7.3 Tregu i importit dhe shitjes më shumicë gazit të lëngshëm**

Gjatë viteve të fundit, tregu i importit dhe shitjes me shumicë të gazit të lëngshëm ka qenë nën monitorim të vazhdueshëm. Raportimet e mëparshme kishin konstatuar se tregu i importit të gazit paraqitej shumë i përqendruar, ku treguesit e përqendrimit janë më të lartët e gjithë periudhës për të cilën dispononim të dhëna. Në treg ndërmarrjet ofronin produkte homogjene, me elementë të kostos dukshëm transparente (çmim burse, shpenzime shkarkimi, transporti e magazinimi, ushtrim të aktivitetit të importit në të njëjtin lokalitet), ku kërkesa për produkt ishte jo elastike dhe ku operonte një ndërmarrje me pozitë të ndjeshme në treg.

Lidhja aksionere mes ndërmarrjes kryesore në treg (A&V Gas Sha), me ndërmarrjen Intergaz (zotëuese e depozitave të gazit) dhe ndërmarrjes Romano Port mund të kenë qenë faktorë që mundësonin lehtësira për forcimin e pozitës së ndërmarrjes importuese në treg.

Ndryshimet e ndjeshme të pjesës së tregut të ndërmarrjeve të tjera, uljet apo rritjet drastike të pjesëve të tyre në treg, tregonin për një paqëndrueshmëri dhe pasiguri të konkurrentëve të tjerë, tregues i dobësisë së konkurrencës potenciale në tregun e importit të gazit.

Nga të dhënat që disponoheshin nuk u gjetën elementë të bashkëpunimit mes ndërmarrjeve më të mëdha të shitjes me shumicë sikurse ishte i paqartë ndikimi i ndërmarrjes kryesore importuese në nivelet e tjera të tregtimit, varësisë ekonomike të blerësve apo mundësisë së një integrimi vertikal në nivele të ndryshme tregtimi.

Për gjithë sa më sipër, specialistet e Sekretariatit vlerësuan sjelljen e ndërmarrjes A&V Gaz (importuesi kryesore) për abuzim me pozitën e tij në treg. Analiza u realizua në zbatim të Udhëzimit “Për pozitën dominuese” si dhe metodologjive më të mira të OECD mbi rastet e abuzimit me pozitën dominuese.

Në përfundim të analizave u konstatua se çmimi i shitjes me shumicë të GLN-së në tregun vendas nga ndërmarrja A&V GAZ SH.A është më i ulët se çmimi i shitjes që kjo ndërmarrje aplikon në tregun rajonal. Çmimi i shitjes së GLN-së në treg ndjek trendin e bursës, duke reflektuar në mënyrë harmonike çmimet në faturat e blerjes. Nga krahasimi i çmimit efektiv të shitjes (brenda dhe jashtë vendit) me koston mesatare të ndryshueshme (AVC) nuk rezulton të kemi shitje nën kosto (predatory prices) gjatë kësaj periudhe. Nga analiza e marzheve të fitimit të viteve 2011-2012-2013 u konstatua përkatësisht se ndërmarrja ka shitur me një marzh mesatar vjetor normal fitimi duke mos paraqitur shenja të shitjes me çmime të padrejta (excessive price). Nga analiza e detajuar që i'u bë çmimeve të shitjes me shumicë që ndërmarrja A&V Gas Sha realizon në tregun e rrjedhës së sipërme drejt ndërmarrjeve të tjera (përrjashto AV Distribution) dhe çmimit që aplikon ndërmarrja e integruar me ndërmarrjen me pozitë dominuese në tregun e rrjedhës së poshtme, rezulton se nuk jemi para një situatë klasike të ngjeshjes së çmimeve (margin squeeze). Në përfundim të analizës u konstatua se ndërmarrja A&V Gas SH.A ka pozitë dominuese në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të gazit të lëngshëm, por nuk u gjetën shenja të abuzimit me pozitën dominuese të saj në tregun përkatës.

Duke qenë se tregu është shumë i përqendruar dhe i ndjeshëm ndaj shpenzimeve konsumatore, Sekretariati do të vazhdojë të ketë nën monitorim sjelljen e ndërmarrjeve importuese në këtë treg.

#### **II.7.4 Tregu i importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit të lulediellit**

Në zbatim të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr.284, datë 13.05.2013 “Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit të lulediellit” ndaj ndërmarrjeve “Erbiron” sh.p.k”, “Olim” SH.A dhe “Crystal” sh.p.k dhe kalimin e këtij tregu në monitorim, Sekretariati ka patur nën monitorim tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit të lulediellit.

Qëllimi i monitorimit ishte evidentimi i dinamikave që mund të kenë ndodhur në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal pas periudhës hetimore në lidhje me treguesit e strukturës së tregut të prodhimit, importit dhe shitjes me shumicë,

indekseve të përqendrimit, sjelljes dhe çmimit të aplikuar nga ndërmarrjet kryesore prodhuese dhe importuese për vajin e lulediellit të shitur në paketimin 1 litra.

Në përfundim të analizës së të dhënave dhe treguesve të konkurrencës u konstatua se nga janar 2013- qershor 2014: vaji i importit plotëson pjesën më të madhe të nevojave për vaj luledielli në vend, (rreth 85% e vajit importohet); tregu i vajit është më pak i përqendruar sesa periudha hetimore dhe çmimet në çdo hallkë tregtimi (importi, shitje me shumicë, shitje me pakicë) kanë rënë ndjeshëm krahasuar me periudhat paraardhëse. Në tregun e importit vërehen hyrje të reja ndërsa në tregun e shitjes me shumicë të gjitha ndërmarrjet kanë reflektuar uljen e çmimit të importit në çmimet e tyre të shitjes me shumicë. Midis ndërmarrjeve nuk vërehet ndonjë sjellje antikonkurruese në lidhje me çmimin pasi ndërmarrjet aplikojnë politika të ndryshme të përcaktimit të çmimit nëpërmjet reflektimit të indekseve të ndryshueshëm të uljes së çmimit të importit/blerjes në hallkën e shitjes me shumicë.

Në përfundim të monitorimit, duke parë dinamikat në strukturën e tregut të importit/prodhimit dhe shitjesh me shumicë të vajit vegjetal si dhe elementet që përcaktojnë sjelljen e ndërmarrjeve në lidhje me çmimin, u vendos mbyllja e monitorimit në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të vajit të lulediellit, ndërkohë që pranë Sektorit të Analizës do të vazhdojë administrimi i të dhënave për tregun e importit të vajit vegjetal.

### **II.7.5 Monitorimin i tregut të produkteve të akcizës**

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të nenit 28 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, ka realizuar një monitorim në tregun e produkteve me akcizës. Shkak për fillimin e monitorimi ishin ndryshimet e fundit në paketën fiskale dhe ndikimi i barrës fiskale në këto tregje. Qëllimi i monitorimit ishte vlerësimi i tregjeve pas ndryshimeve në paketën fiskale dhe evidentimi i strukturave të tregjeve përkatëse për periudhën janar 2013- janar 2014.

Metodologjia e përdorur për monitorimin e mallrave mbi të cilat është aplikuar akciza është bazuar kryesisht në analizën e strukturës së tregjeve të importit dhe prodhimit, ndarjes së tregjeve sipas nomenklaturës së mallrave të DPD dhe kodifikimeve përkatëse, metodologjisë “Strukturë, Performancë, Sjellje” ku për çdo treg është llogaritur pjesa e tregut sipas sasisë/peshës dhe vlerës, janë identifikuar markat, ku është kryer analiza midis markave “Between Brands” dhe analiza brenda markës “Intra Brand” ku janë identifikuar ndërmarrjet kryesore për çdo markë.

Gjatë procedurës u hartua një pyetësor i cili u plotësua në bashkëpunim me studentët e Fakultetit të Ekonomisë pranë Universitetit të Tiranës në pikat tregtare, i cili pati si qëllim të vlerësonte mënyrën e shpërndarjes dhe përcaktimit të çmimit fundor për produktet pije energjike dhe birra, mënyrat e marketingut të produkteve, nëse kishte kushte

detyruese nga ana e furnitorëve për shitësit fundor dhe dinamikat e ndryshimit të çmimit pas janarit 2014.

Analiza e tregut të mallrave të akcizës u realizua si në vlerësimin e akteve ligjore dhe nënligjore në Shqipëri ashtu edhe në një krahasim rajonal “Benchmark” me vendet e rajonit (Kosovë, Maqedoni dhe Mal i Zi ) për shkallën e taksimit, ku janë parë legjislacionet e këtyre shteteve.

Pas përfundimit dhe analizës së të dhënave për treguesit në tregjet përkatëse konstatoam se në tregun e kafesë, Ligji nr.180/2013 “Për akcizat ne RSH” nuk solli ndryshim të akcizës për produktet e kafesë për vitin 2014 dhe tregu i importit është jo i përqendruar.

Për tregun e pijeve energjike, Ligji nr.180/2013 “Për akcizat ne RSH” vendosi për herë të parë akcizë mbi këtë kategori produktesh në masën 50 lek/litër. Kjo taksë aplikohet në Kosovë në vlerën 0.45 euro për litër ose 63 lek për litër, ndërsa vendet e tjera nuk aplikojnë taksë për këtë kategori produktesh. Në treg ka konkurrencë dhe shumëllojshmëri çmimesh midis markave. Brenda markës konkurrenca është e ulët, pasi brenda markës tregjet janë shumë të përqendruara, ose është vetëm një importues i vetëm.

Për tregun e birrës, prodhimi vendas zë 93% të totalit të ofertës për birrë . Për tregun e birrës Ligji nr.180/2013 “Për akcizat ne RSH” solli ulje të ndjeshme të akcizës dhe vlerat e saj janë të krahasueshme me vendet e rajonit. Nga analiza brenda markës, vërehet se të njëjtat ndërmarrje importuese importojnë më shumë se një markë. Ndërsa për markat e prodhimit të birrës një ndërmarrje prodhon vetëm një markë birrë, duke e bërë tregun shumë i përqendruar.

Për tregun e verës, kërkesa për verë në vendin tonë plotësohet nga importi dhe prodhimit vendas. Akciza për këtë produkt ka pësuar ndryshime në rritje dhe është reflektuar në mënyrën e sjelljes së ndërmarrjeve që operojnë në tregun e importit duke importuar një volum shumë të madh në muajin dhjetor të vitit 2013 , para rritjes së taksës së akcizës. Në tregun e importit dhe prodhimit vendas të verës operojnë një numër shumë i madh ndërmarrjesh dhe tregu është mesatarisht të përqendruar.

Në tregun e pijeve alkoolike, Ligji 180/2013 solli rritje të akcizën në grupin “Pije alkoolike të ndërmjetme” me përjashtim të kategorive ku përfshihen dhe klasifikohen prodhimet vendase të alkoolit (raki, konjak dhe uzo). Në krahasimin me vendet e rajonit, në legjislacionin shqiptar kemi një shkallëzim të akcizës sipas llojit të produktit si dhe volumit të prodhimit nga fabrikat prodhuese, kurse me legjislacionet e rajonit akciza është fikse për një fashë shumë të gjerë të mallra të parashikuara në nomenklaturë. Përsa i përket nivelit të akcizës, vlerën në të lartë të akcizës në RSH e kanë pijet e forta, e cila është me i lartë së Kosova dhe Maqedonia, kurse për pijet e tjera akciza

është më e ulët se e rajonit. Nga vlerësimi i strukturave të nëntregjeve përkatëse sipas markave, u vu re se për çdo pije ka një numër shumë të madh markash të cilat në disa raste paraqesin ndryshime të konsiderueshme të çmimit. Nga vlerësimi i strukturës së tregut sipas ndërmarrjeve importuese, vihet re se tregjet janë kryesisht të përqendruar, ku ndërmarrjet më të mëdha kanë ekskluzivitetet markash.

Nga analiza e pyetësorëve të realizuar u konstatua se në të gjithë produktet ka patur rritje të çmimeve pas muajit shkurt 2014; në pikat e shitjes me pakicë tregtohen disa marka të pijeve energjike apo të birrës, me çmime të ndryshme të cilat kanë reflektuar përqindje të ndryshme të rritjes së çmimit pas janarit 2014; ndërmarrjet importuese/prodhuese ofrojnë artikuj promovimi, përcaktojnë skonto dhe oferta të vazhdueshme për ta bërë produktin e tyre më atraktiv se konkurrentët. Nuk u vunë re sjellje diskriminuese ndaj konkurrenteve të tjerë brenda të njëjtit produkt apo kushte detyruese nga ana e furnitorëve në lidhje me kërkesën për furnizim.

Për shkak të karakteristikave të tregjeve dhe konkurrencës midis markave dhe brenda markave si dhe mbështetur në të dhënat e administruara lidhur me sjelljen ndaj çmimit në përfundim të monitorimit u konkludua se nuk ka shenja të kufizimit të konkurrencës në tregjet përkatëse.

Raporti i monitorimit për produktet me akcizë u publikua në faqen e internetit të institucionit si dhe i'u dërgua për informim Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

## **II.8 RISHIKIMI GJYQËSOR I ÇËSHTJEVE TË AUTORITETIT TË KONKURENCËS**

Gjatë vitit 2014, për shkak të hyrjes në fuqi, si dhe zbatimit gjatë gjithë kohëzgjatjes së vitit të Ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", çështjet, në të cilat Autoriteti i Konkurrencës ka qenë palë ndërgjyqëse, janë gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Gjithashtu edhe çështjet, të cilat ishin duke u gjykuar pranë gjykatave civile, u kaluan për kompetencë lëndore pranë Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Ndjekjes së këtyre çështjeve Autoriteti i Konkurrencës i ka kushtuar dhe i kushton kujdes dhe vëmendje të madhe për shkak se efikasiteti dhe impakti konkret në treg i vendimmarrjeve të Komisionit të Konkurrencës (VKK) lidhen ngushtësisht me procesin e rishikimit gjyqësor ndaj vendimeve të Komisionit. Kjo sepse pothuajse të gjitha vendimet që kanë konkluduar në shkëlqje të ligjit dhe që përmbajnë ndëshkime për ndërmarrjet, i janë nënshkruar ankimit në gjykatë. Ky seksion përmban rastet, si dhe



procedurat e ankimimeve të VKK në sistemin e gjyqësorit, ecurinë e tyre atje dhe më pas edhe ekzekutimin përfundimtar të tyre nëpërmjet kalimit nga “Titull ekzekutiv” në Urdhër ekzekutimi. Procedura këto të cilat mbyllen me depozitimin përfundimtar, në buxhetin e shtetit shqiptar, të gjobave ndaj shkelësve të konkurrencës.

Kryesisht Autoriteti i Konkurrencës ka shënuar progres në zbatimin e ligjit të tij organik, për rivendosjen e konkurrencës në treg nëpërmjet veprimit dhe ndëshkimit me gjobë të ndërmarrjeve në shkelje të ligjit, për rastet e karteleve, abuzimit me pozitën dominuese, pengimin e inspektimeve dhe mosnjoftimin në kohë të përqendrimeve. Por doktrina e së drejtës së konkurrencës, ka vërtetuar se efienca e ndërhyrjes së institucionit të konkurrencës në treg kushtëzohet në mënyrë të ndjeshme nga zbatimi i vendimeve të tij.

Kështu që vendimet përfundimtare të Komisionit të Konkurrencës, si akte administrative, tashmë, si dhe bazuar në Ligjin nr.49/2012, përgjithësisht i nënshtrohen procesit të rishikimit (ankimit) gjyqësor në të gjitha shkallët e gjyqësorit administrativ ndaj për këtë arsye Autoriteti i Konkurrencës ka ndjekur me rigorozitet proceset e ankimit dhe mbrojtjes gjyqësore si në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative, Apelit Administrativ dhe Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Nëse i referohemi statistikave, të cilat janë mjaft të detajuara në shtojcat e këtij raporti, në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative, janë trajtuar gjithsej 8 vendime të Komisionit të Konkurrencës, nga të cilat 5 janë shqyrtuar në vitin objekt-raportimi nga të cilët 3 janë kurorëzuar me rrëzim padie, 2 pranim padie, ndërkohë ka edhe 3 raste që janë në proces për vitin 2015. Në Gjykatën e Apelit Administrativ gjatë vitit 2014 kanë qenë për shqyrtim po 8 çështje, nga të cilat mbeten 4 për t'u shqyrtuar në 2015 dhe 4 janë shqyrtuar. Nga këto të fundit 3 janë pranuar kërkesat e paditësve kundrejt VKK dhe 1 njëra u mbyll me rrëzim padie (Romano-Porti) ndërsa në Gj. A. Administrative, priten të kalojnë edhe 4 çështjet e mbetura për shqyrtim në 2015. Nga ana tjetër në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë gjatë 2014 kanë qenë 10 çështje për shqyrtim, nga të cilat vetëm për 1 është vendosur pjesërisht pranimi i Rekursit të paraqitur nga paditësi AMC SH.A., duke u vendosur kthimi i çështjes së VKK nr.59, dt.9.11.2007 për rigjykim në Gjykatën e Apelit Administrativ, për shkak se deri në momentin e gjykimit në Kolegji çështja ishte gjykuar vetëm në gjykatat civile, por me hyrjen në fuqi të ligjit nr.49/2012, dt.3.5.2012 “Për Organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative....” për rishqyrtim pranë gjyqësorit administrativ. Kurse 9 çështje mbeten ende për shqyrtim për 2015, si çështje të mbartura.

Pra një aspekt shumë i rëndësishëm i shqyrtimit gjyqësor, është mbrojtja që realizohet nga Autoriteti i Konkurrencës i vendimeve të vet organit të tij vendimmarrës, gjë që fokusohet gjerësisht në argumentimin ligjor të shkeljeve të konstatuara dhe evidentimin me prova dhe fakte, si dhe elementë të tjerë sqarues për të mundësuar një rishikim

gjqësor sa më objektiv nga ana e gjykatave. Në procesin e rishikimit gjyqësor Autoriteti i Konkurrencës ka bashkëpunuar gjerësisht me Avokaturën e Shtetit në të gjitha shkallët e gjyqësorit administrativ.

Gjithsesi mund të themi se gjatë vitit objekt-analize janë pasur për ndjekje kohë pas kohe 26 çështje në të treja shkallët (ku 8 raste –gjykata e Shkallës së Parë, 8 raste – Gjykata e Apelit, dhe 10 raste – Gjykata e Lartë), prej të cilave mbeten për shqyrtim në 2014 16 ( 3ShkP, 4Gj.A, 9KAGj.L) dhe 10 prej tyre shqyrtuar në 2014, duke rezultuar përkohësisht: 5 të humbura, 4 të fituara dhe 1 dërguar për rishqyrtim për kompetencë në Gjykatën Administrative.

### **II.8.1 Analiza e rasteve të rishikimit gjyqësor**

Lidhur me rastet në të cilat gjyqësori ka konkluduar me pranim padie, (çka nënkupton shfuqizim tërësor apo pjesor të VKK), në pjesën konstatuese të vendimet e gjykatave, tërthorazi argumentohet se një pjesë e mirë e provave të zotëruara nga Autoriteti i Konkurrencës nuk janë konsideruar si të tilla prej tyre. Konkretisht në ilustrim të këtij përfundimi po japim disa konstatime nga vendimet e gjyqësorit mbi provat e Autoritetit të Konkurrencës:

#### **Rasti 1: Gjykata vendos në mënyra të ndryshme në lidhje me shkeljet e ndërmarrjeve të transportit qytetas në Tiranë**

Referuar Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 290, datë 23.07.2013, ndërmarrjet “Ferlut” SH.A, “Tirana Lines” SH.A, “Alba Trans” Sh.p.k, “Tirana Urban Trans” SH.A, “Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve” Sh.p.k dhe “Otto-al” Sh.p.k, me anë të vendimeve të marra në Shoqatën Kombëtare të Transportit Qytetas (SHKTQ), kanë bërë një marrëveshje, si pasojë e së cilës kanë kufizuar tregtimin e 50% të sasisë së aboneve të studentit, për vitin 2007 dhe rreth 80% të sasisë së aboneve të studentit për periudhën 2008-2012. Komisioni i Konkurrencës, u shpreh për marrjen e masës administrative, gjobë e rëndë për shkelje të nenit 4 të Ligjit të Konkurrencës për ndërmarrjet “Ferlut” SH.A, “Tirana Lines” SH.A, “Alba Trans” Sh.p.k, “Tirana Urban Trans” SH.A, dhe “Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve” Sh.p.k.

Ky vendim u ankimua individualisht në rrugë gjyqësore nga ndërmarrjet “Ferlut” SH.A, “Tirana Lines” SH.A, “Alba Trans” Sh.p.k, “Tirana Urban Trans” SH.A. Gjykata ka vendosur të pranojë paditë e ndërmarrjeve Ferlut SH.A dhe Alba Trans Sh.p.k dhe të rrëzojë paditë e ndërmarrjeve “Tirana Lines” SH.A dhe “Tirana Urban Trans” SH.A, duke u shprehur në mënyra të ndryshme për çështje me të njëjtin objekt gjykimi. Më poshtë po paraqesim pjesë nga arsyetimi i dhënë nga ana e Gjykatës, për pranimin apo rrëzimin e padisë, për secilin rast.

### **1. Alba Trans vs Autoritetit të Konkurrencës (VKK nr. 290, datë 23.07.2013)**

Lidhur me padinë e ndërmarrjes Alba Trans, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, vendosën pranimin e padisë, duke arsyetuar:

*“.....vendimi për kufizimin e tregtimit të aboneve të studentit, është marrë nga Shoqata, pjesë e të cilës janë të gjithë operatorët që veprojnë në treg. Në këto kushte ky vendim nuk cenon, nuk dëmton dhe as prek asnjë nga konkurrentet në këtë treg. Ligji organik ka për qëllim të ndalojë ato marrëveshje të cilat i sjellin dëm konkurrencës dhe jo marrëveshjet të cilat mund të kenë çdo qëllim tjetër, por jo pengimin e konkurrencës.*

*Ndërsa kompetencat e palës së paditur shtrihen vetëm në rastet kur shkelet ligji organik Nr. 9121 datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës". Për sa kohë veprimi i shoqatës nuk dëmton konkurrencën, përkundrazi e favorizon atë pala e paditur ka ndërhyrë pa të drejtë duke vendosur gjobë me aktin objekt kundërshtimi.”*

### **2. FERLUT vs. Autoritetit të Konkurrencës (VKK nr. 290, datë 23.07.2013)**

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, vendosi të pranojë Kërkesë-Padinë e ndërmarrjes FERLUT, me arsyetimin se refuzimi për të mos i njohur shoqërisë "GERARD-A" SH.A, kartonin shoqëruar të aboneve për 5500 copë abone, por vetëm për 1200 copë abone, është një vendim i marrë nga SHKTQ, e cila është subjekt juridik me vete e themeluar që më datë 15.12.2003, dhe e regjistruar si e tillë si person juridik më vete, dhe jo nga shoqëria "FERLUT" SH.A, dhe në këto kushte subjekt i kundërvajtjes administrative duhej të ishte pikërisht kjo shoqatë dhe jo shoqëria "FERLUT" SH.A.

Sipas Gjykatës edhe nëse pranojmë se në rastin konkret kemi marrëveshje të ndaluar, siç pretendohet nga pala e paditur, kjo sipas nenit 4 pika 1, germa "b" dhe "c" të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" ashtu siç u theksua më sipër subjekt i kësaj kundërvajtje administrative do të duhej të ishte SHKTQ e cila është subjekt juridik më vete, dhe jo shoqëria "FERLUT" SH.A.

### **3. “Tirana Urban Trans” vs. Autoriteti i Konkurrencës**

Për të njëjtën çështje Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesë –padisë me një palë tjetër siç ishte Tirana Urban Trans. Kështu në lidhje me rastin Gjykata vlerësoi se, duke iu referuar rastit konkret, lidhur me refuzimin për njohjen e aboneve të pashoqëruara me kartelën shoqëruese të Shoqatës dhe lidhur me kufizimin e tregtimit të abonesë së studentit, veprimet e anëtarëve të shoqatës dhe konkretisht të palës paditëse Shoqërisë Tirana Urban Trans SH.A përbëjnë një marrëveshje të ndaluar në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121, dt. 28.07.2003. “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

*Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë vendosi rrëzimin e padisë së ndërmarrjes, duke lënë në fuqi vendimin e Autoritetit të Konkurrencës. Kundër këtij*

*Vendimi nga ana e ndërmarrjes është kryer Ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.*

## **Rasti 2: Gjykata lë në fuqi vendimin për mbylljen e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SH.A dhe rekomandime për AKEP**

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 303, datë 16.01.2014, vendosi mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e telefonisë celulare ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SH.A dhe dhënien e rekomandime për AKEP-in. Ky vendim u kundërshtua nga ndërmarrja "PLUS COMMUNICATION" SH.A në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Në vendimin e saj Gjykata arsyeton se në rastin objekt gjykimi themeli i çështjes zgjidhet referuar zbatueshmërisë së Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar, si një ligj i posaçëm, i cili në nenin 40 të tij "E drejta e Ankimit" ka parashikuar: "Kundër vendimeve të Autoritetit mund të bëhet ankim në Gjykatën e Tiranës brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit." Afati maksimal që parashikon Ligji është 30 ditë, afat ky i pa respektuar nga pala paditëse.

Gjykata konkludon se afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë dhe jo 45 ditë, pasi ligji i posaçëm, i cili ka cituar të drejtën e ankimit dhe afatin përkatës prevalon nga parashikimet për të drejtën e ankimit në ligje të tjera.

*Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë vendosi mospranimin e padisë të paraqitur nga pala paditëse "Plus Communication" SH.A, pasi padia nuk i plotëson kushtet formale të saj, duke lënë në fuqi vendimin e Autoritetit të Konkurrencës. Kundër këtij Vendimi nga ana e ndërmarrjes PLUS është kryer Ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.*

## **Rasti 3: Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, lë në fuqi vendimin ndaj ndërmarrjes "Romano Port" SH.A në tregun e ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm të naftës në rrugë detare.**

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 221, datë 11.04.2012, për abuzim me pozitën dominuese të ndërmarrjes "Romano Port" SH.A në tregun e ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm të naftës në rrugë detare", ndër të tjera ka vendosur të gjobisë këtë ndërmarrje. Kundër këtij vendimi Shoqëria "Romano Port" SH.A, ka paraqitur ankim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila vendosi pushimin e gjykimit të çështjes civile për shkak mosparaqitje, duke lënë në fuqi Vendimin e Autoritetit të Konkurrencës.

Kundër vendimit të mësipërm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pala paditëse, Shoqëria "Romano Port" SH.A, ka paraqitur ankim, i cili pasi është shqyrtuar nga

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, ka vendosur lënien në fuqi të Vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, duke konfirmuar edhe një here Vendimin e Autoritetit të Konkurrencës.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur Rekurs pala paditëse, "ROMANO PORT" SH.A.

#### **Rasti 4: Gjykata rrëzon vendimin e Komisionit të Konkurrencës për marrëveshje të ndaluar në oferta ndaj ndërmarrjeve "NAZERI" SHRSF & "DEA" SHRSF**

Autoriteti i Konkurrencës me Vendimin nr. 240, datë 26.07.2012, ka vendosur ndalimin e marrëveshjes në oferta në tregun e prokurimeve publike të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike ndërmjet ndërmarrjeve: "Eurogjici Security" SHPK, "Toni Security", "Eurogjici Security 1" SHPK, "Nazeri – 2000" dhe "Dea Security", si marrëveshje e ndaluar në kuptim të nenit 4 pika 1 germa a) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

Ndërmarrjet ju drejtuar Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë, secila me kërkesë padi. Kërkesë padia e ndërmarrjeve "NAZERI" SHRSF & "DEA" SHRSF, u gjykua bashkërisht, dhe në përfundim Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi pranimin e kërkesë-padive të Shoqërive "Nazeri 2000" sh.p.k. dhe "Dea Security" sh.p.k, si dhe Anulimin e pjesëshëm të aktit administrativ Vendimit Nr.240, datë 26.07.2012 të Autoritetit të Konkurrencës, që i përket ndëshkimit me gjobë për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar në oferta, të shoqërisë "Nazeri 2000" sh.p.k. dhe shoqërisë "Dea Security" sh.p.k., si dhe pezullimin e zbatimit të këtij akti administrativ deri në përfundim të gjykimit.

Kundër këtij vendimi, brenda afateve të parashikuara në K.Pr.C, Autoriteti i Konkurrencës, ka paraqitur Ankim, dhe Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, vendosi lënien në fuqi të Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke rrëzuar Vendimin e Autoritetit të Konkurrencës, me arsyetimin e mëposhtëm: *Ana e paditur në gjykim nuk ka sjellë prova që të tregojnë se këto veprime të paditësve kanë sjellë dhe pasoja në treg. Pra nuk është treguar se çfarë pasoja ka sjellë ky qëndrim i paditësve në tregun e sigurimit, pra sa kanë influencuar ata që të shmangin operatorë të tjerë nga tregu me këto veprime. Vetëm fakti që midis tyre ka veprime që tregojnë se kanë paraqitur dokumente të njëjta dhe të përafërta, nuk mund të jetë shkak i ndëshkimit të tyre për thyerje të tregut.*

*Me të drejtë, gjykata e shkallës së parë ka pranuar se: "bazuar në rezultatet e hetimit gjyqësor, nga analiza ligjore e bërë në këtë material, si dhe referuar provave e fakteve të parashtruara në raportin e hetimit, vlerësojmë se veprimtaria e pjesëmarrjes në prokurime të shoqërive: "Nazeri 2000", sh.p.k dhe "DEA Security", sh.p.k, ka qenë në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi dhe nuk ka pasur asnjëherë qëllim për të*

*kryer veprime të kundërligjshme, e për më tepër veprime, të cilat mund të përbëjnë objekt hetimi nga ana e të paditurit, apo të kenë sjellë pasoja të hetueshme nga i padituri ".*

#### **Rasti 5: Gjykata e Lartë kthen për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit vendimin për gjobë të rëndë ndaj AMC**

Me Vendimin nr. 59, datë 09.11.2007 "Për abuzim me pozitën dominuese në tregun e telefonisë së lëvizshme të shoqërisë "AMC" SH.A dhe "Vodafone Albania" SH.A Komisioni i Konkurrencës ka provuar se shoqëritë AMC dhe Vodafone kanë abuzuar me pozitën dominuese duke vendosur çmime të padrejta në tregun e telefonisë së lëvizshme gjatë periudhës objekt-hetimi (2004-2005). Për shkeljet e konstatuara shoqëritë AMC dhe Vodafone janë gjobitur me 2 % të xhiros vjetore, respektivisht 211 552 000 lekë dhe 242 633 000 lekë.

Kompanitë e ankimuan vendimin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë veç e veç. Në vendimin për pjesën e AMC-së, gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë me Vendimin nr. 172, datë 19 janar 2009 ka mbështetur konkluzionin e Komisionit të Konkurrencës. Sipas vendimit të Gjykatës, tarifat e shërbimit të telefonisë celulare në Shqipëri të krahasuara me tregjet e tjera gjeografike janë tepër të larta. Duke patur në konsideratë sa është analizuar për vërtetimin e testeve të përcaktuara nga BE, gjykata arrin në përfundimin se AMC ka abuzuar me pozitën e saj dominuese në treg. Për rrjedhojë konkludon Gjykata, Vendimi i Komisionit të Konkurrencës nr. 59, datë 09.11.2007 është i drejtë, i bazuar në ligj dhe në prova dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi. Edhe Gjykata e Apelit e ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe për këtë vendim, ndërmarrja AMC SH.A, ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

Pas shqyrtimit të rekursit të ndërmarrjes AMC SH.A, Gjykata e Lartë vendosi kthimin e çështjes për t'u rigjykuar nga Gjykata Administrative e Apelit.

**Ndërkohë për të njëjtin vendim të Komisionit të Konkurrencës, vetë sistemi gjyqësor (shkalla e parë, Apeli dhe Gjykata e Lartë) në rastin e ankimit gjyqësor të Vodafone Albania SH.A,** ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Konkurrencës për gjobën e rëndë për këtë shoqëri. Nga rishikimi gjyqësor Gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë së shoqërisë Vodafone dhe konfirmimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, duke konfirmuar vendimin e Komisionit të Konkurrencës. Gjithashtu nga ana e ndërmarrjes Vodafone Albania SH.A është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, i cili pasi është shqyrtuar nga kjo Gjykatë në dhomë këshillimi ka vendosur mospranimin e rekursit.

**Rasti 6: Gjykata Administrative e Apelit rrëzon vendimin e AK-së për gjobën ndaj ndërmarrjes AMC SH.A për mosdhënie të të dhënave të kërkuara (Vendimi i Komisionit të Konkurrencës Nr. 26 – 27, datë 02.12.2005 dhe 12.12.2005)**

Çështja gjyqësore me palë: AMC” SH.A vs Autoriteti i Konkurrencës; me Objekt: Anulim i Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 26 – 27, datë 02.12.2005 dhe 12.12.2005. Kjo çështje u gjykua në Gjykatën e Lartë, pas rekursit të paraqitur nga AK-ja, e cila pas shqyrtimit vendosi ta kthejë këtë çështje për rigjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Gjykata e Apelit Tiranë në lidhje me këtë çështje shpalli mos kompetencën lëndore në zbatim të Ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012 dhe ja kaloi për shqyrtim Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, e cila vendosi pranimin pjesërisht të padisë, duke pushuar gjykimin lidhur për Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 26, 02.10.2005 dhe duke pranuar padinë në lidhje me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 27, 12.10.2005. Kundër këtij vendimi Autoriteti i Konkurrencës ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

Nga analiza e mësipërme evidentohet qartazi një konfuzion i gjyqësorit mbi terminologjinë e së drejtës së konkurrencës dhe për më tepër një padijeni në çmuarjen e provave të shkeljes, shtrembërimit apo kufizimit të konkurrencës. Ndërkohë që nga praktika e Gjykata Europiane e Drejtësisë në Luksemburg, por edhe nga praktikat e tjera të njohura ndërkombëtarisht prej vendeve të zhvilluara në këtë drejtim (të cilat shërbejnë edhe si shkollë e së drejtës së konkurrencës), provat e konstatuara nga Autoriteti i Konkurrencës në vendimmarrjen e saj (të orientuara prej këtyre precedentëve), konsiderohen absolutisht si më se të mjaftueshme për evidentimin e kufizimit të konkurrencës.

Nga analiza e vendimeve të gjykatave rezulton se asnjë prej vendimeve të Komisionit të Konkurrencës nuk është goditur, ose rrëzuar procedurat e ndjekura nga Autoriteti i Konkurrencës. Paditë kanë konsistuar gjithmonë mbi themelin e shkeljeve të konkurrencës të konstatuara në VKK. Themele të padive të cilat janë të interpretueshme dhe janë në funksion të “thellësisë së njohurive” të palëve mbi terminologjinë e së drejtës së konkurrencës të përmendura edhe më lart, për shkak dhe rrjedhojë të së cilës është edhe varësia e gjyqësorit dhe e dhënies së drejtësisë mbi bazueshmërinë e vendimeve të Komisionit të Konkurrencës.

Por, përtej statistikave, shqetësimi kryesor i Autoritetit të Konkurrencës është dhe mbetet përthithja nga gjyqësori administrativ i filozofisë dhe terminologjisë së konkurrencës, në përgjithësi dhe i parimeve të së drejtës së konkurrencës, në veçanti. Kjo pasi është shumë e rëndësishme arsyetimi bazuar në interesin publik të vendimeve të tyre dhe të konkurrencës si një e mirë publike.

Prandaj, sfida kryesore e institucionit të konkurrencës ka qenë dhe është ndërtimi dhe konsolidimi i instrumentave të absorbimit të filozofisë së konkurrencës nga anëtarët e gjyqësorit të të gjitha niveleve. Në këtë kuadër një ndihmesë e efektshme do të ishte rritja e trajnimeve të gjyqtarëve, sidomos tashmë, atyre të Gjykatave Administrative të të gjitha shkallëve, pasi do të jenë ata të cilët do të vlerësojnë drejtësinë e VKK në të ardhmen.

## **II.8.2 Ekzekutimi i vendimeve**

Lidhur me ekzekutimin e Vendimeve të Komisionit që kanë marrë formë të prerë, Autoriteti i Konkurrencës në zbatim të Kodit të Procedurave Civile, si dhe nenit 80 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i është drejtuar Zyrës së Përmbartimit Tiranë, për ekzekutimin e titujve ekzekutivë duke paraqitur në kohën e duhur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të mundësuar ekzekutimin e këtyre titujve ekzekutivë prej saj.

Nëse i referohemi shtojcës nr. 3 “Ekzekutimi i gjobave të vendosura nga Komisioni i Konkurrencës deri më 31 Dhjetor 2014, rezulton se për totalin 1 miliardë e 37 milionë lekë masa administrative të vendosura nga Komisioni i Konkurrencës janë mbledhur 25% e vendimeve të kthyer në tituj ekzekutiv (259 milionë e 821 mijë), janë në proces përmbartimi 45.7 milionë ose 4.5 % e shumës dhe për rreth 731.6 milionë lekë ose 70.5 % e gjobave nuk është marrë ende një vendim gjyqësor i formës së prerë.

Përkatësisht është kërkuar dalja e urdhrave të ekzekutime për dy vendime të Komisionit të Konkurrencës ndaj ndërmarrjeve vijuese. Kemi çuar për ekzekutim pranë Zyrës Përmbartimore edhe Urdhrin e Ekzekutimit ndaj subjektit VILOIL. Konkretisht:

- 1) Vendimi i Komisionit të Konkurrencës nr. 221, datë 11.04.2012 “Për abuzim me pozitën dominuese të ndërmarrjes “Romano Port” SH.A në tregun e ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm të naftës në rrugë detare”, për të cilin është lëshuar Urdhër Ekzekutimi me anë të Vendimit nr. 703 Regjistri, datë 23.05.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
- 2) Vendimi i Komisionit të Konkurrencës nr. 318, datë 02.06.2014 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjes Heaney Assets Corporation për mosdhënie të dhënash brenda afatit kohor të përcaktuar në Vendimin e Komisionit”, për të cilin është lëshuar Urdhër Ekzekutimi me anë të Vendimit nr. 934 Regjistri, datë 10.09.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;

Në zbatim të Kodit të Procedurës Civile, Autoriteti i Konkurrencës, ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e duhur për të bërë të mundur ekzekutimin e këtyre titujve ekzekutivë nga ana e Zyrës së Përmbartimit, si dhe ndjekjen dhe ekzekutimin në vazhdim të titujve ekzekutivë të mbartur nga vitet e mëparshëm.



## **II.9 PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E KONKURRENCËS**

Një nga objektivat kryesore të Autoritetit, që prej krijimit e në vazhdimësi, ka qenë dhe mbetet plotësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i legjislacionit rregullator dhe i udhëzuesve për aspekte të veçanta të mbikëqyrës në fushën e konkurrencës, duke mundësuar forcimin e zbatimit të ligjit. Kuadri ligjor i plotësuar synon përafrimin me standardet ndërkombëtare, në kuadër të përmbushjes së angazhimeve të institucionit dhe të vendit për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me Bashkimin Europian.

Duke qenë se Shqipëria, tashmë pas marrjes së statusit të vendit kandidat, ka detyrimin të përafrojë kuadrin ligjor me legjislacionin europian, detyrimi dhe angazhimi për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë europian, sanksionohet në nenin 70 të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit. Sipas këtij neni Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me legjislacionin europian. Në këtë mënyrë, procesi i përafrimit të legjislacionit mbetet një nga prioritetet kryesore të Autoritetit të Konkurrencës, pasi zbatimi i këtij procesi bëhet jo vetëm për të ndërtuar kornizën ligjore në fushën e konkurrencës në përputhje me kërkesat e institucionit duke përshtatur dhe përafruar Acquis Communautaire, por gjithashtu për të siguruar kushtet administrative dhe të tjera të nevojshme për zbatimin efektiv të saj.

Autoritetit të Konkurrencës, gjatë procesit të përfarimit të legjislacionit, është transparent, dhe në këtë mënyrë, publikon në faqen e tij zyrtare si dhe i kalon te palët e treta projekt aktet nënligjore para miratimit, në mënyrë që të marrë mendimet dhe sugjerimet e të tretëve. Kjo është një procedurë që është ndjekur dhe vazhdon të ndiqet pranë Autoritetit të Konkurrencës. Ky ka qenë një bashkëpunim i frytshëm, pasi nëpërmjet mendimeve dhe opinioneve mbi projekt aktet e hartuara, është mundësuar përmirësimi i draft akteve.

Gjatë vitit 2014 janë zbatuar angazhimet e ndërmarra në Planin Kombëtar për Integrimin Europian duke përkthyer, përshtatur apo përafruar dhe miratuar aktet nënligjore të parashikuara, duke respektuar edhe afatet kohore të vendosura. Autoriteti i Konkurrencës në kuadrin ligjor dytësor ka tashmë pjesë të tij edhe aktet e mëposhtme:

**1. Rregullorja “Për kategoritë e marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e transportit detar të mallrave”.** Kjo rregullore parashikon ato kategori marrëveshjeshe dhe praktikash të bashkërenduara në sektorin e transportit detar, të cilat përjashtohen nga zbatimi i nenit 4 të Ligjit. Rregullorja sjell risi për sa i përket disa përkufizimeve dhe përcaktimeve që i bëhen termave të ndryshëm që përmenden në rregullore. Rregullorja jep përkufizime të qarta lidhur me çfarë është

transporti detar, çfarë është konsorciumi, kushtet për dhënien e përjashtimit, rastet e dhënies së përjashtimit, pjesën përkatëse të tregut etj. Përjashtimi i parashikuar në këtë rregullore zbatohet kur përmbushen disa kushte, për ato konsorciume të cilat ofrojnë shërbime të transportit detar ndërkombëtar nga/ose tek një nga portet detare.

**2. Udhëzimi “Mbi zbatueshmërinë e nenit 8 dhe 9 të Ligjit nr.9121, datë 23.07.2003 ‘Për mbrojtjen e konkurrencës’** . Udhëzimi ka për qëllim që të sqarojë teknikat e vlerësimit të rasteve me pozitë dominuese si dhe të sjelljes abuzive. Nëpërmjet këtij udhëzimi i jepet prioritet studimit dhe analizës së këtyre rasteve duke i trajtuar si të dëmshme dhe me efekte për konsumatorët. Ky udhëzim jep sqarime për të tretët, dhe në veçanti për biznesin, se si Autoriteti i Konkurrencës përdor një analizë të bazuar mbi efektet në treg që sjellin rastet e abuzimit me pozitën dominuese. Qëllimi final është mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive si dhe e mirëqenies së konsumatorëve dhe jo e një konkurrenti individual. Analiza e Autoritetit të Konkurrencës konsiston në faktin e vlerësimit nëse një sjellje ka mundësi të kufizojë konkurrencën në treg, përfshirë këtu barrierat e hyrjes, pozicionin dhe kundër-strategjitë e konkurrentëve, cila pjesë e tregut ndikohet nga kjo sjellje etj.

### **III. ADVOKATIA DHE KULTURA E KONKURRENCËS**

Shtylla e katërt e ligjit të konkurrencës është advokacia nëpërmjet së cilës synohet të mbrohet konkurrenca nga efektet e akteve ligjore dhe rregullative, si dhe të nxitet dhe të promovohet ajo. Por, kushti kryesor i zbatimit me efektivitet i kësaj kërkesë të ligjit, është bashkëpunimi i ngushtë dhe real midis institucioneve të qeverisjes qendrore dhe të enteve rregullatore me institucionin e konkurrencës. Eksperienca e vitit të kaluar jo gjithmonë ka qenë pozitive, dhe tregues për këtë është shkalla e marrjes në konsideratë të rekomandimeve të Autoritetit.

#### **III.1. VLERËSIMI I AKTEVE**

Mjedisi për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg është në funksion të aktivitetit të një sërë institucionesh qendrore dhe vendore, përfshirë ministritë, entet rregullatorë, bashkitë etj.

Në bazë të nenit 69 të Ligjit nr. 9121, dt.28.07.2003, organet e administratës qendrore dhe vendore duhet të kërkojnë vlerësimin e autoritetit për çdo projekt-akt normativ që ka të bëjë kryesisht me kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin, vendosjen e të drejtave ekskluzive. Është detyrë ligjore e Autoritetit të vlerësojë shkallën e kufizimit ose të pengimit të konkurrencës, por me gjithë rolin proaktiv që me nismën tonë të bëjë vlerësimin e këtyre akteve, kjo nuk ka qenë gjithnjë e mundur për shkak të neglizhimit që bëjnë institucionet në marrjen e opinionit të Autoritetit përpara miratimit të akteve që sjellin kufizime të konkurrencës.

Me mbështetjen e projektit të asistencës teknike të BE-së Autoriteti i Konkurrencës ka propozuar dhe tashmë është implementuar një matricë e vetëvlerësimit të impakteve të akteve ligjore dhe/ose nënligjore në konkurrencë, si një instrument ndihmës për të gjitha institucionet për të bërë vetë paraprakisht procesin e ndikimit të një akti në kufizimet e mundshme të konkurrencës në treg.

Në vijim paraqiten aktet dhe projekt aktet ligjore të paraqitura për mendim pranë Autoritetit të Konkurrencës, si dhe të akteve ligjore që lidhen me tregjet që kanë qenë objekt hetimi apo monitorimi nga institucioni i konkurrencës, për të cilat janë kryer vlerësimet ligjore.

- Projekt-ligjin “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”;
- Vlerësim i legjislacionit në fushën e tregtimit të karburanteve gjatë procedurave hetimore në atë treg përkatës;
- Vlerësim i legjislacionit në fushën e transportit detar të udhëtareve dhe automjeteve, gjatë procedurave hetimore në atë treg përkatës;

- “Draft Rregullorja e ankandit për alokimin e kapaciteteve në SEE CAO” (Rregullorja e ankandit);
- Vlerësim i aplikimit të shoqërisë “Vodafone M-PESA” sh.p.k pranë Bankës së Shqipërisë për t'u licencuar si subjekt financiar jo bankë/institucion i parasë elektronike, kërkuar nga Banka e Shqipërisë;
- Vlerësim ligjor i Projekt-ligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, kërkuar nga Agjencitë e Reklamave;
- Vlerësim i Rregullores së Bankës së Shqipërisë "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jo-banka", në bazë të kërkesës së ndërmarrjes “UNIONI FINANCIAR TIRANË” Sh.p.k;
- Vlerësim i legjislacionit në sektorin e energjisë elektrike dhe veçanërisht rregullat dhe procedurat e blerjes së energjisë elektrike nga ndërmarrja CEZ SHA/OSHEE;
- Vlerësim i legjislacionit së tregut të sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, gjatë procedurave hetimore në atë treg përkatës;
- Vlerësim i legjislacionit në fushën e telekomunikacionit, gjatë procedurave hetimore në atë treg përkatës;
- Vlerësim i P/Ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”;
- Vlerësim ligjor i procedurave të OSHEE, mbi “Rregullat dhe procedurat standarde të prokurimit të energjisë elektrike, gjatë shqyrtimit të ankesës së ndërmarrjes “GEN-I” sha.
- Vlerësimi i p/amendimeve të Kodit Procedurave Administrative.
- Vlerësim shoqëruar me dhënie mendimi për Dokumentin “Strategjia sektoriale e Axhendës Dixhitale 2014-2020”.
- Vlerësim ligjor i procedurave të OSHEE, mbi “rregullat dhe procedurat standarde të prokurimit të energjisë elektrike, gjatë shqyrtimit të ankesës së ndërmarrjes “GEN-I” SH.A;
- Vlerësim i kontratës konçesionare të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në RSH dhënë nga Komisioni me Vendimin nr. 312, datë 18.04.2014;
- Vlerësim i marrëveshjes së Licencës për Lotarinë Kombëtare,
- Vlerësim i p/vendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”;
- Vlerësim mbi dokumentin e AKEP si “Analizë e tregut të telefonisë së lëvizshme për vitin 2013”.

Krahasuar edhe më parë, ashtu edhe gjatë vitit 2014, ka një numër të konsiderueshëm të akteve nënligjore të ardhura për mendim nga institucionet shtetërore pranë Autoritetit të Konkurrencës. Ky fakt tregon një rritje të vazhdueshme të ndjeshmërisë dhe

domosdoshmëri të institucioneve ndaj hartimit të projekt-akteve sa më në përkrahje të konkurrencës.

### **III.2. DHËNIA E REKOMANDIMEVE**

Autoriteti i Konkurrencës gjatë procedurave të monitorimit dhe të hetimit, analizon faktorët që ndikojnë në mirëfunksionimin e tregjeve respektive, duke identifikuar rolin promovues apo kufizues që mund të luajnë aktet ligjore apo nënligjore të institucioneve rregullatorë apo qendrorë. Në tërësi rekomandimet që ka adresuar Komisioni i Konkurrencës janë paraqitur në pjesët përkatëse të raportuara për procedurat e veçanta sipas tregjeve të monitoruara apo të hetuara, si dhe në shtojcën nr. 8 “Matrica e rekomandimeve nga Komisioni i Konkurrencës për vitin 2014”. Në vijim paraqiten rekomandimet përkatëse.

Në përfundim të procedurave hetimore në tregun e telefonisë celulare me pakicë, Autoriteti i Konkurrencës, me anë të Vendimit nr.303, datë 16.01.2014, ka dhënë rekomandime për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare me qëllim rritjen e konkurrencës në këtë treg.

Nëpërmjet Vendimit nr.308, datë 21.02.2014 Autoriteti i Konkurrencës ka dhënë disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të transportit ajror.

Pas përfundimit të monitorimit në tregun e shërbimit ekskluziv për kontrollin teknik të automjeteve janë dhënë rekomandime për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës për një konkurrencë më efektive në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve.

Pas përfundimit të monitorimit për kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifën e shërbimit të skanimit, i janë dhënë rekomandime Ministrisë së Financave dhe Këshillit të Ministrave për rishikimi i kontratës koncesionare për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit.

Në përfundim të procedurave hetimore në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, janë dhënë rekomandime për shoqëritë e sigurimit për rivendosjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, si dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për nxitjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta.

Pas monitorimit të tregut të importit të energjisë elektrike nga CEZ SHA për mbulimin e humbjeve, Autoriteti ka dhënë rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e prokurimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes.

Pas vlerësimit të kontratës së koncesionit për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave, Autoriteti ka dhënë disa rekomandime për Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në lidhje me kontratën e koncesionit për projektimin, financimin dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave.

### **III.3 TRANSPARENCA DHE RITJA KULTURES SE KONKURRENCES**

Gjatë vitit 2014 Autoriteti i Konkurrencës ka bërë transparent veprimtarinë e tij kryesisht nëpërmjet publikimit të vendimeve në faqen e internetit dhe buletinet zyrtare, nxjerrjes së deklaratave dhe njoftimeve për shtyp për vendimet më kryesore, dhënies së intervistave dhe sqarimeve për media në të gjitha rastet që është kërkuar zyrtarisht dhe publikimit të raportit vjetor, akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e konkurrencës etj. Pothuajse të gjitha publikimet e Autoritetit të Konkurrencës janë bërë pesë e bibliotekave universitare dhe kryesisht të fakulteteve juridike dhe ato ekonomikë.

#### **III.3.1 Konferenca ndërkombëtare**

Për t'u veçuar është konferenca ndërkombëtare shkencore me rastin e 10 vjetorit të Autoritetit të Konkurrencës që u zhvillua në muajin Mars 2014, me temë: "Mbi ndikimin e zbatimit të politikës dhe ligjit të konkurrencës në rritjen ekonomike", si një nga temat e debatit ekonomik në Shqipëri. Në konferencë u theksua se vendosja e tregut në kushtet e efikasitetit duke e mbrojtur nga loja antikonkurrese e një apo disa lojtarëve të tregut, apo ndikimi i shtetit si faktor në treg përbën filozofinë e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës

Nga folësit në panel u konkludua se institucioni i konkurrencës është shumë më i zhvilluar se në vitin e krijimit dhe shumë më i konsoliduar se 5 vite më parë, fakt i cili është evidentuar qartë nga Komisioni Europian në Raportet e Progresit, ku theksohet se Autoriteti i Konkurrencës është një nga institucionet që ka rritur dukshëm performancën gjatë viteve të fundit.

Inkurajimi nëpërmjet vlerësimeve pozitive për performancën në zbatimin e ligjit, rritjen dhe forcimin e kapaciteteve administrative dhe përhapjen e advokatisë e kulturës së konkurrencës, mbështetja e vazhdueshme nëpërmjet financimeve për forcimin e

kapaciteteve institucionale, ka qenë një nga faktorët kryesorë për procesin e konsolidimit të institucionit të konkurrencës.

Rritja e kulturës së konkurrencës arrihet në radhë të parë nëpërmjet zbatimit të ligjit dhe sigurisht, që për konsumatorët ndjehen efektet reale të ndërhyrjes së Autoritetit për rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Rastet hetimore në tregje me kontribut të rëndësishëm në produktin e brendshëm bruto si telefonia celulare, industria financiare, sektori i ndërtimit, prokurimet publike etj., dhe hetimi dhe ballafaqimi me ndërmarrje të mëdha ndërkombëtare dhe vendase me suport ligjor nga studiot më të njohura ligjore të vendit e të Europës, nga Londra në Bruksel, ka qenë një proces sfidues për Autoritetin e Konkurrencës.

E drejta e konkurrencës është pjesë përbërëse e institucionit të së drejtës, zbatimi nga të gjithë institucionet publike i së cilës, përbën një nga instrumentat e luftës ndaj korrupsionit. Një tjetër problem i rëndësishëm, evidentuar nga eksperiencia disa vjeçare e Autoritetit të Konkurrencës, është mungesa e përvojës dhe e njohurive për një vlerësim të plotë të efekteve të një praktike antikonkurrese në treg, nga ana e institucioneve e pushtetit gjyqësor, të cilat shkaktojnë probleme për zbatimin efektiv të së drejtës së konkurrencës.

Vetë komuniteti i biznesit duhet të bashkëpunojë në mënyrë pro-aktive me Autoritetin e Konkurrencës, veçanërisht në drejtim të nxitjes së kulturës së konkurrencës, me anë të aktiviteteve të përbashkëta e politikave individuale të bizneseve, për të siguruar që veprimtaria e tyre të jetë në përputhje me rregullat e konkurrencës.

Qëllimi kryesor i së drejtës së konkurrencës është shpërndarja efiçente e burimeve, mision i cili mundësohet plotësisht vetëm nga një bashkëpunim shumë i ngushtë midis rregullatorëve të tregjeve specifike dhe institucionit të konkurrencës. Një sfidë e vazhdueshme kjo, për të kapërcyer shqetësimet e momentit, me të cilat ballafaqohen këto tregje, për të konverguar në qëllimin për të garantuar mirë funksionimin e qëndrueshëm të tyre.

### **III.3.2. Tryeza të rrumbullakëta rajonale me komunitetin e biznesit dhe akademikët**

Autoriteti i Konkurrencës në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes zhvilloi disa workshope mbi Politikën e Konkurrencës e Ndhimën Shtetërore në rrethet e Gjirokastrës, Korçës dhe Shkodrës.

Në diskutimet e saj Kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës, Znj. Lindita Milo (Lati) u shpreh se zbatimi i ligjit dhe politikës kombëtare të konkurrencës kërkon partneritetin me biznesin, pushtetin vendor, organet tatimore rajonale dhe stafin akademik të Universitetit në funksion të zbatimit të parimeve dhe rregullave të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Nga ana e përfaqësuesve të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Gjirokastrës, është vlerësuar si i domosdoshëm ky workshop për të ndërgjegjësuar komunitetin e biznesit mbi zbatimin e rregullave të konkurrencës në treg, eliminimin e konkurrencës së pandershme dhe informalitetit në ekonomi dhe vënien në kushte të barabarta të biznesit nga ana e organeve të pushtetit qendror dhe vendor, organeve fiskale, prokurimeve publike etj.

Përfaqësuesit e Autoritetit të Konkurrencës prezantuan shtyllat kryesore të Ligjit të konkurrencës dhe rastet e zbatimit praktik, kryesisht lidhur me abuzimin me pozitën dominuese, marrëveshjet e ndaluara, kontrollin e përqëndrimeve, të drejtat ekskluzive dhe advokacinë e konkurrencës.

Përfaqësuesit e sektorit të ndihmës shtetërore paraqitën specifikat e ligjit të ndihmës shtetërore dhe rastet e verifikimit të ndihmës shtetërore të dhëna nga organet e pushtetit vendor, të cilat duhet të njoftojnë për të marrë autorizimin e Komisionit të Ndhmës Shtetërore pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

#### **IV. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR**

Rritja e rolit të Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës në rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare të konkurrencës ka qenë një nga objektivat për të cilën është punuar gjatë vitit 2014. Për më tepër institucioni i konkurrencës është pjesë e rrjetit ndër-institucional të integritit, i cili luan rol koordinues për një kapitull të veçantë, si dhe kontribuon në plotësimin e detyrimeve dhe raportimin edhe të kapitujve të tjerë.

##### **IV.1 BASHKËPUNIMI ME KOMISIONIN EUROPIAN**

Bashkimi European në Qershor 2014 i ka hapur rrugën Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE, duke vendosur pro statusit të vendit kandidat dhe duke vlerësuar kështu reformat e ndërmarra nga Qeveria Shqiptare. Me marrjen e statusit, përpjekjet e Shqipërisë dhe të gjithë institucioneve shqiptare, përfshirë edhe Autoritetin e Konkurrencës, do të përqendrohen në çeljen e negociatave për anëtarësim në BE.

##### **Marrëdhëniet me Ministrinë e Integritit European**

Autoriteti i Konkurrencës edhe gjatë 2014 ka mbajtur kontakte të rregullta me Ministrinë e Integritit European si institucioni koordinues i të gjitha përpjekjeve të vendit drejt integritit european. Në raportet periodike të përgatitura, AK ka pasqyruar progresin e arritur në drejtim të realizimit të masave ligjore dhe aktiviteteve zbatuese, sipas afateve të parashikuara në Planin Kombëtar për Integritimin European (PKIE), si dhe përshkrimin e shkallës së përputhshmërisë së akteve juridike të miratuara në fushën e konkurrencës nën mbikëqyrje me *acquis communautaire*. Autoriteti i Konkurrencës është institucioni



koordinues për Kapitullin 8 “Politika e Konkurrencës” në kuadrin e Raport Progresit të Komisionit European për Shqipërinë. Shqipëria ka bërë progres në drejtim të përafrimit të legjislacionit të saj me kërkesat e BE-së, në drejtim të përmbushjes së kriterit ligjor për anëtarësim.

Zbatimi dhe implementimi i MSA-së nga ana e Shqipërisë, ka vazhduar të monitorohet rregullisht edhe në takimet vjetore të Komitetit të Stabilizim Asocimit, i përbërë nga përfaqësues të shtetit shqiptar dhe institucioneve të BE-së. Autoriteti i Konkurrencës ka marrë pjesë dhe ka kontribuar me materiale në takimin e këtij komiteti, të mbajtur në muajin Mars 2014. Gjithashtu, përfaqësuesit e institucionit kanë marrë pjesë edhe në takimet e radhës të Nënkomitetit BE-Shqipëri për “Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën”, (Prill 2014), ku është raportuar mbi punën në lidhje me aktivitetin e institucionit, vendimet e marra, përmirësimin e kuadrit rregullator në fushën e konkurrencës etj. Gjithashtu, Autoriteti i Konkurrencës raporton sa herë kërkohet nga Ministria e Integritit në lidhje me aktivitetin e institucionit, zbatueshmërinë e ligjit, rritjen e kulturës dhe advokacisë së konkurrencës, nismat e reja ligjore etj.

Me anë të instrumentit TAIEX (Technical Assistance and Information Exchange), i cili mundëson asistencë afatshkurtër nga BE-ja me qëllimin për të njohur, zbatuar dhe përforcuar legjislacionin e BE-së, Autoriteti i Konkurrencës, gjatë vitit 2014, ka kryer një aktivitet/workshop me ekspertë të disa prej Autoriteteve të Konkurrencës të shteteve anëtare të BE-së me temë “Zbulimi i karteleve pa evidenca direkte/analizat ekonometrike”. Çështjet e zgjedhura për këshillim ose trajnim kanë qenë ngushtësisht të lidhura me procedurat hetimore në rastin e zbulimit të marrëveshjeve të ndaluara pa evidenca direkte.

Që në fillimet e tij, Autoriteti i Konkurrencës duke qenë një institucion i ri, të cilit i nevojitej një eksperiencë e konsoliduar, një praktikë pune e unifikuar, një eksperiencë e vendeve të rajonit apo më gjerë, ka qenë gjithnjë i angazhuar në forcimin e kapaciteteve investiguese, kryesisht të burimeve njerëzore që merren drejtpërdrejtë me hetimin administrativ por jo vetëm.

Autoriteti i Konkurrencës, gjatë eksperiencës së tij, tashmë 10-vjeçare, ka qenë jo vetëm pjesëmarrës në aktivitete të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, por ka qenë dhe promotor i këtyre aktiviteteve. Kjo është arsyeja edhe pse institucioni jonë ka marrë pjesë aktivisht dhe vazhdon të marrë pjesë në trajnimet e ndryshme në fushën e konkurrencës.

## **IV.2 BASHKËPUNIMI ME RRJETIT NDËRKOMBËTAR TË KONKURRENCËS (ICN) DHE AUTORITET E RAJONIT**

Në datat 23-25 Prill 2014 Autoriteti Konkurrencës ka marrë pjesë në konferencën vjetore të ICN-së, të mbajtur në Marakesh. Konferenca ishte organizuar me sesione dhe nënsesione. Sesioni i parë kishte të bënte me praktikën antikartel duke pasur në fokus procedurat hetimore për zbulimin dhe ndëshkimin e karteleve. U diskutuan skenare hipotetike për implementimin e programit të lehtësimit, zbulimin e karteleve pa programin e lehtësimit, paaftësia e pagesës së gjobave, vendosja e gjobave, etj. Gjithashtu u diskutua për mbledhjen e evidencave digitale, ku jepen resurset për mbledhjen e evidencave digitale, praktikën më të mira të grumbullimit të evidencave, fuqia për evidencat ligjore të grumbulluara, avantazhet etj.

Sesioni i dytë ishte në lidhje me advokatesinë e konkurrencës. Në këtë sesion u paraqit një manual me praktikën më të mira të studimit të tregut. Informacioni mbi studimet e tregut do të ndihmojë mbi identifikimin e çështjeve për studim, identifikimin e rrugëve për probleme të veçanta të tregut, identifikimi i anëtarëve të ICN, të cilët janë të aftë të asistojnë/këshillojnë mbi eksperiencat e tyre në udhëheqjen e studimeve të tregut në sektorë të veçantë etj.

Sesioni i tretë u mbajt mbi efektivitetin e agjencisë, ku synohej të identifikoheshin elementët kryesorë që kontribuojnë në ndërtimin e kapaciteteve të suksesshme dhe implementimin e politikës së konkurrencës në ekonominë në zhvillim dhe në tranzicion.

Seksioni i katërt kishte të bënte me analizat e përqëndrimeve. Qëllimi i materialeve të paraqitura ishte t'i japë shtysë adoptimit të praktikave më të mira në paraqitjen e përqëndrimeve. U paraqitën praktikën e rekomanduara për përcaktimin e tregut. Këto praktika të reja të rekomanduara u pasuan nga disa praktika për analizën e përqëndrimeve si: kuadri ligjor, struktura e tregut, hyrja në treg dhe zgjerimi, analiza e konkurrencës në përqëndrimet horizontale, etj. Një rëndësi ju kushtua Testit të Monopolistit Hipotetik "SSNIP" .

### **IV.3. BASHKËPUNIMI ME AGJENCINË E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR TREGTINË DHE ZHVILLIMIN – UNCTAD**

Në datat 29 janar -1 shkurt 2014, vizitoi Tiranën Z. Hassan Qaqaya, kreu i divizionit për politikën e konkurrencës dhe mbrojtjen e konsumatorit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD). Kjo vizitë u krye në kuadër të një vlerësimi të kërkuar nga ana e Autoritetit të Konkurrencës, mbi veprimtarinë e këtij institucioni nga ana e UNCTAD dhe vendeve anëtare të këtij institucioni të rëndësishëm ndërkombëtar.

Gjatë kësaj vizite Z. Qaqaya u takua me Komisionin e Konkurrencës, stafin e Autoritetit të Konkurrencës, për të diskutuar për këtë proces. Gjithashtu Z. Qaqaya dhe Kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës, Znj. Lindita Milo, zhvilluan takime me Z. Ilir Meta, Kryetar i Kuvendit, Znj. Zineb Touimi-Benjelloun, Koorditore e Përhershme e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, Znj. Eralda Cani, Këshilltare e Kryeministrit për të drejtën publike, Znj. Floreta Luli-Faber, Drejtoreshë Ekzekutive, Dhoma Amerikane e Tregtisë, Blerina Raca, përfaqësuese e GIZ etj.

Gjatë procesit të vlerësimit (Peer Review), ekspertët e pavarur të UNCTAD do të përgatisin një raport mbi përmirësimet e mundshme dhe mbi vlerësimin e nevojave të Autoritetit të Konkurrencës, për të kryer këto përmirësime. Ky raport, do të shërbejë si bazë për vlerësimin nga autoritetet përgjegjëse për konkurrencën të 192 vendeve anëtare të UNCTAD gjatë seancës vjetore të Grupit Ndërqeveritar të Ekspertëve (IGE).

Në datat 6-10 të muajit korrik në Gjenevë, nga UNCTAD gjatë Konferencës Vjetore, do të organizohet një seancë e plotë për Shqipërinë, Autoritetin e Konkurrencës dhe politikën e konkurrencës, të cilat janë analizuar nëpërmjet një raporti shumë të detajuar nga ekspertët e UNCTAD. Gjetjet e këtij raporti, si dhe funksionimi institucional dhe shkalla e zbatimit të së drejtës së konkurrencës do të jenë objekt diskutimi nga të gjithë të pranishmit, të cilët janë përfaqësues nga të gjitha vendet.

Ky proces ofron një mundësi unike për të shqyrtuar dhe nxjerrë mësim nga përvojat dhe sfidat me të cilat përballen vendet e ndryshme në zbatimin e politikave të konkurrencës. Raportet e prodhuara gjatë procesit lidhur me gjendjen e ligjit të konkurrencës dhe zbatimin në vende të përfshira janë të paanshëm dhe rigorozë të kryera nga ekspertë të politikës së konkurrencës si nga vende të zhvilluara ashtu edhe në zhvillim të cilët kanë përvojë praktike në zbatimin e ligjit të konkurrencës.

Proçesi i vlerësimit është interaktive dhe kombinon shkëmbimin e përvojave me rekomandime për përmirësime të mundshme qoftë në formulimin e ligjit të konkurrencës

ose në zbatimin e tij. Më tej, ai ofron për vendet e interesuara në zhvillim asistencë teknike në rast se ata janë të gatshëm për të zbatuar rekomandimet përkatëse.

#### ***IV.4 MEMORANDUMI ME AUTORITETIN AUSTRIAK TE KONKURRENCËS***

Në datë 12.12.2014, në Vjenë u nënshkrua memorandumi mes Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës dhe Autoritetit Federal Austriak të Konkurrencës, me qëllim për të nxitur bashkëpunimin në fushën e politikës së konkurrencës dhe zbatimit të ligjit të konkurrencës.

Marrëveshja u nënshkrua respektivisht nga Z. Theodor Thanner, Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Federal Austriak të Konkurrencës dhe Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetare e Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës, në prani të ambasadorit shqiptar në Austri Z. Roland Bino dhe Z. Alexander Italianer, Drejtor i Përgjithshëm për Konkurrencën në Komisionin Europian.

Sipas memorandumit, dy autoritetet, duke synuar krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe bazuar në parimet e barazisë dhe përfitimit të ndërsjellë si dhe duke nënvizuar rolin e konkurrencës në zhvillimin real dhe efektiv të ekonomisë së tregut, kanë rënë dakord të nxisin dhe forcojnë bashkëpunimin në zbatim të ligjit dhe politikës së konkurrencës, në përputhje me legjislacionin kombëtar të Shteteve të Palëve.

Në interes të ndërsjellë të dy autoriteteve, bashkëpunimi do të realizohet në drejtimet themelore të mëposhtme: (a)shkëmbimi i informacionit mbi zhvillimet legjislative; (b)shkëmbimi i eksperiencës në fushën e hetimeve në lidhje me shkeljen e rregullave të konkurrencës, duke respektuar dispozitat e kuadrit ligjor përkatës në fuqi në të dy vendet; dhe (c) shkëmbimi i përvojës me marrëdhëniet midis autoriteteve të konkurrencës dhe agjencive rregullatore kombëtare.

Gjithashtu delegacioni i Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës mori pjesë në konferencën dy ditore të Konkurrencës mbi “Praktikat më të mira të hetimeve” si dhe “Pavarësia dhe strukturat e autoriteteve kombëtare të konkurrencës në kontekstin europian” të moderuara respektivisht nga Z. Hassan Qaqaya, shefi i Divizionit të Ligjit të Konkurrencës në UNCTAD dhe Z. Alexander Italianer, drejtor i përgjithshëm për Konkurrencën në Komisionin Europian.

## **V. ADMINISTRIMI I BURIMEVE NJERËZORE**

Forcimi i kapaciteteve institucionale ka qenë një nga prioritetet e vitit 2014, pasi është konsideruar si një nga faktorët kryesorë për pavarësinë reale të institucionit të konkurrencës. Risetë e ligjit të nëpunësit civil janë përdorur si instrumenta për të ndërtuar sistemin e matjes së performancës reale të secilit prej nëpunësve të Autoritetit duke synuar rritjen e motivimit. Ndërtimi i sistemit të menaxhimit të eksperiencave, të cilat janë materializuar në dokumentacionin e plotë të çështjeve të përfunduara si dhe disponimi i botimeve të rasteve në kohë reale të praktikës ndërkombëtare, kanë qenë disa nga aspektet e investimeve që pritet të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe përmirësimin e nivelit të ekspertizës.

### ***V.1 STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE FUNKSIONET E AUTORITETIT TË KONKURRENCËS***

Struktura organizative e Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit 2014 nuk ka patur ndryshime në aspektin organizativ por ka patur shtim të numrit të punonjësve me një vend, e cila miratuar dhe paraqitet në Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë Nr.68/ 2014, për një shtese në vendimin nr. 7/2012. Ku numri i punonjësve tashmë behet 36 vete, nga të cilët 27 vetë janë staf teknik i përbërë nga ekonomistë dhe juristë (14 ekonomistë 10 juristë, 2 informaticienë dhe gjuhë e huaj) si dhe personeli mbështetës.

Autoriteti i Konkurrencës përbëhet nga Komisioni i Konkurrencës, si organ vendimmarrës dhe Sekretariati si organ administrativ dhe hetimor. Në shtojcën nr.9 “Struktura e Autoritetit të Konkurrencës” bashkëlidhur është vendosur organograma e Autoritetit të Konkurrencës.

#### **Komisioni i Konkurrencës:**

Përbëhet nga pesë anëtarë, të votuar në mënyrë nominale nga Parlamenti. Aktualisht Komisioni ka në përbërjen e vet tre ekonomistë dhe dy juristë. Tre nga pesë anëtarët janë në mandatin e tyre të dytë, duke mundësuar një vazhdimësi në veprimtarinë vendimmarrëse të institucionit. Transparenca, paanësia, barazia, dhe objektiviteti kanë qenë parimet bazë të funksionimit dhe të vendimmarrjes së Komisionit. Përmirësimi i vazhdueshëm nëpërmjet debatit dhe mendimit alternativ kanë qenë karakteristikat e veprimtarisë së Komisionit të Konkurrencës për forcimin e zbatimit të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

## **Kabineti**

Është njësi që funksionon pranë Komisionit duke asistuar për organizimin dhe mirëfunksionimin e mbledhjeve të Komisionit, ndërlidh punën midis Komisionit dhe Sekretariatit, organizimin e seancave dëgjimore, marrëdhëniet me Kuvendin, marrëdhëniet me mediat, marrëdhëniet me jashtë, kujdesi për instrumentat e advokacisë dhe kulturës së konkurrencës etj.

## **Sekretariati**

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës është organi administrativ i ngarkuar me ligj për të kryer monitorimin dhe hetimin për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në treg. Sekretariati përbëhet nga tre drejtori dhe sektori i analizës.

Drejtorja mbikëqyrjes dhe e hetimet të tregut realizon procesin e mbikëqyrjes dhe të investigimit të sjelljes së ndërmarrjeve në treg në zbatim të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Politikës Kombëtare të Konkurrencës. Kjo drejtori përbëhet nga tre sektorë të emërtuar sipas tre shtyllave kryesore që prezantohen në Ligj, sektori i abuzimit me pozitën dominuese, sektori anti-kartel dhe sektori i përqëndrimeve.

Drejtorja Juridike, e Hetimit dhe Proçedurave realizon argumentimin juridik të produkteve të veprimtarisë së Sekretariatit, merr pjesë në grupet e punës hetimore në bashkëpunim me Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Tregut, dhe përfaqëson Autoritetin në proceset gjyqësore në mbrojtje të Vendimeve të Komisionit ndaj akt-padive nga palët e prekura.

Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Integritit European është pjesa e strukturës së funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës e cila realizon kryesisht përafrimin e legjislacionit të konkurrencës me atë të BE, si dhe menaxhimin e burimeve njerëzore në përputhje me kërkesat dhe proçedurat e Ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, programon zhvillimin e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve, duke shfrytëzuar të gjitha burimet mundshme si OECD, ICN, RCC, ITAP, Universiteti i Tiranës etj. Një drejtim tjetër i punës së kësaj drejtorie është mbulimi i veprimtarisë financiare të Autoritetit dhe mbajtja e përgjegjësisë së plotë për të gjitha proçedurat e hartimit dhe të administrimit të fondeve të buxhetit, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e buxhetit të Shtetit Shqiptar.

Sektori i studimit dhe analizës ka si mision realizimin e monitorimeve sistematike të tregjeve sipas detyrave të përcaktuara nga vendimet e Komisionit të Konkurrencës, si dhe vëzhgimin e kushteve dhe kryerjen e analizave ekonomike të strukturave të ndryshme të tregjeve.

## **V.2 RITJA E KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE**

Rritja dhe forcimi i kapaciteteve administrative përbën një nga sfidat e vazhdueshme të Autoritetit të Konkurrencës. Aktualisht në këtë institucion prej 36 punonjësish janë me titullin profesor 2, Ass prof. 1, në proçes doktorature 4 vete, me master 15 vetë nga të cilët 1 në proçes, me diplome masteri jashtë vendit 3 vete dhe të diplomuar jashtë 2 vetë.

Në vitin 2014, është realizuar një numër i madh trajnimeve për stafin e Autoritetit të Konkurrencës. Gjatë vitit 2014 në qendrën e OECD-së për Konkurrencën në Budapest janë zhvilluar trajnimet si vijon: Seminari mbi ligjit European të Konkurrencës për gjyqtarët për rastet e abuzimit me pozitën dominuese, Workshop mbi praktikën dhe procedurat për përqendrimet, Seminar për marrëveshjet në oferta dhe prokurimet publike, Seminar mbi çështjet e konkurrencës në tregjet e pakicës dhe seminar mbi evidencat në rastet e abuzimit me pozitën dominuese.

Trajnime janë zhvilluar në UNCTAD, Forumin European të Konkurrencës, Forumin Botëror të Konkurrencës, pranë Autoritetet Italian dhe Austriak të Konkurrencës, Traktatit të Energjisë, SETTO në transportin hekurudhor etj.

## **V.4 MANAXHIMI FINANCIAR**

Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2014 ka zbatuar me korrektësi kërkesat e Ligjit Nr.185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014". Administrimi i vlerave materiale dhe monetare është konsideruar një fushë e rëndësishme e punës tonë duke zbatuar me korrektësi të gjitha aktet ligjore e nënligjore dhe normativat në përdorimin e fondeve buxhetore.

Sektori i financës në këtë institucion planifikon dhe ndjek miradministrimin e shpenzimeve buxhetore të miratuara, të cilat janë të lidhura me aktivitetin e institucionit, Në tërësinë e vet ky sektor ka ndikuar në realizimin e objektivave që ka institucioni.

Buxheti i miratuar për vitin 2014 është realizuar në masën 94%. Informacioni i detajuar jepet në pasqyrën e paraqitur në shtojcën 10 "Buxheti faktik i Autoritetit të Konkurrencës viti 2014". Mosrealizimi në masën 6 % ka ardhur kryesisht nga fondet e mbetura nga procedurat e prokurimeve të kryera gjatë vitit si dhe nga një pozicion inspektori i paplotësuar.

## **VI. PRIORITETET PËR VITIN 2015**

Prioritetet për vitin që ka filluar janë përcaktuar mbi bazën e parimit të vazhdimësisë së çështjeve të nisura gjatë vitit 2014, reagimit ndaj shqetësimeve të tregut të adresuara nga ankesat e operatorëve të tregut apo konsumatori apo të përcjella nga mediat, si dhe rekomandimeve të raportit të vlerësimit të zbatimit të ligjit dhe të politikës së konkurrencës si dhe të funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës, i realizuar nga UNCTAD.

### ***VI.1. FORCIMI I ZBATIMIT TË LIGJIT TË KONKURRENCËS***

Autoriteti i Konkurrencës ka filluar punën për vitin 2015 me një axhendë të qartë të sektorëve prioritarë për ndërhyrjen me qëllim rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Ndërkohë pritet që tendenca e ankesave të vazhdojë të paktën me të njëjtin ritëm për të na mundësuar ndërhyrjen dhe marrjen e masave ndëshkuese dhe rregulluese në ato tregje apo sektorë të ekonomisë ku sjellja e një ose disa operatorëve ka cenuar konkurrencën në treg.

Ndër sektorët kryesorë janë sektori i komunikimeve elektronike, energjia dhe gazi, bujqësia, sektori financiar (Sektori bankar (tregu i kredisë)) etj. ndërkohë që pritet që një sërë procedurash hetimore të hapen dhe bazohen në ankesat e ndërmarrjeve në tregje dhe sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Për vitin 2015 është realizuar monitorimi në tregun e prodhimit dhe shitjes së vezëve dhe pas konstatimit të rritjes së fortë me rreth 30 % dhe të menjëhershme të çmimit të vezëve është vendosur hapja e procedurës së hetimit paraprak.

Gjithashtu në bazë të një metodologjie të MLEX po zhvillohet monitorimi në tregun e interesit të produkteve bankare (overdraft/ kredi konsumatore) me qëllim krahasimin e normave të interesave të aplikuara nga bankat për overdraft dhe kreditë konsumatore ndaj interesit të depozitave, bonove e thesarit dhe normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë.

Monitorimi i tregut të importit dhe shitjes me shumicë të gazit do të vazhdojë për shkak të dominancës individuale që ka një shoqëri në këtë treg.

### ***VI.2. PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT***

Në kuadër të vëmendjes së Autoritetit të Konkurrencës edhe për vitin 2015 do të jetë përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullativ nëpërmjet hartimit të ligjeve dhe rregulloreve apo amendimeve të tyre, rritja e shkallës së përafrimit me direktivat e BE-së dhe me



standardet e parimet ndërkombëtare të konkurrencës. Janë identifikuar nevojat për përmirësime të mëtejshme legjislative në fushën e konkurrencës të cilat janë pasqyruar edhe në Planin Kombëtar për Integrimin Europian.

Kuadri ligjor dytësor i Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2015 do të plotësohet me dy akte të tjera nënligjore dhe konkretisht me Udhëzimin “Për vlerësimin e kufizimeve vertikale” si dhe me Udhëzimin “Për masat e Komisionit në rastet e përqendrimeve”.

### ***VI.3. HARTIMI I DOKUMENTIT TË RI TË POLITIKËS SË KONKURRENCËS***

Gjatë vitit 2014 Autoriteti i Konkurrencës është angazhuar të rishikojë dokumentin e Politikës Kombëtare të Konkurrencës proces i cili do të finalizohet gjatë 2015.

Qëllimi i rishikimit të Politikës është inkurajimi i ndërmarrjeve, për inovacion, efikasitet dhe zgjedhje me të gjerë, duke i mundësuar konsumatorëve blerjen e të mirave dhe shërbimeve që ata dëshirojnë me çmimin më të mirë të mundshëm. Gjithashtu, ky proces bazohet në koordinimin dhe bashkëpunimin ndërinstytucional midis institucioneve qendrore dhe rregullatore me Autoritetin e Konkurrencës, pasi Politika Kombëtare e Konkurrencës është produkt integral i të gjithë faktorëve për të mundësuar rritjen e konkurrueshmërisë kombëtare, në kërkim të përmirësimit të procesit konkurrues, për t'i siguruar konsumatorëve që të ndiejnë përfitimet nga ky proces.

### ***VI.4 BASHKËPUNIMI ME GJYQËSORIN***

Në lidhje me bashkëpunimin e Autoritetit të Konkurrencës dhe sistemit gjyqësor, i cili është institucioni që bën rishikimin e vendimeve të Komisionit të Konkurrencës dhe nevojat për të realizuar trajnime me gjyqtare të gjykatave administrative për të realizuar një gjykim sa me objektiv dhe të bazuar në ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra nga Komisioni i Konkurrencës.

Në kuadër të këtij procesi kemi filluar një bashkëpunim me shkollën e magistraturës e cila është treguar e gatshme të bashkëpunojë me Autoritetin për realizimin e këtyre trajnimeve nëpërmjet saj duke vendosur edhe temat përkatëse që parashikon Ligji “Për mbrojtjen e konkurrencës” siç janë marrëveshjet e ndaluara, abuzimi me pozitën dominuese si dhe procedurat hetimore që ndiqen gjatë procesit të hetimit nga vetë Autoriteti. Në këto procese trajnimi do të përfshihen edhe Komisionerë të Autoritetit të Konkurrencës duke përcjellë gjithë procesin që realizohet në Autoritetin e Konkurrencës deri në vendimmarrje, duke dhënë kështu eksperiencën më të mirë për sistemin gjyqësor administrativ në këtë rast.

### ***VI.5 RITJA DHE FORCIMI I KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE***

Forcimi i kapaciteteve administrative nëpërmjet trajnimeve të planifikuara sipas kërkesave të drejtorive dhe rekomandimeve të Komisionit Europian në Progres Raportin

e fundit do të realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes në seminarët trajnuese që do të organizohen nga RCC (OECD), ICN etj. Ligji i Buxhetit i vitit 2015 i ka njohur Autoritetit shtesën e një vendi, proces i cili është për miratim nga Kuvendi i Shqipërisë nëpërmjet aprovimit të shtesës në strukturë me një pozicion inspektor në Drejtorinë Juridike Hetimit dhe Procedurave. Në këtë mënyrë plotësohet struktura organizative sipas kërkesave në rritje si dhe përmbushjen e sugjerimeve të Raport-Progressit të Komisionit European.

Stafi i Autoritetit të Konkurrencës do të marrë pjesë në workshope apo konferenca të organizuara nga rrjete ndërkombëtare të konkurrencës apo asistencën teknike të UNCTAD, i cili do të adresojë nevojat e identifikuara nga raporti i vlerësimit të kapaciteteve të Autoritetit, me qëllim mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg nëpërmjet parandalimit dhe zbulimit të praktikave anti konkurruese.

## **SHTOJCA**

**Shtojcë 1: Të dhëna statistikore mbi vendimet e Komisionit të Konkurrencës sipas viteve**

Viti	Vendime në total	Përqendrime	Abuzimin me Pozitën Dominuese	Marrëveshje Të ndaluara	Përjashtime nga Marrëveshjet	Rregullore dhe Udhëzues	Rekomandime ndaj Institucioneve Publike	Vendime për vendosje gjobe	Masa të përkohshme	Kushte dhe detyrime	Vendime të tjera
2004	13	2				6	1	-			4
2005	17	-				2	3	1			12
2006	14	4				-	1	1			9
2007	25	9	1	3		4	2	5			6
2008	29	11	1		1	4	5	-			7
2009	36	8	1	2	1	2	10	2			12
2010	34	6	3	2	-	7	5	2			11
2011	43	10	2	2	-	6	5	1			18
2012	48	9	2	2	1	5	5	7			24
2013	42	13	0	1	1	3	1	2	1		22
2014	42	8	3	7	1	2	4	2	0	1	14
<b>Total</b>	<b>343</b>	<b>80</b>	<b>13</b>	<b>19</b>	<b>5</b>	<b>41</b>	<b>42</b>	<b>23</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>139</b>

## **Shtojca 2: Lista e vendimeve te komisionit te konkurrencës**

1. Vendim Nr. 302 dt. 14/1/2014 – “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve të duhanit”
2. Vendim Nr. 303 dt. 16/1/2014 – “Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e telefonisë celulare me pakicë ndaj ndërmarrjes “Vodafone Albania” SHA dhe rekomandime për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare”;
3. Vendim Nr. 304 dt. 27/1/2014 – “Për një ndryshim në Vendimin nr.292, datë 16/9/2013 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve për kufizime të mundshme të konkurrencës”;
4. Vendim Nr. 305 dt. 14/2/2014 – “Për ndryshime në vendimin e KK nr.330, datë 6/12/2013 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimeve për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregtimin e produktit policë sigurimi për mjetet e transportit për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”;
5. Vendim Nr. 306 dt.19/2/2014 – “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Qarkun e Dibrës”
6. Vendim Nr. 307 dt. 21/2/2014- Për miratimin e Raportit Vjetor mbi “Mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2013 dhe synimet kryesore për vitin 2014”;
7. Vendim Nr. 308 dt.21/2/2014- “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të transportit ajror”;
8. Vendim Nr. 309 dt.6/3/2014- “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të përbashkët në mënyrë të tërthortë në shoqërinë Beralb SH.A nëpërmjet transferimit të 50% të aksioneve të shoqërisë Nesko Metal Sanayi Ve Ticaret AS, nga shoqëria Ekin Maden Ticaret ve Sanayi AS tek shoqëritë Jiangxi Copper Company Limited, Beijing Meal Challenge Global Trading Co.LTD dhe CRM International (Beijing) Co.LTD”;
9. Vendim Nr. 310 dt.31/3/2014- “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”;
10. Vendim Nr. 311 dt. 17/4/2014- “Kërkesë për sigurimin e të dhënave financiare të shoqërisë Anika Enterprises S.A”;
11. Vendim Nr. 312 dt. 18/4/2014- “Për disa rekomandime në lidhje me funksionimin e tregut të shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve”;
12. Vendim Nr. 313 dt. 30/04/2014- “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të biznesit të markës ACE nga shoqëria Fater S.p.a me anë të blerjes së aseteve nga shoqëria Thë Procter and Gamble”;
13. Vendim Nr. 314 dt. 8/5/2014- “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit, shitjes me shumicë dhe pakicë të duhanit”;
14. Vendim Nr. 315 dt. 13/5/2014- “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve të karburantit”;
15. Vendim Nr. 316 dt. 23/5/2014- “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve”;

16. Vendim Nr. 317 dt. 23/5/2014- "Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Dibrës";
17. Vendim Nr. 318 dt. 2/6/2014- "Vendosje gjobe ndaj ndërmarrjes Heaney Assets Corporation për mosdhënie të dhënash brenda afatit kohor të përcaktuar në Vendimin e Komisionit";
18. Vendim Nr. 319 dt. 13/6/2014- "Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e konçesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit";
19. Vendim Nr. 320 dt. 24/6/2014- "Për shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjeve "KASTRATI" SHA dhe KASPETROL SHA për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr.315, datë 13/5/2014 "Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit, dhe shitjes me shumicë të karburanteve";
20. Vendim Nr. 321 dt. 1/7/2014- "Për shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjes "Rapidscan Systems ICN" për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr.319 dt. 16/6/2014 "Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit";
21. Vendim Nr. 322 dt. 3/7/2014- "Për miratimin e Rregullores "Për kategoritë e marrëveshjeve, vendimeve, dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e transportit detar të mallrave";
22. Vendim Nr. 323 dt. 8/7/2014- "Për vlerësimin e ankesës së ndërmarrjes "Pelikan Security" Sh.p.k në lidhje me procedurat e prokurimit publik me objekt "Shërbim I ruajtjes dhe sigurisë fizike";
23. Vendim Nr. 324 dt. 30/7/2014- "Për vendosjen e kushteve dhe detyrimeve ndaj shoqërive të sigurimit për rivendosjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta";
24. Vendim Nr. 325 dt. 30/7/2014- "Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për nxitjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta";
25. Vendim Nr. 326 dt. 8/9/2014- "Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e tregtimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes";
26. Vendim Nr. 327 dt. 8/9/2014- "Për shqyrtimin e ankimit administrative të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për revokimin e Vendimit Nr. 325, dt. 30/7/2014 të Komisionit të Konkurrencës";
27. Vendim Nr. 328 dt. 11/9/2014- "Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit nga Alpha Bank S.A të aseteve të zotëruara nga Citi Bank International PLC që I përkasin aktivitetit të shërbimeve bankare në Greqi dhe të ndërmarrjes Dinars Club of Greece Finance Company S.A";
28. Vendim Nr. 329 dt. 29/9/2014- "Për një ndryshim në vendimin nr. 316 dt. 23/5/2014 "Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtarë detar të udhëtarëve dhe automjeteve";

29. Vendim Nr. 330 dt.3/10/2014- “Mbi Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të plotë nga Shoqëria Ferrero International S.A të shoqërive të Oltan Group”;
30. Vendim Nr. 331 dt.7/10/2014- “Mbi Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të 76% të aksioneve të CEZ SHA nga shoqëria CEZ A.S tek Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”;
31. Vendim Nr. 332 dt.9/10/2014-Udhezimi “ Mbi vlerësimin e pozitës dominuese dhe abuzimit me pozitën dominuese”;
32. Vendim Nr. 333 dt.21/10/2014- “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Ndërtim I Rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut- Bregu I lumit) loti1, loti 2, loti3.”;
33. Vendim Nr. 334 dt.31/10/2014- “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e prokurimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes”;
34. Vendim Nr. 335 dt.31/10/2014- “Mbi Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të plotë nga shoqëria TransAtlantic Petroleum Ltd të shoqërisë Stream Oil & Gas Ltd”;
35. Vendim Nr. 336 dt.11/11/2014- “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare ndaj shoqërisë Vodafone SH.A”;
36. Vendim Nr. 337 dt.11/11/2014-“ Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin, dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, sipërmarrjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave”;
37. Vendim Nr. 338. dt.11/11/2014- “Mbi përjashtimin individual nga ndalimi të Marrëveshjeve-Tip mes shoqërisë “Digitalb” SH.A dhe operatorëve televiziv”;
38. Vendim Nr. 339 dt.24/11/2014- “Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit nr.324, datë 30/7/2014, të Komisionit të Konkurrencës mbi kushtet dhe detyrimet ndaj shoqërive të sigurimit për rivendosjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik”;
39. Vendim Nr. 340 dt.27/11/2014-“ Mbi Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të pavarur CMA CGM Albania Sh.p.k nga ndërmarrjet CMA CMG Agencies Eorldeide dhe Pelikan Sh.p.k”;
40. Vendim Nr. 341 dt.27/11/2014- “Për vendosjen e një gjobe të lehtë ndaj shoqërisë “Pelikan” Sh.p.k për njoftimin jashtë afatit të përqendrimit të realizuar me CMA CGMA Agencies Eorldeide për krijimin e ndërmarrjes së pavarur CMA CGMA Albania Sh.p.k”;
41. Vendim Nr.342 dt.27/11/2014- “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të cigareve të fabrikua”;
42. Vendim Nr.343 dt.4/12/2014- “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të 100% të kapitalit aksionar të Landeslease SH.A nga Union Bank SH.A”

### **Shtojca 3: Ekzekutimi i gjobave të vendosura nga Komisioni i Konkurrencës deri më 31 Dhjetor 2014**

<b>Gjobat e vendosura nga AK</b>	<b>Shuma në lekë</b>	<b>Përqindja ndaj totali<sup>3</sup></b>
Gjopa të vendosura në total	<b>1.037.199.298</b>	100
Gjopa të mbledhura nga përmbarimi	<b>259.831.233</b>	25. %
Gjopa në proces mbledhjeje nga përmbarimi	<b>45.711.419</b>	4.5%
Gjopa për të cilat nuk është marrë ende një vendim gjyqësor (ende pa FP)	<b>731.656.646</b>	70.5%

#### **I. Gjopa të derdhura në buxhetin e shtetit në total**

Procesi i ekzekutimit të gjobave të vendosura nga Komisioni i Konkurrencës

N/r	Ndërmarrja	Vlera (lekë)	Statusi
1	AMC SH.A	211,552,000	Pezulluar me vendim gjykatës së Lartë
2	Media Vizion	100,000	Pushuar si e ekzekutuar
3	Vodafone	242,633,000	Pushuar si e ekzekutuar
4	Intersig Sha	664,000	Pushuar si e ekzekutuar
5	Alban Tirana Co	447,915	Ka shlyer plotësisht detyrimin
6	Ferro Beton & Konstruksion	436,959	Ka shlyer plotësisht detyrimin
7	Shkodra Beton	396,974	Ka shlyer plotësisht detyrimin
8	Classic sh.p.k	25,712,000	Proces likuidimin vullnetar
9	Hyundai Auto Albania	5,383,000	Proces likuidimin vullnetar
10	Geci	100,000	Proces gjyqësor
11	Albanian Airline	2,600,000	Ekzekutim i detyrueshëm
12	Viloil	100,000	Ekzekutim i detyrueshëm
13	Ultra Motors	1,517,000	Ekzekutim i detyrueshëm
14	Kajo Hallka	30,000	Transferuar zyra përmbarimit Fier
	<b>Totali</b>	<b>491,672,848</b>	

#### **II. Gjopa të vendosura gjatë vitit 2014**

a) HEANEY ASSETS	100.000 lekë
b) PELIKAN SHPK	<u>100.000 lekë</u>
<b>Totali</b>	<b>200.000 lekë</b>

<sup>3</sup> Shifrat në përqindje janë të rrumbullakosura



**Shtojca 4 Lista e vendimeve shoqëruar me urdhër ekzekutimi**

Nr.	Vendimi i Komisionit	Lëshimi i Urdhrit të Ekzekutimit nga Gjykata	Debitor
1	Nr. 59 datë 09.11.2007 "Vendosje gjobe ndaj AMC SHA dhe Vodafone SHA"	Vendimi Nr. 3359 Akti datë 09.11.2010 (Vetëm për pjesën që i përket AMC)	AMC SHA
2	Nr. 66 datë 18.12.2007 "Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve që operojnë në tregun e betonit"	Vendimi Nr. 3357 Akti datë 22.12.2010	"Alban Tirana Co", "Best Construction Alb", "Beton Ekspres", "Ferro Beton & Const", "Halili", "Ital – Beton Const", "Kirchberger – Albania", "Qarri - 02", "Shkodra Beton"
3	Nr. 67 datë 24.12.2007 "Marrje sanksioni individual ndaj z. Kajo Hallka"	Vendimi Nr. 3356 Akti datë 10.12.2010	Kajo Hallka
4	Nr. 123 datë 08. 09. 2009 "Vendosje gjobe ndaj Albanian Airlines MAK SHPK.	Vendimi Nr. 3355 Akti datë 12.11.2010	Albanian Airlines MAK SHPK
5	Nr. 229 datë 03.07.2012 "Vendosje gjobe ndaj GECI SHPK për njoftimin e përqendrimit në shkelje të afatit ligjor"	Vendimi Nr. 9771 Akti datë 29.10.2012	GECI SHPK
6	Nr. 154 dt. 01.10.2011 (vetëm për pjesën që i përket ndërmarrjes "Hyundai Auto Albania" sh.p.k.)	Vendimit Nr. 1611 Akti datë 10.02.2012	"Hyundai Auto Albania" sh.p.k.
7	Nr. 239 datë 26.07.2012 "Vendosje gjobe ndaj Media Vizion",	Vendimit Nr. 9772 Akti datë 09.10.2012	Media Vizion
9	Vendimi i Komisionit të Konkurrencës Nr. 154 dt. 01.10.2011 (vetëm për pjesën që i përket ndërmarrjes "Ultra Motors" sh.p.k.)	Vendimit Nr. 1612 Akti datë 27.02.2012	"Ultra Motors" sh.p.k
10	Nr. 154 dt. 01.10.2011 (vetëm për pjesën që i përket ndërmarrjes "Classic" sh.p.k dhe "NOTI" SHPK)	Vendimit Nr. 2384 Akti datë 19.04.2013	"Classic" sh.p.k dhe "NOTI" SHPK
11	Nr. 265, datë 05.02.2013 "Për Vendosje Gjobe ndaj ndërmarrjes VILOIL" SHA	Vendimi Nr. 7677 Akti, datë 20.12.2013	"VILOIL" SHA
12	Nr. 221, datë 11.04.2012 "Për Vendosje Gjobe ndaj ndërmarrjes "Romano Port" SHA	Nr. 703 Regjistri, datë 23.05.2014	"ROMANO PORT" SHA
13	Vendimin Nr. 318, datë 02.06.2014 "Për Vendosje Gjobe ndaj Ndërmarrjes Heaney Assets Corporation	Nr. 934 Regjistri, datë 10.09.2014	"HEANEY ASSETS CORPORATION"

### Shtojca 5 Përqendrimit e njoftuara dhe të autorizuara

Nr.	Rasti i Përqendrimit	Tregu Përkates	Nr. i Vendimit	Data e Autorizimit	Procedura
1.	50% të aksioneve të Beralb SH.A./ Nesko Metal Sanayi Ve Ticaret AS/ Ekin Maden Ticaret Ve Sanayi AS/ Jiangxi Copper Company Limited, Beijing Metal Challenge Global Trading Co. Ltd dhe CRM International (Beijing) Co. Ltd.	Tregu i nxjerrjes/pasurimit të mineralit të bakrit dhe prodhimit të koncentratit të tij, dhe atë të eksportit të bakrit dhe nënprodukteve të tij	309	06.03.2014	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit
2.	ACE / Fater S.P.A /The Procter & Gamble.	Tregu i larësve shtesë/ produkteve ndihmës në larje	313	30.04.2014	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit
3.	Alpha Bank s.a., / CitiBank International PLC / Diners Club of Greece Finance Company S.A.	Tregu i shërbimeve bankare për individë, depozita e shërbime për llogaritë, kreditim	328	11.09.2014	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit
4.	Ferrero International S.A, / Oltan Group.	Prokurimi dhe shitja e lajthive, tregu i produkteve të ëmbla me përmbajtje çokollate (ëmbëlsirave të çokollatës) dhe tregu i kremrave të ëmbël lehtësisht të përhapshëm/ cokokremi.	330	03.10.2014	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit
5.	76% të aksioneve të shoqërisë CEZ SH.A. / CEZ A.S. / Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.	Tregu i shpërndarjes së energjisë elektrike dhe ai i furnizimit dhe shitjes së energjisë	331	07.10.2014	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit
6.	TransAtlantic Petroleum Ltd, / Stream Oil & Gas Ltd.	Tregu i kërkimit, zbulimit dhe prodhimit të gazit natyror dhe naftës	335	31.10.2014	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit
7.	CMA CGM Albania sh.p.k., / CMA CGM Agencies Eorldeide dhe Pelikan sh.p.k.	Tregu i transportit detar të kontejnerëve (import/eksport)	340	27.11.2014	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit
8.	100% e kapitalit aksionar të Landeslease SH.A. / Union Bank SH.A.	Tregu i qirasë financiare/ leasing	343	04.12.2014	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit

## **Shtojca 6 Rezoluta e kuvendit për veprimtarinë e autoritetit të konkurrencës**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**MIRATOHET  
KRYETARI  
ILIR META**

### **REZOLUTË**

#### **PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT**

#### **TË KONKURRENCËS PËR VITIN 2013**

##### **Kuvendi i Shqipërisë konstaton se:**

Veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës është ushtruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9121, datë 29.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", ndryshuar me ligjin nr. 9499, datë 3.4.2006.

##### **Kuvendi vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës në drejtim të:**

- Rritjes së besueshmërisë, të shprehur nëpërmjet numrit të çështjeve të ankimuara pranë Autoritetit të Konkurrencës;
- Rritjes së efikasitetit, të shprehur përmes numrit të çështjeve të trajtuara nga Autoriteti i Konkurrencës;
- Konsolidimit të profilit të tij publik, si institucion që mbron interesat e biznesit, nëpërmjet zbatimit të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës;
- Punës në vijimësi për të përafuar kuadrin ligjor me atë të vendeve të Bashkimit Europian;
- Punës në vijimësi për të përmirësuar kuadrin ligjor në fushën e konkurrencës;
- Punës në vijimësi për të rritur monitorimin në treg;
- Hartimit të dokumentit të ri të politikës së konkurrencës, në bashkëpunim me institucionet vendase dhe të huaja, komunitetin e biznesit dhe shoqatat konsumatore;
- Objektivit për të rritur kapacitetin e stafit të Autoritetit të Konkurrencës, për të pasur një rol më proaktiv në zgjidhjen e problemeve të marrëveshjeve të ndaluara, praktikave antikonkurrese dhe abuzimit me pozitën monopolistike.

##### **Kuvendi kërkon që Autoriteti i Konkurrencës, për vitin 2014, të përmirësojë punën në drejtim të:**

1. Fokusimit të veprimtarisë në sektorët më prioritarë të ekonomisë, ku përqendrimi i tregut në subjekte të caktuara ka sjellë deformime të funksionimit të tregjeve, si:

##### *Tregu i telefonisë celulare.*

- Tregu i telefonisë celulare është paraqitur problematik, pasi shihet një fenomen antikonkurrese, që lidhet me diferencimin e theksuar të tarifave të thirrjeve Brenda rrjetit dhe

atyre jashtë rrejtit nga operatorët e konsoliduar në treg, pavarësisht se kostot janë të përafërta. Ky fenomen, i cili kushtëzon sjelljen e konsumatorit dhe shkakton impakt negativ për konkurrencën e lire, ka sjellë që numri i thirrjeve brenda rrejtit të jetë në nivelin më të lartë në botë (97 për qind e thirrjeve brenda rrejtit, ku Kenia është e dyta me 96 për qind) dhe në përqendrim të tregut, ku një kompani e vetme ka rreth 50 për qind të tregut dhe dy kompanitë e para rreth 90 për qind. Për të zgjidhur këtë situatë, e cila krijon mure në treg, duke penguar konkurrencën, Kuvendi i kërkon Autoritetit të Konkurrencës që të intensifikojë bashkëpunimin me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

#### *Tregu i sigurimeve.*

- Në këtë treg, rënia e shpejtë e çmimeve, pas liberalizimit në nivele shumë të ulëta dhe jokonkurrese, cilësim ky që vjen si nga aktorët në treg, ashtu dhe nga organet mbikëqyrëse kompetente, nuk është zgjidhur, duke diversifikuar produktin, sipas modelit të propozuar (bonus-malus), por është bërë duke koordinuar rritjen e çmimit.

#### *Energjia.*

- Zbatimi i vendimeve të mëparshme në këtë sektor, të cilat rekomandojnë një rritje të numrit të aktorëve në treg, me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë dhe uljen e kostove për konsumatorët. Tregu i gazit të lëngshëm dhe problematika të tregjeve të tjera, të bëra publike nga operatorët, të cilat tregojnë brishtësinë e konkurrencës në Shqipëri.

2. Hetimit dhe zgjidhjes së problematikës së shërbimeve konçesionare, të dhëna në kushte monopoli nga Qeveria dhe Kuvendi, në të cilat kostot për qytetarët janë rritur në nivele shumë më të larta se në rajon, si:

- Shërbimi i kontrollit të automjeteve;
- Shërbimi i pajisjes me pulla fiskale;
- Shërbimi i markimit të karburanteve;
- Lotaria kombëtare;
- Shërbimi i skanimit të kontejnerëve pranë terminalit të Portit të Durrësit.

3. Rritjes së bashkëpunimit të Autoritetit të Konkurrencës me Qeverinë, KLD-në dhe me entet e tjera përgjegjëse.

- Deri më 31.12.2013, për 71,2 për qind të gjobave të vendosura nga Autoriteti i Konkurrencës nuk është marrë një vendim nga pushteti gjyqësor.
- Është vënë re se opinioni i Autoritetit të Konkurrencës nuk është marrë parasysh në vendime sensitive për konkurrencën në treg.
- Për mospërsëritjen e këtyre problematikave, Kuvendi i kërkon Autoritetit të Konkurrencës, organeve ekzekutive dhe gjyqësore të të gjitha niveleve të shkëmbejnë informacionin e nevojshëm për monitorimin e tregut, hetimin e praktikave që deformojnë konkurrencën dhe për konsultime të përhershme në procesin e përgatitjes dhe miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore.

4. Rritjes së transparencës së Autoritetit të Konkurrencës ndaj Kuvendit, Qeverisë, si dhe ndaj publikut të gjerë.

Miratuar në datën 29.5.2014

## **Shtojca 7 Kapitulli 8: Politika e konkurrencës, raporti i progresit, komisioni evropian**

*Në fushën antikartel dhe bashkimet, në nëntor, Autoriteti i Konkurrencës (AK) miratoi një vendim që jep orientime mbi vlerësimin e marrëveshjeve horizontale. Autoriteti mori 34 ankesa, kundrejt 19 në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, që çuan në nisjen e hetimeve në fusha si sigurimet, transporti publik, hidrokarburet dhe transporti detar. Gjithashtu, AK-ja filloi dhe finalizoi hetime edhe për shërbimet e telefonisë, tregjeve të duhanit dhe sigurisë private.*

*AK-ja nxori pesë vendime për marrëveshje anti-konkurrencë, një vendim për abuzim me pozitën dominuese në treg, si edhe katër vendime që autorizojnë bashkimet. AK-ja miratoi edhe tre vendime për vlerësimin e ankesave dhe dha përjashtim për një marrëveshje të ndaluar. AK-ja miratoi tre akte ligjore, dha pesë rekomandime dhe filloi nëntë procedura administrative. Në 2013 nuk janë vendosur gjoba, kundrejt shtatë në 2012.*

*Në qershor, AK-ja i vuri gjobë një shoqërie për vonesa procedurale. Gjithashtu, i dha rekomandime rregullatorit të telekomunikimit, Autoritet të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare si edhe qeverisë për dy koncesione.*

*Për sa i përket çështjeve gjyqësore, Autoriteti i Konkurrencës humbi një çështje në gjykatën e nivelit të parë, të cilën e ka ankimuar. AK-ja ka fituar dy nga tre apelimet. Shumica e gjobave që ka vënë AK-ja në të kaluarën nuk janë arkëtuar, për shkak se priten vendimet e shumë apelimëve në gjykatë. Struktura e re e AK-së ende nuk është miratuar nga parlamenti. Trajnimi i gjyqtarëve mbi politikën e konkurrencës duhet të përmirësohet më tej.*

### *Përfundim*

*Disa përparime janë bërë në fushën e politikës së konkurrencës, kryesisht në lidhje me politikën anti-kartel dhe bashkimet, ku Autoriteti i Konkurrencës vazhdoi të konsolidojë historikun e rezultateve. Në tërësi, përgatitjet në fushën anti-kartel dhe të bashkimeve janë të kënaqshme.*

**Shtojca 8: Matrica e rekomandimeve nga komisioni i konkurrencës për vitin 2014**

Nr.	Objekti:	Nisma:	Vlerësimi i Autoritetit të Konkurrencës	Sa është marrë në konsideratë
1.	Vlerësim i aplikimit të shoqërisë "Vodafone M-PESA" sh.p.k pranë Bankës së Shqipërisë për t'u licencuar si subjekt financiar jo bankë/institucion i parasë elektronike, kërkuar nga Banka e Shqipërisë.	Shkresa me Nr. 2821 Prot, dt. 09.10.2014 (AK Nr. 440 Prot., dt. 13.10.2014) dërguar nga Banka e Shqipërisë.	<p>Autoriteti i Konkurrencës, me anë të Shkresës nr. 440\1, dt. 24.11.2014 "Kthim përgjigje", është shprehur se:</p> <p>"- <i>Autoriteti i Konkurrencës vlerëson se procedurat ex-ante të licencimit të shoqërisë Vodafone M-Pesa sh.p.k të vlerësohen edhe në këndvështrimin e Ligjit nr. 9121, dt. 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" duke rekomanduar që nëse është e mundur të mos përmbajnë klauzola përjashtuese për klientët në formën e shkruar në aplikim se shërbimi do të ofrohet "vetëm për abonentët e VF Albania" pasi do të binin në kundërshtim me parimet e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.</i></p> <p><i>Nga diskutimi me ekspertët e BSH-së ka rezultuar se abonentët e tre shoqërive të tjera përveç Vodafone kanë mundësi vetëm të jenë klientë pasivë {marrës} dhe jo aktivë {dërgues} të parave, por gjithsesi atyre ju kërkohen të njëjtat dokumente dhe ju hapen llogari të parasë elektronike njëjloj si klientëve aktive. Nga kjo pikëpamje kuptojmë se heqja e këtij diskriminimi është e mundur pa i detyruar abonentët e shoqërive të tjera të telefonisë celulare të portojnë numrin në Vodafone ose të marrin një numër të ri të Vodafone Albania.</i></p> <p><i>- Autoriteti i Konkurrencës vlerëson se në këtë rast ka tregje të prekura mes shërbimeve financiare dhe telefonisë celulare dhe për këtë arsye kërkojmë vendosjen në vëmendjen e BSH të Vendimit nr. 303 të KK sipas të cilit është përcaktuar pozicioni dominues i Vodafone Albania në tregun e telefonisë celulare me pakicë. Për këtë arsye rekomandojmë se do të duhet të vlerësohet për aplikantin, detyrimi për të bërë të mundur teknikisht mundësinë {"interoperabilitetin"} e këtij shërbimi për të gjithë klientët që zotërojnë një numër celular me kontratë apo me parapagesë pavarësisht nga kompania e licencuar për shërbime celulare në Shqipëri. Kjo do të shmangte klauzola diskriminuese që ky shërbim të ofrohet vetëm për abonentët e Vodafone dhe do të krijohej mundësia e përfitimit të shërbimit edhe për abonentët e shoqërive të tjera të telefonisë së lëvizshme.</i></p> <p><i>- Përfitimi i shërbimit të ofruar nga M-Pesa është i lidhur me faktin e posedimit të një teknologjie të caktuar që është ajo e telefonisë celulare dhe duke qenë se</i></p>	Banka e Shqipërisë nuk është shprehur ende lidhur me këtë aplikim por ka bashkëpunuar intensivisht me Autoritetin e Konkurrencës lidhur me të gjitha shqetësimet dhe rekomandimet për këtë aplikim.

			<p><i>aplikuesi për licencën e parasë elektronike parashikon që akses i klientelës do të jetë me akses të kufizuar {pra klienti duhet të bëhet klient i një kompanie të caktuar para se të ketë mundësinë e përfitimit të shërbimit e M-pesa}, ekziston mundësia e krijimit të barrierave të reja për portimin e numrit, një nga instrumentet për rritjen e konkurrencës së lire dhe efektive në treg. Portimi pengohet në këtë klauzolë dhe klienti e humbet mundësinë e përfitimit të shërbimit nëse nuk dëshiron të jetë klient në kompaninë përkatëse telefonike, pavarësisht se është i kënaqur me shërbimin M-Pesa.</i></p> <p><i>- Me qëllim eliminimin e barrierave të hyrjes në këtë treg propozojmë që licencimi të kryhet konform direktivës 2007/64/EU, duke aplikuar kushte të njëjta për ofruesit e këtyre shërbimeve. Meqenëse BSH na informon se është në procesin e rishikimit të kuadrit mbikëqyrës rregullativ për subjektet financiare jobanka, ndër të tjera do ta konsideronim shumë të rëndësishme dhe do sugjeronim që gjatë procesit të merret në konsideratë direktiva 2007/64/EU dhe të përfshihet në relacionin shoqërues të vendimit të licencimit shkalla e përafrimit të legjislacionit shqiptar me <i>acqui-communitaire</i> në tregun e parasë elektronike dhe shërbimeve financiare.</i></p> <p><i>- AK i rekomandon BSH të vlerësojë efektet e funksionimit të sistemeve të ngjashme në vendet e BE me histori të konsoliduar të sistemit bankar dhe shprehet i gatshëm të bashkëpunojë me BSH në monitorimin ex-post për sigurimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në tregjet përkatëse.”</i></p>	
<b>2.</b>	Mendim mbi Draft/ Rregulloren e Ankandit për Alokimin e Kapaciteteve në SEE CAO” (Rregullorja e Ankandit).	Shkresa nr. 671\1 Prot, dt. 22.10.2014 (AK Nr. 453 Prot., dt. 22.10.2014), dërguar nga ERRE.	Autoriteti i Konkurrencës, me anë të Shkresës nr. 453/2, dt. 31.10.2014 “Kthim përgjigje”, drejtuar ERRE-s, është shprehur se: <i>“Nga vlerësimi i “Draft Rregullores së Ankandit për Alokimin e Kapaciteteve në SEE CAO” në bazë të neneve 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, në kuptim të këtij Ligji, kjo Draft Rregullore nuk kufizon konkurrencën, midis ndërmarrjeve që marrin pjesë në procedurën e Ankandit të kapaciteteve ndërkufitare të interkonjeksionit të energjisë elektrike.”</i>	Nuk ka patur rekomandime pasi akti ka qenë në përputhje me ligjin “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”
<b>3.</b>	Vlerësim Ligjor i Projekt-ligjit “Për tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, kërkuar nga Agjencitë e Reklamave.	Shkresa me Nr. 04 Prot., datë 11.12.2013 (AK Nr. 478 Prot., datë 11.12.2013) dërguar nga Shoqata Shqiptare e Agjencive të	Autoriteti i Konkurrencës, me anë të Shkresës Nr. 478/1 Prot., datë 06.01.2014, informoi Shoqatën se në zbatim të neneve 69 dhe 70 të Ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, do të kryejë vlerësimin përkatës të p/Ligjit “për TVSH-në”, në momentin që ai do ti vihej në dispozicion zyrtarisht. Pas marrjes se p/ligjit përveç konstatimeve të përgjithshme u evidentua në vlerësim se ndryshe nga ligji i mëparshëm i 1995 (neni 25/3), ishte risi e draftit, (tashme ligj ne fuqi me 1.1.2015) që furnizimin e shërbimit të reklamave nga mediat jo vetëm nuk figuronte si i përjashtuar nga TVSH, por ajo ishte e njëjtë (p.sh.20%	Akti nuk paraqiste kundërshtime me rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës për mosdiskriminim të operatorëve subjekt i TVSH-së

		Reklamave.	për reklamat) për operatorët e të njëjtit treg dhe nuk sillte diskriminim konkurrencial.	
<b>4.</b>	Vlerësim i Rregullores së Bankës së Shqipërisë "Për Licencimin dhe Ushtrimin e Veprimtarisë nga Subjektet Financiare Jo-banka", në bazë të kërkesës së ndërmarrjes "UNIONI FINANCIAR TIRANË" SHPK;	Shkresa Nr.663 Prot, dt. 13.05.2014 dërguar nga "UNIONI FINANCIAR TIRANË" SHPK;	Autoriteti i Konkurrencës, me anë të Shkresës nr. 228/2, dt. 31.07.2014 "Kthim përgjigje", drejtuar Unionit Financiar, është shprehur se: "Komisioni, pasi ju drejtua Bankës së Shqipërisë për interpretim të rregullores përkatëse, vlerësoi rregulloren "Për Licencimin dhe Ushtrimin e Veprimtarisë nga Subjektet Financiare Jo-banka" dhe në përfundim: KK i rekomandon Bankës së Shqipërisë që subjektet që janë nën mbikëqyrje të mbahen në konsideratë që për tregje apo shërbime ku këta subjekte janë konkurrentë me njëri-tjetrin, të mos diskriminohen apo të trajtohen në mënyra të ndryshme midis tyre, por të respektohen parimet bazë të transparencës, mos diskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve si gjatë procesit të licencimit ashtu edhe të operimit në treg."	Rekomandimi është marrë parasysh nga Banka e Shqipërisë dhe ka patur takime në nivel ekspertësh për përfshirjen e rekomandimeve në versionin final të aktit
<b>5.</b>	Vlerësim i legjislacionit në fushën e telekomunikacionit, gjatë procedurave hetimore në atë treg përkatës.	Hetimi i thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë	Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit <b>Nr. 303, datë 16.01.2014</b> "Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e telefonisë celulare me pakicë ndaj ndërmarrjes "Vodafone Albania" SHA dhe rekomandime për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare", vendosi: "II. Ti rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare: 1. Të marrë masat e ndërmjetme dhe të menjëhershme, përpara përfundimit të analizës së tregut të pakicës së telefonisë celulare, për të bërë të zbatueshme zgjidhjet e rregullimit të tregut për të parandaluar daljet nga tregu që do kishin pasoja afatgjatë mbi konkurrencën, dhe në veçanti: a) Të modifikojë modelin BU-LRAIC duke ulur ndjeshëm koston e terminimit për operatorët e vegjël ndaj operatorëve të mëdhenj në këtë treg, me qëllim nxitjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në tregun përkatës; b) Të detyrojë zvogëlimin real të diferencës së tarifave off-net/on-net brenda dhe jashtë paketave dhe planeve tarifore specifike për operatorët që kanë pozitë dominuese. 2. Të realizojë analizën e tregut të pakicës në telefoninë celulare për të adresuar zgjidhjet për shqetësimet e konkurrencës në tregun e telefonisë celulare me pakicë, duke ndërmarrë masa konkrete rregullatore për reduktimin e diferencimit të theksuar të tarifave për thirrjet brenda rrjetit me tarifën jashtë rrjetit të operatorit Vodafone. 3. Në rolin e rregullatorit të monitorojë zbatimin e angazhimit publik të Vodafone Albania për barazimin e tarifave brenda Vodafone Club dhe jashtë rrjetit të Vodafone (drejt fix, AMC, Eagle dhe Plus) dhe në veçanti, reflektimin e zvogëlimin real të kësaj diference jo vetëm në tarifën nominale (off-net, on-net),	Rekomandimet e dhëna janë marrë në konsideratë nga ana e AKEP në analizën e tregut të telefonisë celulare. Problem mbetet zbatimi i vendimeve të AKEP për rregullimin e tregut dhe për këtë arsye pranë AKEP dhe AK ka patur ankesa nga Plus dhe AT. Me shkresën nr. 64 të datës 29 janar 2015 AK ka kërkuar nga AKEP statusin e zbatimit të vendimeve për rregullimin e tregut



			por edhe në njësitë e përfshira në paketat opsionale të komunikimit kombëtar (ofertat dhe paketat javore, mujore e vjetore).”	
<b>6.</b>	Vlerësim i legjislacionit në tregun e shërbimit të transportit ajror	Monitorimi i tregut të transportit ajror të pasagjerëve	Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit <b>Nr.308, datë 21.02.2014</b> “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të transportit ajror”, vendosi: “1) <i>T’i rekomandojë OSHA;</i> a. <i>Në zbatim të pikës 19. 2, germa (a), të Kontratës së Koncesionit të Aeroportit Ndërkombëtar në cilësinë e Organit të Autorizuar Shtetëror dhe në bashkëpunim me shoqërinë konçesionare të rishikojnë Pagesat për Shërbimet e Aeroportit siç parashikohet çdo tre vjet.</i> b. <i>Për shkak të pozicionit të kompanisë konçesionari si i vetmi ofrues i shërbimeve ndërkombëtare të transportit të pasagjerëve, OSHA të hartojë dhe aprovojë një metodologji/rregullore për vendosjen e tarifave të aeroportit, si edhe tarifën të jenë të orientuara drejt kostos.”</i>	Nga ana e Ministrisë së Transportit nuk kemi përgjigje lidhur me këto rekomandime.
<b>7.</b>	Vlerësim i kontratës konçesionare të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në RSH	Monitorimi në tregun e shërbimit ekskluziv për kontrollin teknik të automjeteve	Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit <b>Nr. 312, datë 18.04.2014</b> “Për disa rekomandime në lidhje me funksionimin e tregut të shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve”, vendosi: “1. <i>T’i rekomandojë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës:</i> 1.1. <i>Në periudha afatshkurtër të kërkojë nga konçesionari SOCIETE GENERALE DE SURVEILLANCE S.A të krijojë më shumë se një mundësi për zgjedhjen e konsumatorit për kryerjen e kontrollit të detyrueshëm teknik vjetor të automjeteve në qytetin e Tiranës.</i> 1.2. <i>Në periudha afatgjatë të shikohet mundësia e ofrimit të kontrollit teknik të automjeteve nga disa operatorë.</i> 1.3. <i>Të kërkojë shprehjen e mendimit të Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të nenit 69-70 të Ligjit, pasi të marrë studimin e tregut nga konçesionari në lidhje me mënyrën e funksionimit të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm;</i> 1.4. <i>Të marrë parasysh direktivën e re të BE-së lidhur me rregullat e reja për koncesionet duke zbatuar parimin e transparencës dhe të përcaktojnë kriterin e “tenderit me avantazhin më të mirë ekonomik” përgjatë procedurave të prokurimit, ku autoritetet publike do t’i mëshojnë rëndësisë mbi cilësinë, pasojave mbi mjedisin, aspekteve sociale ose risive, si dhe duke pasur parasysh çmimin si dhe jetëgjatësinë-ciklin-koston e asaj çfarë prokurohet për tu dhënë si e drejtë ekskluzive ose e veçantë.”</i>	Ministria e Transportit është në procesin e rishikimit të të drejtës ekskluzive.

<p><b>8.</b></p>	<p>Vlerësimi i kontratës së koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit</p>	<p>Monitorimi për kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit</p>	<p>Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit <b>Nr.319, datë 13.06.2014</b></p> <p>“Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”, vendosi:</p> <p>“1. <i>T’i rekomandojë Ministrisë së Financave dhe Këshillit të Ministrave, rishikimi i kontratës koncesionare për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit.</i></p> <p>2. <i>Institucionet publike duhet të respektojnë parashikimet e Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) për të kërkuar paraprakisht vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës në dhënien e miratimit të akteve që kanë si objekt ose pasojë dhënien e të drejtave ekskluzive ose kufizime sasiore në tregje ose sektorë të ndryshëm të ekonomisë.</i></p> <p>3. <i>Në procesin e rishikimit të Ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të mbahet parasysh direktiva e re e BE-së (32014L0023; Direktiva 2014/23/EU e Parlamentit Europian dhe e këshillit të datës 26 Shkurt 2014 mbi dhënien e kontratave të koncesioneve; OJ L 94, 28/03/2014, p. 1–64) që të ndahen qartë tregjet nga shërbimi publik dhe këto të fundit përgjithësisht t’i mbeten shtetit si detyrime pasi nëse kalojnë nga shteti te privati kanë kosto shtesë për biznesin dhe konsumatorin dhe eliminojnë mundësinë e zgjedhjes së biznesit apo konsumatorit pasi ofruesi është gjithmonë ekskluziv (i vetëm).</i></p> <p>4. <i>Instrumenti ligjor për rishikimin e kontratës koncesionare është procesi i rishikimit të Kodit Doganor dhe sipas nenit 18.2.1 të Ligjit 123/2013 për miratimin e marrëveshjes koncesionare.</i></p> <p>5. <i>Përmbajtja e kontratës rekomandohet si vijon: “Ministria e Financave duke marrë parasysh specifikat e shërbimit doganor për të luftuar kontrabandën dhe evazionin fiskal mund të kontraktojë koncesionarin vetëm për blerjen e pajisjeve dhe shërbimin ta kryejnë organet doganore”.</i></p>	<p>Nga ana e Ministrisë së Financave nuk ka një përgjigje mbi rekomandimet e Autoritetit. Ndërkohë që Rapiscan Systems ICN kërkoi revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 319, datë 13.06.2014 por Komisioni i Konkurrencës vendosi mospranimin e kërkesës për revokim vendimi.</p>
<p><b>9.</b></p>	<p>Vlerësim i legjislacionit të tregut të sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, gjatë procedurave hetimore në atë treg përkatës.</p>	<p>Hetimi i Thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta</p>	<p>Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit <b>Nr.325, Datë, 30/07/2014</b></p> <p>“Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për nxitjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”, vendosi:</p> <p>“1. <i>T’i rekomandojë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare marrjen e masave rregullatore për vendosjen e tregut të sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta në kushtet e funksionimit eficient duke siguruar konkurrencën mes shoqërive të sigurimit nëpërmjet marrjes së</i></p>	<p>AMF ka kundërshtuar në rrugë administrative për revokimin e Vendimit nr. 325, datë 30.07.2014 të Komisionit të Konkurrencës”. Komisioni i Konkurrencës me</p>

			<p><i>masave si vijon:</i></p> <p>1.1. Të bëjë të zbatueshëm parashikimin ligjor për trajtimin e dëmit nga siguruesi i drejtpërdrejtë sipas parashikimeve të ligjit nr.10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit";</p> <p>1.2. Të miratojë tabela të individualizuara të primit të riskut mbështetur në analizën e riskut sipas portofolit të shoqërive të sigurimit, karakteristikave të produkteve dhe strukturës së sigurimeve për çdo shoqëri sigurimi;</p> <p>1.3. Të informojë Autoritetin e Konkurrencës në mënyrë periodike mbi vënien në funksionim të projektit Bonus-Malus deri në realizimin e plotë të projektit për individualizimin e primit të riskut sipas historikut të dëmeve të të siguruarit, moshë dhe drejtuesit të automjeteve, vendbanimi dhe fuqia motorike e automjetit, etj.</p> <p>1.4. Të bashkëpunojë me Autoritetin e Konkurrencës në kuadër të projektit të asistencës me Bankën Botërore për rishikimin e kuadrit rregullator për produktet e sigurimit MTPL me theks të veçantë mbi teknikat e përlllogaritjes së provigjoneve të dëmeve nga produktet e sigurimit MTPL.</p> <p>1.5 Të publikojë raportin dhe të dhënat financiare të shoqërive të sigurimit për të mundësuar konkurrencën e ndershme në tregun e sigurimeve mbështetur në Udhëzimin "Mbi rregullat e publikimit të të dhënave të shoqërive të sigurimit, shoqërive të brokerimit në kuadrin e transparencës ndaj publikut dhe mbrojtjen konsumatorë", me vendimin e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrës Financiare nr. 11, datë 08.02.2007, dhe të sigurojë që "Shoqëria e sigurimit publikon raportin vjetor i cili përfshin raportin vjetor financiar dhe të dhëna të tjera të përfshira në këtë Udhëzim. Ky raport publikohet, jo më vonë se gjashtë muaj nga përfundimi i vitit kalendarik".</p>	<p>Vendimin nr. 327 date 08.09.2014</p> <p>"Për shqyrtimin e ankimit administrativ të Autoritetit të Mbikëqyrës Financiare" vendosi ta rrëzojë këtë ankimim. Gjithsesi për disa nga rekomandimet AMF si për sistemin Bonus Malus dhe tabelat e individualizuara të primit të rrezikut është në proces implementimi me asistencën e projekteve të Bankës Botërore dhe FSVK</p>
<b>10.</b>	Vlerësim i legjisllacionit në sektorin e energjisë elektrike dhe veçanërisht rregullat dhe procedurat e blerjes së energjisë elektrike nga ndërmarrja CEZ SHA/OSHEE;	Monitorimi i tregut të importit të energjisë elektrike nga CEZ SHA për mbulimin e humbjeve	<p>Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit <b>Nr. 334, datë 31.10.2014</b></p> <p>"Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e prokurimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes", vendosi:</p> <p>"1. Me qëllim mirëfunksionimit të tregut të energjisë elektrike, për rritjen e konkurrencës në tregun përkatës së blerjes së energjisë elektrike, t'i rekomandojë Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike, si vijon:</p> <p>1. Në kushtet e ndryshuara, të rishikojnë procedurat e blerjes së energjisë elektrike mujore dhe vjetore për OSHEE sipas parimeve:</p> <p>a) Nxitjen e pjesëmarrjes në procedurat e blerjes së energjisë,</p> <p>b) Nxitja e konkurrencës ndërmjet blerësve;</p> <p>c) Sigurimi i trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë pjesëmarrësit në procedurën e blerjes së energjisë;</p>	<p>OSHEE në seancën dëgjimore pranë Komisionit të Konkurrencës me datë 5 shkurt 2014 u shpreh se aktet nënligjore janë tagër i ERE ndërsa rekomandimet e mundshme brenda rregullores ekzistuese do të merren parasysh dhe do të testohen në</p>

		<p>d) Sigurimi i integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e blerjes së energjisë elektrike dhe kosto sa me te ulëta për këto lloj transaksionesh.</p> <p>2. Për periudhën afatshkurtër (meqenëse tenderët janë në periodicitet mujor) deri në miratimin e një rregulloreje të re për blerjen e energjisë elektrike nga Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike, të rishikohet vendimi 30, datë 23.3.2001 i ERE “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të blerjes nga KESH SH.A...”:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Duke ndryshuar nenin 13, pika 4, në mënyrë që pranimi, vlerësimi dhe negociimi i ofertave të kryhet në prani të ofertuesve duke rritur në këtë mënyrë besueshmërinë e procesit dhe konkurrencën ndërmjet ofruesve.</li> <li>- Duke ndryshuar neni 7 i rregullores i cili aktualisht përjashton nga procedurat e tenderimit prodhuesit vendas të licencuar, duke hapur tregun dhe lejuar të gjithë aktoret e tregut të marrin pjesë në procedurat e tenderit duke e bërë në këtë mënyrë me konkurrues procesin.</li> </ul> <p>3. Në draftimin e rregullave për blerjen e energjisë për operatorin e shpërndarjes të mbahen parasysh edhe parashikimet e vendimit nr. 30, datë 23.3.2011 “Për rregullat dhe procedurat e blerjes së energjisë elektrike nga KESH SH.A” në mënyrë të veçantë: të nenit 9/2 (Publikimi ftesës), neni 11 (kriteret e vlerësimit të ofertave sipas çmimit/njësi më të ulët, neni 19 (publikimi në faqen zyrtare të internetit i procedurës së blerjes).</p> <p>Gjithashtu mënyra e përcaktimit të ofertës fituese të përshtatet sipas rregullores së Ministrisë së Financave nr. 31, datë 27.12.2013 “Për emetimin e obligacioneve”, neni 13, pika 6, “kërkesat konkurruese pranohen si fituese duke filluar nga ato që kanë çmimin më të ulët deri në plotësimin e sasisë së energjisë së kërkuar”.</p> <p>4. Duke marrë në konsideratë faktin që aktualisht në Shqipëri të gjitha procedurat e prokurimit publik janë në formë elektronike dhe realizohen nëpërmjet platformave përkatëse elektronike, kjo procedurë të parashikohet edhe në rregullat e blerjes së energjisë elektrike.</p> <p>5. Për rritjen e transparencës dhe uljen e mundësive të abuzimeve, të behet publikimi mujor dhe vjetor i sasisë dhe çmimit mesatar të energjisë elektrike të importuar, nga Enti Rregullator (ERE).</p> <p>II. ERE dhe Ministria e Industrisë dhe Energjetikës, në zbatim të neneve 69 dhe 70 të Ligjit duhet të sjellin për mendim pranë Komisionit të Konkurrencës, para miratimit, të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore të funksionimit të tregut të energjisë, pasi kjo do të ndihmonte tregun e energjisë të zhvillohej dhe të bëhej</p>	<p>procedurat e ardhshme për blerjen e energjisë për mbulimin e humbjeve</p>
--	--	--	--

			më konkurrues.”	
<b>11.</b>	Vlerësimi i kontratës së koncesionit për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave	Me nismën e vetë AK, bazuar në shqetësimet e komunitetit të biznesit të bëra prezent në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet mediave	Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit <b>Nr.337, datë 11.11.2014</b> “Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për projektimin, financimin dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave”, vendosi: “1. <i>T’i rekomandojë Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes,</i> 1.1. <i>Të kryejnë vlerësimin ekonomik dhe teknik mbi zbatueshmërinë e kushteve të kontratës konçesionare dhe analizën e justifikimit ekonomik të konçesionit, i cili është pasuar me rritjen e kostos së biznesit për pullat fiskale. Në këtë vlerësim të identifikohet përmbushja e qëllimit për të cilin është dhënë koncesioni, si rritjen e të ardhurave fiskale dhe luftën ndaj evazionit dhe kontrabandës së produkteve të akcizës.</i> 1.2. <i>Rishikimin e kontratës konçesionare, për pjesën e pullave fiskale për barnat pasi konstatohet se nuk ka filluar prodhimi i tyre, si dhe sjell kosto të lartë për produktet farmaceutike të cilat kanë një ndjeshmëri shumë të lartë.”</i>	Nga ana e Ministrisë së Financave nuk jemi informuar për hapa të mëtejshëm. Ndërkohë Ndërmarrja SICPA në datë 03.02.2015, ka depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës një shkresë ku kërkoi revokimin e Vendimit nr. 337, datë 11.11.2014. Komisioni i Konkurrencës vendosi të mos e revokojë vendimin.
<b>12.</b>	Vlerësim i P/Ligjit “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”;	Shkresa Nr. 403 Prot., dt. 19.09.2014, dërguar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë.	Autoriteti i Konkurrencës, me anë të Shkresës nr. 403/1, dt. 03.10.2014 “Në lidhje me disa sugjerime mbi Projekt-Ligjin “Për sektorin e energjisë elektrike”, drejtuar Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë , është shprehur se: “Në Projekt Ligjin e paraqitur vihet re se, në përgjithësi projektligji merr në konsideratë parimet bazë për garantimin e një furnizimi të qëndrueshëm dhe të sigurtë me energji elektrike të klientëve, nëpërmjet krijimit të një tregu eficient dhe konkurrues, duke marre në konsideratë paketën e tretë rregullatore dhe disa nga rekomandimet e dhëna nga Autoriteti i Konkurrencës për tregun e energjisë elektrike. Projekt Ligji i ri përveçse është i domosdoshëm, ai përbën një risi për rregullimin e kuadrit ligjor të këtij sektori kyç dhe do të ndikojë pozitivisht për hapjen dhe konkurrencën e tregut të energjisë elektrike. Në vlerësimin e përgjithshëm është e rëndësishme që ligji të shpreh qartë elementët e transparencës dhe të mos diskriminimit midis operatorëve, gjithashtu është e domosdoshme ndërhyrja në elementët kyç të modelit të tregut, të cilat do të jenë edhe elementë bazë për modelin e tregut që do të pasojë dhe shoqërojë këtë projekt ligj. Për sa i përket sugjerimeve nen për nen të projektligjit, është përgatitur një material në nivel ekspertesh, material i cili do të jetë objekt diskutimi të	Janë marrë në konsideratë pjesërisht rekomandimet e AK në fazën e parë të diskutimit të plligjit. Pas kalimit në Këshillin e Ministrave Autoriteti është shprehur sërish pranë Komisionit të veprimtarive Prodhuese për draftin.


			<i>mëtejshëm gjatë tryezave që do të pasojnë diskutimet rreth projekt ligjit.</i>	
<b>13.</b>	Vlerësimi i p/amendimeve të Kodit të Procedurave Administrative.	Marrë nga faqja zyrtare e Kuvendit të Shqipërisë	Autoriteti i Konkurrencës, me nismën e tij, ka bërë vlerësimin e Projekt Kodit të Procedurave Administrative dhe ka konkluduar se ky Projekt Kod nuk bie në kundërshtim me Ligjin nr. 9121, dt. 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.	Nuk ka patur rekomandim
<b>14.</b>	Vlerësim i Projekt/Ligjit “Për Veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit”	Me nismën e vetë Autoritetit	Autoriteti i Konkurrencës, me nismën e tij, ka bërë vlerësimin e “Projekt/Ligjit “Për Veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit” dhe është shprehur se ky projekt/ligj nuk bie në kundërshtim me Ligjin Nr.9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.	Nuk ka patur rekomandim
<b>15.</b>	Vlerësim shoqëruar me dhënie mendimi për Dokumentin “Strategjia sektoriale e Axfordës Dixhitale 2014-2020”.	Shkresa Nr. 4614 Prot., dt. 5.12.2014, dërguar nga Ministri i Shtetit për Inovacionit dhe Administratën Publike.	Autoriteti i Konkurrencës, me anë të Shkresës nr. 526/1, dt. 19.12.2014 “Dhënie mendimi i strategjisë n\sektoriale Axfordës Dixhitale 2014-2020”, drejtuar Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, pas shqyrtimit të dokumenteve dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, është shprehur se: - <i>Strategjia është në përputhje me Ligjin nr. 9121, dt. 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.</i>	Nuk ka patur rekomandim
<b>16.</b>	Vlerësim i p/vendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”	Shkresa nr. 416 Prot., dt. 29.09.2014, dërguar nga Banka e Shqipërisë	Autoriteti i Konkurrencës, me anë të Shkresës nr. 416/1, dt. 01.10.2014 “Mbi projekt-vendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, drejtuar BSH-së, është shprehur se: <i>“Projekt-Vendimi i paraqitur nuk bie në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9121, dt. 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.</i>	Nuk ka patur rekomandim
<b>17.</b>	Mendim mbi dokumentin “Analizë e tregut të telefonisë së lëvizshme për vitin 2013”	Shkresa nr. 358, dt. 3.9.2014, dërguar nga AKEP	Autoriteti i Konkurrencës, me anë të Shkresës nr. 358/1, dt. 23.09.2014 “Mbi analizën e tregut të telefonisë celulare”, drejtuar AKEP, është shprehur <i>pa vërejtje dhe sugjerime, pasi është konstatuar se raporti ka adresuar plotësisht çështjet e rekomanduara nga Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. 303, dt. 16.01.2014 dhe rekomandimet e rezolutës së Kuvendit nr. 251/3 Prot., dt. 03.06.2014 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2013’.</i>	AK ka konstatuar se janë marrë parasysh rekomandimet nga ana e AKEP të shprehura në vendimet e tij.

<b>18.</b>	Vlerësim i marrëveshjes së Licencës për Lotarinë Kombëtare	Me nismën e vetë AK	<p>Autoriteti i Konkurrencës, me anë të Shkresës 515, dt. 04.12.2014 “Mbi vlerësimin e marrëveshjes së Licencës për Lotarinë Kombëtare”, drejtuar Ministrisë së Financave dhe për dijeni Komisionit Kuvendor për Ekonomi dhe Financë, është shprehur se:</p> <p><i>“Në rastin e miratimit të Ligjit nr. 95/2013, dt. 4.3.2013 “Për miratimin e marrëveshjes së licencës për lotarinë kombëtare ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet i autorizuar, dhe shoqërisë “Oesterreichische Lotterien”, Gmbh, nëpërmjet shoqërisë “Olg Project” sh.p.k” është mbajtur parasysh parimi dhe eksperiencia e thujtës të gjitha vendeve që do të jetë një licencë e vetme për lojërat për të cilat Lotaria ka ekskluzivitet.</i></p> <p><i>Sa i përket mbajtjes së kësaj të drejte ekskluzive nga shteti apo kalimi me koncesion te privati, praktika sugjeron të dy mënyrat dhe për këtë arsye Autoriteti i Konkurrencës konkludon se mbetet në vlerësimin e MF mbajtja e monopolit të lojërave të lotarisë kombëtare nga Oesterreichische Lotterien Gmbh nëpërmjet OLG Project sh.p.k, apo kthimi i saj në zotërim të shtetit shqiptar.</i></p> <p><i>Nga pikëpamja e Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” ky pozicion dominues monopol nuk është i ndaluar sipas parashikimeve të nenit 8 të Ligjit, por AK do të monitorojë sjelljen e ndërmarrjes sipas parashikimeve të nenit 9 të Ligjit.</i></p>	Nuk ka zhvillime lidhur me këtë të drejtë ekskluzive.
<b>19.</b>	Dhënie mendimi për aplikimin për tarifatat e reja të energjisë për KESH, OST dhe OSHEE	Shkresa nr.453 3, dt.19.11.2014, dërguar nga ERE	<p>Autoriteti i Konkurrencës, me anë të Shkresës nr. 524, dt. 10.12.2014 “Dhënie mendimi për aplikimin për tarifatat e reja të energjisë për KESH, OST dhe OSHEE”, drejtuar ERE, rekomandon: që të mbahen parasysh parimet e përcaktimit të tarifave në tregjet e rregulluara si transparenca, trajtimi i barabartë dhe konkurrenca , për të mundësuar sigurinë elektrike dhe funksionimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në tregun e energjisë elektrike. Tashmë që OSHEE është rikthyer në pronësi dhe administrim publik është rekomanduar përfshirja e KESH dhe prodhuesve të energjisë në procedurat mujore dhe vjetore të blerjes së energjisë për mbulimin nga humbjet të OSHEE-së.</p> <p>ERE për vitin 2015 duhet të miratojë një tarifë të shpërndarjes të mesatarizuar në mënyrë të ponderuar me tarifën përfundimtare të konsumatorëve tariforë të orientuar drejt kostos reale dhe trajtimin e barabartë të konsumatorëve familjarë, biznesit dhe institucioneve publike.</p>	Janë marrë parasysh nga ERE në vendimmarrjen për tarifatat e reja të energjisë

<p><b>20.</b></p>	<p>Propozime mbi ndryshimin e Udhëzimit për TVSH-në, lidhur me produktet e karburantit dhe cigareve</p>	<p>Procedurat hetimore ne tregun e karburanteve dhe cigareve</p>	<p>Autoriteti i Konkurrencës me anë të shkresës nr. 7 Prot, dt. 6.1.2015 “Mbi shfuqizimin e Udhëzimit 17/2008”, drejtuar Ministrit të Financave, risjell në vëmendje të MF-se VKK Nr. 118 datë 29.05.2009, duke propozuar marrjen në konsideratë të tij në hartimin e Udhëzimit të ri për TVSH-në.</p> <p>Konkretisht, lidhur me produktet e karburantit dhe cigareve, është propozuar që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shoqëritë e tregtimit me shumicë tu faturojnë shoqërive të tregtimit me pakicë vetëm me çmim shumice;</li> <li>- Shoqëritë/personat fizikë të shitjes me pakicë përcaktojnë vetë çmimin e shitjes me pakicë dhe barra fiskale (TVSH) llogaritet si diferencë mes dy çmimeve (pakicë-shumicë).</li> </ul>	<p>Me hyrjen ne fuqi (1 Janar 2015) te Ligjit te ri Nr. 92/2014 për TVSh-në”, shfuqizohen të gjitha aktet nënligjore te dala në zbatim të tij. Për rrjedhojë, Ministri i Financave ka miratuar Udhëzimin Nr. 6, dt. 30.01.2015 “Për TVSH në R. Shqipërisë”, me anë të të cilit hiqet importuesve te mëdhenj te drejtën që të vendosin çmimin final të karburantit në treg, i cili tashmë do të përcaktohet përmes konkurrencës nga vetë pikat e pakicës, duke respektuar propozimin e AK për këtë rast. Ndërsa lidhur me cigaret vazhdon te aplikohet skema e veçante (pika 4.2) ku çmimi maksimal i shitjes me pakice te cigareve vazhdon te përcaktohet nga furnizuesi kryesor.</p>
-------------------	---	--	--	---



### Shtojcë 9: Struktura e Autoritetit të Konkurrencës



**Shtojca 10: Buxheti faktik i Autoritetit të Konkurrencës viti 2014**

	<b>Plani</b>	<b>Fakti</b>	<b>Mbetje</b>	<b>Në %</b>
<b>Shpenzime personeli</b>	44.500.000	42.672.000	1.827,461	96%
<b>Kontribute sigurime shoqërore</b>	7.000.000	6.207.557	792.8330	89%
	10.300.000			
<b>Shpenzime operative</b>		9.246.598	1.053.402	90%
<b>Investime</b>	1.000.000	952.812	47.188	95%
<b>Totali:</b>	<b>63.402.206</b>	<b>59.682.206</b>	<b>3.720.494</b>	<b>93.4%</b>